



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS  
ALBANIA



# Raport i Vlerësimit Afatmesëm për Strategjinë e Strehimit Social

Dhjetor 2020



Leave  
No One  
Behind

United Nations House

Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania  
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

# Raport i Vlerësimit Afatmesëm për Strategjinë e Strehimit Social

për projektin

**“Mbështetja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) për kryerjen e rishikimit afatmesëm të Strategjisë së Strehimit Social (SSS) dhe të planit të saj të veprimit, si dhe për hartimin e Planeve Vendore të Strehimit Social”,**

**zbatuar nga UNDP**

**në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbete pas", të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.**

Raporti u përgatit dhe u dorëzua nga: MetroPOLIS, Shpk. dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Numri i referencës së kontratës: 39/2020.

20 dhjetor 2020



**Leave  
No One  
Behind**

**United Nations House**

Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania  
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje .....	6
1. "Strategjia e Strehimit Social 2016-2025" .....	6
2. Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e vlerësimit .....	7
3. Analiza e kontekstit .....	9
3.1 Procesi i integritimit në BE.....	9
3.2 Tërmeti i 26 nëntorit 2020 .....	10
3.3 COVID-19 dhe strehimi social.....	15
3.4 Ndryshimet institucionale .....	20
3.5 Strategjitë dhe programet e tjera.....	20
3.6 Kostot dhe shpenzimet e strehimit social .....	25
3.7 Legjislacioni mbi strehimin social dhe ndërthurja me sektorë të tjerë .....	28
3.8 Mësimet e nxjerra nga analiza e kontekstit.....	32
4. Vlerësimi afatmesëm i Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025 .....	34
4.1 Rëndësia e objektivave, qëllimeve, produkteve dhe rezultateve dhe përshtatshmëria e masave .....	35
4.2 Efektiviteti përkundrejt parimeve, objektivave dhe veprimeve .....	41
4.3 Efiçenca përkundrejt produkteve .....	53
4.4 Qeverisja .....	55

## Tabela e figurave

Figura 1. Shifrat e COVID-19 në datat 14 tetor dhe 8 nëntor 2020 .....	15
Figura 2. Numri total i personave të infektuar në nivel lokal, 8 nëntor 2020 .....	16
Figura 3. Morbiditeti (infektimet) dhe vdekshmëria (vdekjet) në Shqipëri .....	17
Figura 4. Varësia ndaj të moshuarve ndër vite.....	18
Figura 5. Varësia ndaj të moshuarve sipas qarkut, 2018.....	18
Figura 6. Numri i familjeve përfituese të investimeve dhe subvencioneve për strehimin social.....	25
Figura 7. Numri i familjeve për çdo kategori përfituesish, që kanë përfituar nga subvencionimi i qirasë (2019 dhe 2020) .....	26
Figura 8. Shpenzimet e programeve të strehimit social për vit: Investimet (majtas) dhe subvencionet (djathtas).....	27
Figura 9. Investimet në strehimin social sipas burimit, në bazë të kontratës .....	27



Figura 10. Shpërndarja e bashkive të anketuara (në ngjyrë blu) .....	34
Figura 11. Rëndësia dhe përshtatshmëria e objektivave strategjike në nivel vendor (mesatarja e ponderuar) .....	35
Figura 12. Përqindja e bashkive që kanë shprehur nevojën për ndryshim të objektivave strategjike, nënobjektivave dhe/ose qëllimeve të objektivave.....	37
Figura 13. Vështirësitë në menaxhimin financiar dhe monitorimin e brendshëm të proceseve për programet e strehimit social. ....	38
Figura 14. Faktorët e jashtëm që pengojnë proceset vendore për strehimin social .....	39
Figura 15. Ndikimi i perceptuar (balanca neto) e tërmetit të 26 nëntorit dhe i pandemisë COVID-19 në nivel vendor, sipas bashkive. ....	39
Figura 16. Programet e strehimit social të zbatuara nga bashkitë gjatë periudhës 2017-2020.....	41
Figura 17. Bashkitë që zbatojnë më shumë se 1 program të zbatimit social.....	42
Figura 18. Integrimi i programeve të strehimit me sektorë të tjerë .....	43
Figura 19: Niveli i bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe institucioneve në nivel kombëtar .....	43
Figura 20. Metodatat e ndarjes së informacionit .....	44
Figura 21. Aksesit i grupeve të vulnerabël në programet e strehimit social gjatë periudhës 2017-2020.....	46
Figura 22. Konsultimi i kritereve të përzgjedhjes të bazuara në pikë me grupet e interesit .....	46
Figura 23. Niveli i vështirësisë me të cilin përballen bashkitë në lidhje me kapacitetet financiare .....	50
Figura 24. Vlerësimi mesatar nga 1 (shumë i lehtë) deri në 6 (i pamundur) për çdo program të strehimit social (perceptimi i bashkive bazuar në vështirësitë teknike dhe financiare) .....	50
Figura 25. Burimet bashkiake për përmbushjen e kërkesës për strehim social .....	51
Figura 26. Përqindja e personave të pastrehë për bashki, në raport me mesataren kombëtare .....	52
Figura 27. Lehtësia e aksesit të bashkive në fondet e strehimit social në nivelin qendror .....	54
Figura 28. Struktura institucionale për strehimin social në nivel vendor .....	55
Figura 29. Madhësia e sipërfaqeve (m <sup>2</sup> ) të caktuara për banesa sociale në Planet e Përgjithshme Vendore Territoriale .....	56
Figura 30. Sistemi i përdorur nga bashkitë për të regjistruar dhe ruajtur të dhëna mbi strehimin social .....	57
Figura 31. Shpeshtësia e përdorimit të sistemeve të informacionit në nivel vendor .....	58
Figura 32. Hartëzimi i komuniteteve të disavantazuara në nivel vendor dhe monitorimi i ndikimeve të programeve të strehimit .....	59

## **Tabela e tabelave**

Tabela 1. Dëmet dhe humbjet e përlogaritura nga tërmeti i 26 nëntorit.....	12
Tabela 2. Familjet e prekura nga tërmetet, që përfitojnë nga strehimi social .....	14
Tabela 3. Fondet e planifikuara për OS <sub>5</sub> dhe investimet dhe subvencionet e zbatuara gjatë periudhës 2016-2020, në lekë .....	53

## Shkurtime

SHVSH	Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
ALL	Lek shqiptar
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BE	Bashkimi Evropian
PPVT	Plani i Përgjithshëm Vendor Territorial
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
QSh	Qeveria e Shqipërisë
PINSK	Plani i Integruar Ndërsektorial Kombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MB	Ministria e Brendshme
VAM	Vlerësimi afatmesëm
MZHU	Ministria e Zhvillimi Urban
OJQ	Organizatë Joqeveritare
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
VNFN	Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive natyrore
PPP	Partneriteti Publik-Privat
PAK	Personat me aftësi të kufizuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SSS	Strategjia e Strehimit Social
OS	Objektiv specifik
OKB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

## Hyrje

Me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri, përmes programit të tij "Askush të mos mbetet pas" të financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin e rishikimit afatmesëm të Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025. <sup>1</sup>Siç parashikohet në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", Ministria përgjegjëse për strehimin social është përgjegjëse për shqyrtimin e planit të veprimit të strategjisë.

Dokumenti në vijim jep një vlerësim të zbatimit të Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025. Ky vlerësim është ndërmarrë nga MetroPOLIS shpk dhe Co-PLAN, për llogari të ministrisë. Qëllimi i këtij vlerësimi është kryerja e një shqyrtimi të zbatimit të strategjisë për periudhën afatmesme 2016-2020, i cili do të shërbejë si bazë për dhënien e rekomandimeve për rishikimin e Strategjisë dhe të Planit të saj të Veprimit.

### 1. "Strategjia e Strehimit Social 2016-2025"

"Strategjia e Strehimit Social 2016-2025"<sup>2</sup> u miratua më 1 qershor 2016 me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 405. Strategjia u përgatit nga Ministria e Zhvillimit Urban, e cila ishte përgjegjëse për zbatimin e saj deri në vitin 2017. Që prej asaj kohe, zbatimin e strategjisë e ka marrë përsipër<sup>3</sup> Drejtoria e Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Strategjia përqafon parimet e disponueshmërisë, aksesit, përbalueshmërisë dhe përshtatshmërisë së strehimit, si dhe synon të japë zgjidhje për strehimin e "familjeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme, të cilat nuk mund ta përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, dhe sidomos për familjet me tregues vulnerabiliteti të cilët çojnë në përjashtimin e tyre nga mundësitë e strehimit" (Qeveria e Shqipërisë, 2016, f. 5). Strategjia parashikon "Përfshirjen sociale dhe ekonomike nëpërmjet ofrimit të alternativave të strehimit të cilat janë të disponueshme, të aksesueshme, të përbalueshme dhe të përshtatshme, për më shumë se 60% të popullsisë shqiptare e cila nuk ka mundësi financiare të përballojë strehimin me çmimet e tregut dhe në veçanti grupet të cilat janë në pozita të pafavorizuara" (Qeveria e Shqipërisë, 2016, f. 29). Strategjia ka 4 prioritetet strategjike, të cilat përkthehen më tej në pesë objektiva, si më poshtë vijon:

- "Zhvillimi i kapaciteteve të 61 njësive vendore për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e aksesit në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara;
- Bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e procesit të shpërndarjes së banesave në 61 njësitë vendore;
- Sigurimi i marrëveshjeve të partneritetit publik-privat (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social dhe rritjen e numrit të familjeve përfituese me 20%;

<sup>1</sup> Në vijim referuar si ligji për strehimin social ose thjesht ligji.

<sup>2</sup> Në vijim referuar si SSS ose Strategjia

<sup>3</sup> Duke qenë se kompetencat për strehimin social janë transferuar ndërmjet ministrive të ndryshme, në vend që t'i përmendin ato me emër, disa pjesë të këtij raporti i referohen ministrisë përgjegjëse për strehimin social thjesht si Ministria.

- Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 30%". (Qeveria e Shqipërisë, 2016, f.37).

Secili objektiv përmban nënobjektiva dhe çështje për trajtim, të cilat konkludojnë në rezultate të pritshme. Më tej, për çdo nënobjektiv ka një sërë aktivitete të renditura, përfshirë këtu edhe afatet kohore, rezultatet dhe treguesit, buxhetin, donatorët e mundshëm dhe institucionet zbatuese, si edhe rreziqet e masat për zbutjen e tyre. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe i arritjes së rezultateve bazohet në një listë prej 39 treguesish, të cilët do të furnizojnë me informacion raportet vjetore të monitorimit që do të hartohen nga drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për strehimin social. Krahas vlerësimit të ecures së zbatimit të Strategjisë, treguesit janë përcaktuar në mënyrë të atillë që t'u japin bashkive dhe, rrjedhimisht, Ministrisë, mundësinë për të zhvilluar një bazë të dhënash për strehimin social në nivel kombëtar, me informacione të ndara sipas bashkive.

Si përfundim, Strategjia jep një përlogaritje të kostos së përgjithshme për zbatimin e saj prej rreth 7,3 miliardë lekë, prej të cilave rreth 5,7 miliardë lekë ose 78% e totalit, duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit për projektet dhe subvencionimin e programeve të strehimit.

## 2. Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e vlerësimit

Vlerësimi afatmesëm i rezultateve të zbatimit të Strategjisë së Strehimit Social u ndërmor si një hap i detyrueshëm në monitorimin e ecures së Strategjisë dhe të nevojës për përmirësim.

Vlerësimi afatmesëm për Strategjinë e Strehimit Social merr një qasje vlerësimi realist, përmes së cilës analizohet marrëdhënia mes *kontekstit*, *mekanizmit* dhe *rezultatit* (siç përcaktohet në Strategji, shih edhe Milligan *et al.* 2007), duke çuar në gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e Strategjisë. Vlerësimi afatmesëm i Strategjisë është një vlerësim në nivel politik. Ai përqendrohet te vlerësimi i objektivave dhe synimeve kombëtare, duke përdorur treguesit e Strategjisë dhe perceptimin e grupeve të interesit mbi performancën e strategjisë dhe të mekanizmave që ajo përdor. Për ta arritur këtë, ekipi përgjegjës për vlerësimin afatmesëm ka kryer hulumtime lidhur me sa vijon:

- **Kontekstin** në të cilin strategjia është hartuar dhe zbatuar deri më sot, si dhe marrëdhënien e tij shkak-pasojë me procesin e zbatimit dhe arritjen e rezultateve. Faktorët kontekstualë janë të brendshëm dhe të jashtëm në raport me qëllimin e strategjisë dhe planin e saj të veprimit. Aspektet e brendshme janë ato që i kanë dhënë formë kërkesës për strehim social në katër vitet e fundit që prej miratimit të Strategjisë. Më konkretisht, për këtë vlerësim, konteksti i jashtëm ka përfshirë: procesin e integritimit në BE, ndikimin e tërmetit të 26 nëntorit 2020, ndikimin e COVID-19, ndryshimet madhore institucionale, strategjitë e tjera sektoriale që janë miratuar dhe po vihen në zbatim, statusin e financave për strehimin social, legjislativacionet e tjera sektoriale të ndryshme nga strehimi social.
- **Mekanizmat** që janë përdorur nga strategjia, pra masat për zbatim, si dhe faktin nëse zbatimi i tyre ka qenë faktori i vetëm që ka ndikuar te rezultatet. Për të kuptuar nëse faktorët biheviore, shoqërorë, institucionale, etj., që qëndrojnë në themel të të dhënave të vrojtueshme, kanë pasur ndikim te rezultatet, (Milligan *et al.* 2007) rast në të cilin lidhja me kontekstin është e një rëndësie thelbësore, nevojitet një farë dimensiononi ontologjik.

- **Rezultatet** që synohen të arrihen deri në vitin 2020. Për shkak të natyrës afatmesme të vlerësimit, nuk ishte e mundur që të ravijëzoheshin rezultatet reale, të cilat pritet të materializohen nga fundi i periudhës së vlefshmërisë së strategjisë dhe ndoshta edhe përtej saj. Megjithatë, deri më tani, vlerësimi ka marrë në vëzhgim produktet/synimet dhe rezultatet për fazën e dhënë të zbatimit të Strategjisë, si edhe treguesit përkatës, siç përcaktohen në Strategji. Këto janë vlerësuar nga aspekti i efektivitetit, efikasitetit, rëndësisë dhe përshtatshmërisë (Rogers *et al.* 2005; Milligan *et al.* 2007; MacDonald and Tempest 2018).

**Mekanizmat dhe rezultati** janë vlerësuar për nga aspekti i *rëndësisë, efektivitetit dhe efikasitetit*, siç përkufizohen në termat e referencës së detyrës së vlerësimit afatmesëm. Megjithatë, krahas këtyre tri aspekteve të nevojshme, vlerësimi ka shqyrtuar edhe përshtatshmërinë e masave (paralelisht me rëndësinë e tyre), partneritetet e krijuara me qëllim zbatimin e mekanizmave, si dhe sistemin qeverisës të vënë në zbatim nga të gjitha grupet e interesit gjatë 4 viteve të fundit për performancën në sektorin e strehimit social dhe arritjen e synimeve afatmesme të strategjisë. Partneritetet janë konsideruar gjithashtu si një formë qeverisjeje. Për secilin prej aspekteve të vlerësimit, janë formuluar pyetje kërkimore, të tilla si:

*Rëndësia dhe përshtatshmëria:* Sa të rëndësishme dhe të përshtatshme janë propozimet e strategjisë me kontekstin (duke përfshirë ndryshimet kontekstuale)? Në ç'shikullë dhe me sa efektivitet u është përgjigjur strategjia dhe plani i saj i veprimit nevojave të grupeve të synuara, duke rezultuar në përshtatshmëri të objektivave dhe masave? Në ç'masë janë fushat aktuale strategjike të fokusit dhe qasjet aktuale të planit të veprimit ende të pajtueshme dhe të përshtatshme me kontekstin e zhvillimit të ndryshueshëm?

*Efektiviteti (për rezultatin dhe procesin):* Në ç'masë janë përmbushur parimet, objektivat, aktivitetet, rezultatet dhe synimet e strategjisë për periudhën përkatëse të vlerësimit? Sa përfituesve nga kategoritë e përcaktuara me ligj u është mundësuar aksesimi në strehimin social dhe cili është raporti i tyre me numrin e aplikantëve? Cilat janë sfidat e hasura deri më tani në realizimin e planit të veprimit? Cilat janë mësimet e nxjerra dhe rekomandimet kryesore në realizimin e planit të veprimit?

*Efikasiteti:* Në ç'masë ka ndikuar deri më tani vënia në përdorim dhe alokimi i burimeve dhe procedurave në realizimin e strategjisë (sipas planit, duke arritur rezultate më të mira dhe duke tejkaluar pritshmëritë, duke shkaktuar vonesa dhe pengesa ndaj zbatimit)? Sa i mjaftueshëm dhe i aksesueshëm ka qenë alokimi i burimeve për arritjen e rezultateve (sipas planit, nevojiteshin më shumë burime, nevojiteshin më pak burime, kostoja për njësi e output-it përkundrejt input-it për alternativat e ndryshme apo përkundrejt synimeve të përcaktuara për përdorimin e burimeve)? Cilat kanë qenë sfidat dhe mangësitë në vënien në përdorim dhe alokimin e burimeve?

*Partneritetet:* Në ç'masë dhe në ç'mënyrë kanë ndihmuar dhe kontribuar partneritetet e krijuara në kuadër të zbatimit të strategjisë në arritjen/përmirësimin e efektivitetit dhe/ose efikasitetit në realizimin e planit të veprimit dhe arritjen e rezultateve/përfundimeve?

*Qeverisja:* Në ç'masë dhe në ç'mënyrë kanë ndihmuar dhe kontribuar strukturat qeverisëse të miratuara në arritjen/përmirësimin e efektivitetit dhe/ose efikasitetit në realizimin e planit të



veprimit dhe arritjen e rezultateve/përfundimeve? Çfarë lloj përmirësimesh mund t'u bëhen mekanizmave të qeverisjes për strehimin social?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ekipi i vlerësimit ka shfrytëzuar instrumentet e mëposhtme:

- Shqyrtimin e dokumentacionit, legjislacionit dhe strukturës institucionale për sektorin e strehimit social.
- Intervistat me informatorët kyçë, të kryera me grupet institucionale të interesit në nivel kombëtar, duke përfshirë jo vetëm ministritë dhe agjencisë përkatëse, por edhe shoqatat e aktorëve joshitetërorë të interesuar.
- Një anketë me pyetje të mbyllura drejtuar të 61 bashkive, me fokus zbatimin e strategjisë në nivel vendor.
- Një numër të kufizuar intervistash vijuese me përfaqësues të drejtorive të strehimit në bashkitë e përzgjedhura, me synimin për të kuptuar më mirë gjetjet e anketës.
- Mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Strehimit Social për diskutimin dhe miratimin e rekomandimeve të vlerësimit që do të zbatohen në versionin e rishikuar të strategjisë dhe planit të veprimit.

### 3. Analiza e kontekstit

#### 3.1 Procesi i integrimit në BE

Më 25 mars 2020, Këshilli i Evropës vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, mbi bazën e një sërë kushteve. Në këtë kuadër, përpara konferencës së parë ndërqeveritare, Shqipëria duhet të adresojë pesë prioritetet kyçe si një hap paraprak për të nisur shqyrtimin e krerëve të *Acquis Communautaire*. Hapja e negociatave është me rëndësi madhore për Shqipërinë, si dhe për sektorin e strehimit social, ndonëse strehimi social nuk përfshihet në politikat thelbësore të BE-së dhe mbetet ekskluzivisht nën tutelën e shteteve anëtare. Megjithatë, strehimi njihet si një nga të drejtat themelore të njeriut në Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore, e cila, në nenin 34 të saj (siguria sociale dhe ndihma sociale) parashikon se “për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë, BE-ja njeh dhe respekton të drejtën për ndihmë sociale dhe strehim social ...” (Bashkimi Evropian, 2012, f. 402). Të drejtat themelore trajtohen në kreun 23, i cili është një prej krerëve kryesore që do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe negociimit. Qeveria e Shqipërisë raporton mbi strehimin social nën titullin “Të drejtat themelore”, dhe gjatë viteve 2019-2020, për sa u përket akteve nënligjore për strehimin social, Drejtoria e Strehimit i dha prioritet parësor vendimit të Qeverisë “Për procedurat e zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional”. Ky akt nënligjor u miratua në maj të vitit 2019 me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 361, dhe u hartua në përputhje me udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi dëbimet dhe rivendosjet, duke përfshirë procedurat, afatet kohore dhe bashkëpunimin institucional për rastet e sistemimit. Vendimi zbatohet në mënyrë universale për të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht nëse gëzojnë apo jo titull pronësie mbi banesën. Vendimi nr. 361 thekson se shtetasit nuk do të dëbohen me forcë nga vendbanimi apo strehimi i tyre, derisa të sigurohet një zgjidhje e përshtatshme për ta në kuadër të programit të strehimit social.

Për më tepër, kreu 19 i Acquis Communautaire trajton politikën sociale dhe punësimin, ku përfshirja dhe mbrojtja sociale përfshin edhe praktikën e strehimit social. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka alokuar përafërsisht 670 milionë lekë për periudhën 2019-2020 për zbatimin e projektit "Përmirësimi i kushteve të jetesës për grupet e varfra dhe vulnerabël. Nga ky projekt (investimet për përmirësimin e banesave, infrastrukturës, furnizimit me ujë dhe objekteve sanitare) kanë përfituar 1516 familje. Familjet e komunitetit rom dhe egjiptian përbëjnë 42% të numrit total të përfituesve. Gjatë po kësaj periudhe, shteti ka alokuar përafërsisht 3,2 miliardë lekë për të ndihmuar familjet e varfra dhe vulnerabël për përballimin e qirasë në tregun privat të banesave. Nga kjo shumë, 2,9 miliardë janë alokuar për subvencionimin e qirasë për banesat në treg, për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e tërmetit. 1880 familje të varfra dhe vulnerabël kanë përfituar nga subvencionin për qiratë, prej të cilave 15,9% e totalit janë familje të komunitetit rom dhe egjiptian.

Procesi i integritimit në BE supozohet të mos ketë pasur ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e strehimit social në Shqipëri gjatë periudhës 2016-2020, duke pasur parasysh faktin se strehimi social përbën një politikë ekskluzive të shteteve. Në këtë pikëpamje, legjislativi për strehimin social nuk është hartuar në transpozim të ndonjë direktive të posaçme të BE-së. Megjithatë, duke qenë se strehimi social është pjesë e sektorit social dhe të zhvillimit, ai preket nga direktiva dhe procese të tjera zyrtare që lidhen me integrimin në BE. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë tashmë një qasje ndaj politikës së strehimit social e cila është në një linjë me përpjekjet për evropianizim, qofshin ato shoqërore apo politike. Pritet që avancimi i integritimit të ndikojë në zbatimin e politikës së strehimit social. Në njëfarë mënyre, negociatat lidhur me krerë specifike do të kenë ndikim mbi zbatimin e politikës dhe programeve të strehimit social për grupe të ndryshme përfituesish.

### **3.2 Tërmeti i 26 nëntorit 2020**

Efektet shkatërruese të tërmetit lanë shumë familje të rajonit Tiranë-Durrës<sup>4</sup> në kushte të papërshtatshme strehimi, ndërsa shumë të tjera mbetën të pastreha. Kësisoj, krahas kategorive të komuniteteve që aplikojnë për regjistrim në programet e strehimit social (të përcaktuara me ligj), grupeve në nevojë për strehim social iu shtua edhe një bashkësi tjetër familjesh (me statuse të ndryshme socio-ekonomike). Tërmeti i datës 26 nëntor 2019 ishte i paprecedentë në 40 vitet e fundit, dhe nxori në pah disa prej sfidave të lëna në harresë në fushën e ndërtimit të qyteteve dhe planifikimit urban në Shqipëri. Sigurisht, një ndër sektorët e prekur në mënyrë më të drejtpërdrejtë e më të theksuar ishte sektori i strehimit.

Në vijim të ngjarjes, Qeveria e Shqipërisë kreu një vlerësim të nevojave pas fatkeqësisë, i cili shërbeu si bazë për mbledhjen e ndihmave financiare dhe nisjen e procesit të rehabilitimit të [banesave]. Ky vlerësim i nevojave pas fatkeqësisë (Këshilli i Ministrave dhe të tjerë, 2020) thekson disa prej ndikimeve më të konsiderueshme të tërmetit tek aspekte të ndryshme socio-ekonomike, duke përfshirë edhe strehimin. Sipas këtij vlerësimi<sup>5</sup>, një numër total prej 11 490 njësisish banimi pësuan kishin pësuar dëme të rënda apo ishin shkatërruar, dhe kishin nevojë për zëvendësim; 18 980 njësi banimi kishin pësuar dëme

<sup>4</sup> 11 bashkitë e prekura nga tërmeti janë: Tirana, Durrësi, Shijaku, Kurbini, Mirdita, Kruja, Lezha, Rrogozhina, Kavaja, Vora, Kamza

<sup>5</sup> Në vijim referuar si VNFN

mesatare apo të pjesshme, dhe mbi 64 000 kishin pësuar vetëm dëme të lehta (Council of Ministers; European Union; United Nations Agency; The World Bank, 2020). Ç'është e vërteta, sektori i strehimit pësoi rreth 85 % të totalit të dëmeve dhe humbjeve të identifikuar, me humbje të përlllogaritura në vlerën 662,30 milionë euro. Rreth 65% e këtyre humbjeve u regjistruan në Bashkitë e Tiranës dhe të Durrësit, ndërsa për 9 bashkitë e tjera të prekura, vlera e humbjeve varion nga 73 milionë deri 4 milionë euro.

Sipas vlerësimit VNFN, pjesa më e madhe e dëmeve është identifikuar në njësitë e banimit të ndërtuara përpara vitit 1993, për shkak të tipologjisë së ndërtimit: banesa me muraturë të papërfortuar, të ndërtuara me qerpiç ose mure me tulla argjile apo blloqe betoni. Megjithatë, statusi social dhe ekonomik i familjeve të prekura mbetet i paqartë, dhe tipologjia e ndërtesave nuk përbën tregues të këtij statusi.

Masat për akomodim të përkohshëm të popullsisë së prekur, të përcaktuara me akte nënligjore,<sup>6</sup> u menaxhuan nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Sipas VNFN-së, rreth 17 090 persona u akomoduan në hotele (25% ose 4324) dhe në çadra (75% ose 12 766). Pjesa tjetër u strehuan në banesat e familjarëve apo miqve të tyre apo në banesa të marra me qira, ndërsa rreth 1000 persona u zhvendosën drejt Kosovës (Këshilli i Ministrave, Bashkimi Evropian, Agjencia e Kombeve të Bashkuara, Banka Botërore, 2020). Ndërkohë, u ofrua një program i subvencionimit të qirasë për personat që gjetën vetë strehim të përkohshëm.

Ofrimi i mundësive të përkohshme të akomodimit nuk u përshtat sipas nevojave të posaçme të grupeve specifike, si p.sh. të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë shtatzëna, por trajtoi vetëm nevojën imediate për strehim pas tërmetit. Në vijim, u ofrua mbështetje psikosociale për personat në nevojë. Sipas raportit të VNFN-së, kjo mbështetje u ofrua më së shumti për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, të cilët kishin nevojë për kujdes social dhe shëndetësor për shkak të sëmundjeve të tyre kronike. Personat e akomoduar në çadra nuk kishin kushte ngrohjeje (75%). Fëmijët përbënin 22% të popullsisë së akomoduar në hotele dhe çadra, ndërsa 17% e tyre (ose rreth 2873 fëmijë) qëndronin në çadra me rrezik më të lartë sëmundjesh për shkak të të ftohtit dhe kushteve të përgjithshme (Council of Ministers; European Union; United Nations Agency; The World Bank, 2020). Së fundi, sipas raportit të VNFN-së, rreth 356 nga familjet e prekura i përkisnin komunitetit rom dhe egjiptian.

Aktualisht, ndërkohë që programi i qeverisë shqiptare për rindërtimin është ende në vazhdim, ka ende familje të strehuara në çadra apo që i kanë dhënë vetë zgjidhje situatës së tyre. Deri më sot, nuk disponohen të dhëna zyrtare rreth situatës së akomodimit të personave të prekur. Të vetmet të dhëna ekzistuese janë ato nga raportimet e atyketushme në media apo të dhënat sporadike të raportuara nga bashkitë e prekura në anketën e kryer për qëllimet e këtij raporti vlerësimi.

Pasojat e përgjithshme të tërmetit në sektorin e strehimit përlllogariten në vlerën 696,3 milionë euro (85,68 miliardë lekë), me dëme totale në vlerën 662,3 milionë euro (81,50 miliardë lekë) dhe humbje totale të përlllogaritura në vlerën 34 milionë euro (4.18 miliardë lekë). Kostot e dëmtimeve përfshijnë si ndërtesat e dëmtuara ashtu edhe mobilet dhe sendet vetjake të shkatërruara. Humbjet e regjistruara

---

<sup>6</sup> VKM 754, datë 30.11.2019, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarve për shkak të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, në strukturat akomoduese"

përfshijnë kostot që lidhen me pastrimin e mbetjeve, kostot që mbulojnë strehimin e përkohshëm (kostot e ngritjes së çadrave dhe akomodimit në hotele dhe bonuset qeveritare të qirasë), si dhe humbjet në qira nga pronarët e banesave/apartamenteve të dëmtuara.

Tabela 1. Dëmet dhe humbjet e përlogaritura nga tërmeti i 26 nëntorit

Bashkia	Dëme të lehta	Dëme të pjesshme	Shkatërrim total	Sendet shtëpiake	Dëme në total	Pastrimi i mbetjeve	Humbjet në qira (1 vit)	Ofrimi i strehëve të përkohshme	Humbjet në total
	<i>Dëme në milionë euro</i>					<i>Humbje në milionë euro</i>			
Durrës	69,6	61,1	61,6	6,8	208,6	4,3	0,25	7,65	12,2
Shijak	4,1	7,4	35,7	2,9	50,2	2,2	0,1	0,3	2,6
Krujë	7,4	13,7	4,4	3,6	69,7	2,8	0,2	0,3	3,3
Lezhë	3,6	5,6	10,4	0,9	20,6	0,6	0,04	0,9	1,54
Mirditë	1,3	1,83	1	0,06	4,3	0,06	-	-	0,06
Kurbin	3,6	6,3	12,4	1	24,1	0,8	0,04	0,4	1,24
Tiranë	54	52,8	84,9	9,2	204,8	5,46	0,68	3,3	9,44
Kamzë	5,6	2,2	5,6	0,4	14	0,35	0,02	0,06	0,43
Vorë	5,1	3,2	27,3	2,1	37,9	1,68	0,09	0,43	2,2
Kavajë	5,5	8,3	12,6	1,2	27,7	0,78	0,04	0,11	0,93
<b>Totali</b>	<b>160,3</b>	<b>163,9</b>	<b>309,4</b>	<b>28,7</b>	<b>662,3</b>	<b>19,03</b>	<b>1,46</b>	<b>13,45</b>	<b>33,94</b>

Burimi: VNFN, 2020

Aktualisht, ekzistojnë një sërë nismash që trajtojnë procesin e rikuperimit pas tërmetit në nivel kombëtar. Nga pikëpamja legjislative, Qeveria e Shqipërisë ka miratuar disa akte nënligjore për të adresuar pasojat e fatkeqësisë natyrore dhe për të përcaktuar kushtet, kriteret, kategoritë e përparësisë, përfitimet, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programi i Rindërtimit.

Sipas VKM nr.5, datë 6.1.2020<sup>7</sup> përfitues të Programit Kombëtar të Granteve të Rindërtimit janë individët dhe familjet që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore. Qeveria vendore është përgjegjëse për menaxhimin e aplikimeve nga familjet e prekura dhe për krijimin, administrimin dhe përditësimin e bazës përkatëse të të dhënave.

Programi i Rindërtimit përcakton disa kategori përfituesish sipas nivelit të dëmtimit të banesave të tyre, vendndodhjes dhe karakteristikave të tjera sociale.

1. Familjet që banojnë në zona urbane, në ndërtesa shumëkatëshe të shembura apo të shpallura të pabanueshme, janë të kualifikueshme për të përfituar një apartamenti të ri qoftë në të njëjtën vendndodhje (zonat e rihvillimit) apo në një vendndodhje tjetër (zonat e reja të zhvillimit). Në disa raste, këto familje mund të kompensohen përmes Fondit për Strehimin.
2. Familjet në zonat urbane, të cilat jetojnë në banesa individuale, do të marrin një banesë në një vendndodhje tjetër ose do të përfitojnë nga granti i rindërtimit ose nga fondi për strehimin.

<sup>7</sup> VKM nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga Programi i Granteve të Rindërtimit dhe projektet model"

3. Familjet në zonat rurale që kanë humbur banesat e tyre, por ndodhen jashtë zonave të përcaktuara si "zona urbane" të territorit, do të përfitojnë një banesë si pjesë e programit të zhvillimeve të reja ose do të rimbursohen përmes granteve të rindërtimit.
4. Së fundi, familjet banesat e të cilave kanë pësuar dëme, por nuk përfshihen në grupin e banesave të pabanueshme, janë të kualifikueshme për të përfituar financim nga grantet e rindërtimit.

Ndonëse qeveritë vendore kanë mbajtur përsipër përgjegjësinë për të menaxhuar procesin e regjistrimit të përfituesve sipas kriterëve të lartpërmendura, pjesa më e madhe e proceseve administrative i janë ngarkuar nivelit qendror, që nga përcaktimi i zonave të reja të zhvillimit dhe atyre të rihvillimit, e deri te hartimi i planeve të detyruara vendore në 11 bashkitë e prekura, i cili iu delegua Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.<sup>8</sup> Aktualisht, ekzistojnë 39 zona të caktuara rihvillimi, dhe për 22 prej tyre është miratuar plani i detyruar vendor<sup>9</sup>. Faza e zbatimit të këtyre planeve është ende në fillimet e saj.

Programi i rihvillimit parashikon një grant të buxhetuar prej 8 736 419 145 lekësh (rreth 70 692 381 euro) për rindërtimin e banesave individuale, grant i cili do të menaxhohet kryesisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe nga bashkitë. Bashkia e Tiranës ka marrë rreth 20% të këtij buxheti në formën e një granti të pakushtëzuar<sup>10</sup>. Sipas raportimeve nga Drejtoria e Strehimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, një shumë prej 2,9 miliardë lekësh është alokuar nga buxheti i vitit 2020 për subvencionimin e qirave të banesave në treg për rreth 14 000 familje të prekura nga tërmeti.

Ndonëse legjislacioni në mbështetje të rindërtimit përcakton të gjitha procedurat dhe mekanizmat financiare lidhur me dëmtimet fizike të banesave, nuk ekziston asnjë mbështetje e mirëpërcaktuar nga aspekti social për popullsinë e prekur. Aktet nënligjore e trajtojnë çështjen përciptazi, duke bërë thjesht një kategorizim të përfituesve sipas përparësisë, në kategoritë e mëposhtme:

- familjet që kanë humbur pjesëtarë të familjes nga fatkeqësia natyrore;
- familjet me një prind të vetëm, me fëmijë nën varësi, duke përfshirë nënat e reja;
- familjet me persona me aftësi të kufizuara;
- të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit;
- familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike;
- të rënë në krye të detyrës.

Pesë prej këtyre gjashtë kategorive janë pjesë e grupeve të përcaktuara si përfituese të mundshme të strehimit social nga ligji për strehimin social. Megjithatë, akti nënligjor për rindërtimin thjesht i rendit ato të parët në procesin e regjistrimit, dhe nuk parashikon asnjë mënyrë tjetër mbështetjeje për rikuperimin e tyre pas fatkeqësisë. Ç'është e vërteta, në skemën e Politikës dhe Fondit të Rindërtimit mungon një qasje që trajton specifikat e kategorive/nevojave sociale, ndonëse rimëkëmbja socio-ekonomike përbën një prej pesë programeve për zbatim. Në fakt, raporti i VNFN-së konstaton gjithashtu se vlerësimi i dëmeve dhe humbjeve për mbrojtjen sociale është minimal krahasuar me sektorët e tjerë, pasi pjesa më e madhe e tyre janë raportuar si dëme dhe humbje në infrastrukturën e komunitetit dhe në strehim. Në

<sup>8</sup> VKM 9, datë 10.1.2020 "Për caktimin e njësive zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondit për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020"

<sup>9</sup> NTPA, <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=1024>, aksesuar më 21.9.2020

<sup>10</sup> VKM 202, datë 5.3.2020 "Për përdorimin e Fondit të Rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale"

mënyrë të ngjashme, nevojat për rimëkëmbje në fushën e mbrojtjes sociale vlerësohen në shkallën 0,26%, duke rezultuar në nivelin më të ulët nga gjashtë sektorët e marrë në konsideratë.

Procesi i rindërtimit bazohet në module të parapërcaktuara, që variojnë në përmasa sipas numrit të pjesëtarëve të familjes. Për familjet me 2 pjesëtarë, sipërfaqja e përcaktuar e apartamentit është 60-70m<sup>2</sup>; për familjet me 2-4 pjesëtarë 70-80 m<sup>2</sup> dhe për familjet me mbi 5 pjesëtarë jo më pak se 90 m<sup>2</sup><sup>11</sup>. Kjo skemë mund të marrë më mirë në konsideratë përmasat ekzistuese të familjeve, veçanërisht kur ato kanë mbi 3 pjesëtarë, pasi sipërfaqja optimale e banesës nuk duhet të bjerë nën standardin e një sipërfaqeje të barabartë me ose më të madhe se 25m<sup>2</sup>/person<sup>12</sup>. Për më tepër, skema nuk merr parasysh kushtet sociale të përfituesve, veçanërisht kur ata bëjnë pjesë në kategoritë e të moshuarve dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Procesi kombëtar i rindërtimit nuk fokusohet në aspektet sociale dhe ekonomike të komuniteteve vulnerabël dhe atyre në nevojë për strehim social. Në vend të këtyre, ai fokusohet kryesisht në dëmet fizike/humbjet që kanë pësuar ndërtesat dhe infrastruktura fizike (infrastruktura kritike, ajo sociale dhe ajo e shërbimeve utilitare). Ai ka gjithashtu një program rimëkëmbjeje sociale dhe ekonomike, i cili synon lehtësimin e punësimit dhe aksesin në arsim, kujdes shëndetësor, shërbime kulturore dhe shërbime të tjera komunitare për personat e prekur. Nga ana tjetër, nuk disponohet asnjë dokument strategjik për strehimin social që shqyrton thellësisht aspektin socio-ekonomik të tërmetit. Sipas parimit të shmangies së dublikimit të programeve për të njëjtin përfitues, familjet që ishin tashmë përfituese të ndihmave sociale, strehimit social etj., nuk përfituan mbështetje shtesë nga grantet e rindërtimit. Megjithatë, mbetet ende e paqartë se në ç'masë janë prekur nga tërmeti përfituesit e programeve sociale, dhe veçanërisht ata që banojnë në streha sociale. Në dhjetor të vitit 2019 u krye një vlerësim i përciptë i komuniteteve vulnerabël nga World Vision, por ky vlerësim la pa trajtuar aspektet e strehimit social. Ndikimi afatmesëm i tërmetit mbi grupet vulnerabël dhe grupet e personave që përfitonin strehim social përpara tërmetit mbetet ende për t'u vlerësuar. Në anketën e kryer me bashkitë mbi zbatimin e strategjisë së strehimit social, për qëllimet e këtij raporti vlerësimi, bashkive iu kërkua të raportonin mbi numrin total të familjeve të prekura nga tërmeti dhe mbi numrin e familjeve përfituese të programeve të strehimit social që u prekën gjithashtu nga tërmeti. Në kuadër të kësaj ankete, u mblodhën informacioni në vijim. Megjithatë, siç mund të vihet re, jo për të gjitha bashkitë janë raportuar të dhëna mbi të dy treguesit.

Tabela 2. Familjet e prekura nga tërmetet, që përfitojnë nga strehimi social

Bashkitë	Familjet e prekura nga tërmetet në total (numri)	Familjet e prekura nga tërmetet, që përfitojnë nga strehimi social
Devoll	253	23
Kamëz	2827	480
Kavajë	2036	505
Klos	58	58
Krujë	4700	

<sup>11</sup> VKM nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga Programi i Granteve të Rindërtimit dhe projektet model"

<sup>12</sup> Sipërfaqja mesatare e një kati për person në 28 shtetet anëtare të BE-së është 42,56 m<sup>2</sup> (KE, [https://ec.europa.eu/energy/content/housing-space-person\\_en](https://ec.europa.eu/energy/content/housing-space-person_en))

Lezhë		389
Poliçan	68	
Tiranë		2762
Tropojë	10	
Vorë	2589	-
Totali i përgjithshëm	12 541	4218

Burimi: Anketa e kryer me bashkitë gjatë periudhës shtator-tetor 2020


### 3.3 COVID-19 dhe strehimi social

Më 9 mars 2020, u shpall zyrtarisht shpërthimi i pandemisë COVID-19 në Shqipëri, me raportimin e rastit të parë të një të infektuari nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fill pas kësaj, qeveria zbatoi një politikë të rreptë izolimi me një tregues ashpërsie prej mbi 80%, gjatë muajve mars dhe prill të vitit 2020. Kjo politikë përfshinte, ndër të tjera, vendosjen e orës policore, ndalimin e përdorimit të transportit publik dhe të hapësirave publike dhe karantinimin për 14 ditë të personave të dyshuar si të infektuar. Zbatimi i këtyre masave ishte një sfidë e madhe për ekonominë dhe popullsinë në përgjithësi, e veçanërisht për grupet vulnerabël, të tilla si personat e pastrehë, personat e komunitetit rom dhe egjiptian të cilët nuk kanë një vendbanim fiks, familjet me një prind etj., të cilët nuk kishin apo nuk mund të përballonin një strehim të përshtatshëm. E teksa në shumë vende trumpetohej slogani “qëndro në shtëpi” për parandalimin e përhapjes së virusit, kjo frazë ishte e pakuptimtë për disa grupe vulnerabël. Në një dokument pozicioni, Housing Europe<sup>13</sup> theksoi se “*#QëndroNëShtëpi është e lehtë për t’u thënë, por e vështirë për t’u bërë për një pjesë të madhe të popullsisë së BE-së!*”. Duke qenë se problematika e strehimit përbën një emergjencë si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë vendor, dhe kërkon përgjigje njëjloj si pasiguritë e tjera të shkaktuara nga COVID-19, lipset gjetja e zgjidhjeve afatshkurtra dhe afatgjata në nivel politik dhe lokal, sa më pranë njerëzve.

Shifrat në vijim tregojnë përhapjen e COVID-19 në muajt tetor dhe nëntor. Numri total i të infektuarve është dyfishuar që atëherë, por tendencat mbeten të ngjashme në kohë.


Figura 1. Shifrat e COVID-19 në datat 14 tetor dhe 8 nëntor 2020

<sup>13</sup> <https://www.housingeurope.eu/resource-1376/stayathome-and-europe-s-housing-crisis>



Burimi: Autorët janë bazuar në të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe "Open Data Albania"<sup>14</sup>

Figura 2. Numri total i personave të infektuar në nivel lokal, 8 nëntor 2020



<sup>14</sup> Të dhëna nga <http://open.data.al/covid-19/#ligje-section>, aksesuar më 15 tetor 2020.



Burimi: Autorët janë bazuar në të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe "Open Data Albania"<sup>15</sup>


Gjatë periudhës së izolimit në muajt mars-maj 2019, bashkitë u gjendën përballë sfidës për të ofruar shërbime të rregullta vendore (duke përfshirë strehimin social), krahas detyrimit për t'iu përgjigjur nevojës së qytetarëve vulnerabël për ushqim dhe materiale mjekësore (Toto dhe të tjerë, 2020).

Të dhënat mbi COVID-19 në 11 bashkitë e prekura nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019 tregojnë se tri bashki (Rrogzhinë, Vorë dhe Shijak) kishin një numër total infektimesh prej më pak se 40 persona secila deri në datën 14 tetor 2020. Shtatë bashkitë e tjera raportojnë numra 3-shifrorë, me 151 infektime të regjistruara në Mirditë deri në datën e fundit të raportimit, dhe 989 raste të regjistruara në Durrës. Tirana përbën përjashtim me 7095 të infektuar deri në 14 tetor dhe me tendenca vazhdimisht në rritje. Në nivel qarku, Tirana mbetet më e prekura si për sa i përket numrit total të infektimeve, ashtu edhe për sa i përket numrit të personave të infektuar për çdo 10 000 banorë. Treguesi i dytë është qartësisht më i lartë në qarqet në veri të Tiranës, me përjashtim të Dibrës, e cila ka pasur numrin më të ulët të personave të infektuar për çdo 10 000 banorë, si në datën 14 tetor ashtu dhe në 8 nëntor. Disa raporte të hartuara nga qeveria shqiptare gjatë viteve të fundit lidhur me pabarazitë rajonale, tregojnë se disa prej qarqeve më të prekura nga COVID-19 janë njëkohësisht më të pafavorizuarat nga aspekti socio-ekonomik. Megjithatë, kjo gjetje nuk është e vërtetë për Dibrën, e cila, ndonëse është një qark mjaft i pafavorizuar, duket se është prekur më pak nga infektimet me COVID-19 sipas të dhënave të regjistruara. Kjo mund t'u atribuohet mundësive më të pakta të lëvizjes dhe aksesit në transport krahasuar me qarqet e tjera, ndonëse nuk është kryer ende një vlerësim i strukturuar për të kuptuar tendencat e përhapjes së infeksionit.

Në Shqipëri, deri më tani, COVID-19 ka rezultuar me morbiditet më të lartë te të rinjtë dhe me vdekshmëri më të lartë te të moshuarit (figura 3). Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e personave të prekur bëjnë pjesë në grupmoshat 30 deri në 59 vjeç, të cilët përbënin 55% të numrit total të infektimeve në 14 dhjetor 2020, ndërsa numri më i lartë i vdekjeve është regjistruar për grupmoshat 60+, me 76% të rasteve. Grupmosha 50-59 përbën një kategori ndërmjetëse, me morbiditet dhe mortalitet në vlera të ngjashme, përkatësisht 18% dhe 16%.

Figura 3. Morbiditeti (infektimet) dhe vdekshmëria (vdekjet) në Shqipëri


<sup>15</sup> Të dhëna nga <http://open.data.al/covid-19/#ligje-section>, aksesuar më 15 tetor 2020.



Burimi: Të dhëna nga koronavirusi në Shqipëri, 14 dhjetor 2020, <https://coronavirus.al/statistika/>.

Ndonëse numri i vdekjeve është aktualisht më i lartë mes grupmoshave më të mëdha, në Shqipëri po pëson rritje edhe treguesi i varësisë ndaj të moshuarve. Në nivel kombëtar, vlera është 21,6% për vitin 2020, çka tregon raportin ndërmjet numrit të personave në moshën 65 vjeç e lart (mosha kur janë përgjithësisht joaktivë nga pikëpamja ekonomike) dhe numrit të personave në moshat 15-64 vjeç.


Figura 4. Varësia ndaj të moshuarve ndër vite



Burimi: Plani i përbashkët i bazuar në popullimin e të dhënave nga INSTAT-i.

Në nivel qarku (figura 5), vlerat më të larta janë regjistruar në Gjirokastrë dhe Lezhë, pasuar nga Kukësi dhe Berati. Kjo situatë territoriale mund të ndryshojë në vitin 2020. Nëse përdorim raportin e vitit 2018, Kukësi dhe Lezha janë gjithashtu dy prej qarqeve më të prekura nga COVID-19. Në njëfarë mënyre, rritja e raportit të varësisë ndaj të moshuarve sjell sfida më të mëdha për qeverinë/qeveritë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes nga COVID-19 për një kategori specifike grupesh vulnerabel, sipas moshës.

Figura 5. Varësia ndaj të moshuarve sipas qarkut, 2018



Burimi: Plani i përbashkët i bazuar në popullimin e të dhënave nga INSTAT-i.

Shqetësimet në rritje lidhur me strehimin [social] pas shpërthimit të pandemisë së COVID-19 u vunë re në shumë vende, ku qeveritë dhe/ose agjencitë e tjera joshtetërore miratuan masa të përkohshme për të ndihmuar personat më vulnerabël. Për shembull, në Portugali,<sup>16</sup> të gjitha dëbimet dhe shpronësimet u pezulluan deri në përfundim të gjendjes së emergjencës, çka nënkuptonte se askush nuk mund të humbiste banesën deri më 1 maj 2020. Familjet e strehuara në streha sociale kishin gjithashtu mundësinë që të negocionin një ulje të shumës së qirasë apo të kërkonin falje të përkohshme të qirasë. Në Belgjikë,<sup>17</sup> mbyllja e përkohshme dhe e kufizuar e strehave dhe mensave sociale u kthye në një shqetësim të madh. Në muajin mars, Kryqi i Kuq belg hapi një sektor të posaçëm në një prej qendrave të saj për të pastrehët, për të strehuar personat simptomatikë. Nisma të ngjashme u ndërmorën edhe nga qendra të tjera. Shoqata Federale e Agjencive Imobilare dhe të Strehimit në Gjermani theksoi nevojën për partneritete të koordinuara, duke propozuar që qiramarrësit e ndodhur në paaftësi të plotë apo të pjesshme për të shlyer shumatat e qirave për shkak të COVID-19 të kualifikoheshin për të aplikuar për mbështetje në platformën përkatëse që do të krijohet online. Sektori i shoqërive kooperative të strehimit në Itali propozoi masa parandaluese të jashtëzakonshme për të ndihmuar familjet me të ardhura të ulëta të paguanin qiratë. Si në Irlandë (sipas ICSH<sup>18</sup>) ashtu edhe në Spanjë (sipas AVS<sup>19</sup>), qiratë do të përshtaten në mënyrë automatike mbi bazën e të ardhurave. Në rastin e Shqipërisë, u propozua fillimisht një vendim nga Kryeministri për pezullimin e pagesës së qirave të banesave gjatë muajve të izolimit, gjë e cila nuk u prit mirë nga pronarët e banesave. Për rrjedhojë, u mor vendimi përfundimtar për të shtyrë pagesat e qirave nga qiramarrësit (e veçanërisht studentët) deri në heqjen e masave të izolimit. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave miratoi edhe një vendim për shtyrjen e pagesës së kësteve të kredive deri në gusht të vitit

<sup>16</sup> <https://www.rosalux.eu/es/article/1644.covid-19-has-revealed-the-cracks-in-portuguese-welfare.html>

<sup>17</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/belgium-report-covid-19-april-2020\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/belgium-report-covid-19-april-2020_en.pdf)

<sup>18</sup> Irish Council for Social Housing (<https://icsh.ie>).

<sup>19</sup> The Spanish Association of Public Promoters for Social Housing and Land (<https://gestorespublicos.org>).

2020. Vendimet u vunë në zbatim nga Agjencia Kombëtare e Strehimit, për aq sa kishin të bënin me fushën e saj të kompetencës.

### 3.4 Ndryshimet institucionale

Ndryshimi institucional më madhor që prej miratimit të strategjisë së strehimit social ishte shpërbërja e Ministrisë së Zhvillimit Urban në vitin 2017, në vijim të zgjedhjeve kombëtare dhe pasi ajo kishte funksionuar përgjatë kohëzgjatjes së një mandati qeveritar. Fill pas kësaj, funksioni i strehimit social iu transferua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përmes Drejtorisë së Strehimit, nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik. Struktura e drejtorisë përfshin drejtorin dhe katër specialistë. Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 ishte përgatitur nga stafi i ministrisë së mëparshme. Për pothuajse një vit, drejtori i emëruar rishtazi u përfshi në hartimin e legjislacionit për strehimin social, me mbështetjen e avokatëve të ministrisë. Më pas, në vitin 2019, drejtorisë iu shtuan dy ekspertë në sajë të programit të qeverisë për lehtësimin e punësimit të studentëve të diplomuar me rezultate të shkëlqyera. Megjithatë, plotësimi i drejtorisë së strehimit social me stafin e domosdoshëm (dy ekspertë të tjerë) u finalizua jo më herët se fundi i vitit 2020, përkatësisht në shtator dhe nëntor. Në nivel institucional, janë identifikuar dy sfida madhore: 1) Njohuritë e fituara gjatë procesit të hartimit të SSS-së nuk iu transferuan plotësisht drejtorisë së re. 2) Memoria institucionale nuk u ruajt për shkak të ndryshimit tërësor të stafit. Gjithashtu, drejtorja e krijuar rishtazi u përball edhe me sfidën e mungesës së stafit të nevojshëm për rreth dy vite.

### 3.5 Strategjitë dhe programet e tjera

Strategjia është hartuar dhe zbatuar në kuadrin e nismave dhe platformave ndërkombëtare në të cilat merr pjesë edhe Shqipëria, si dhe mbi bazën e strategjive kombëtare që kanë lidhje apo ndikim mbi rezultatet e SSS-së. Më të rëndësishmet në të dy nivelet janë:

*Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ)*, të cilat u miratuan në vitin 2015 nga të gjithë anëtarët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (duke përfshirë edhe Shqipërinë), me synimin për t'u bërë thirrje shteteve anëtare për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të garantuar paqe dhe prosperitet për të gjithë njerëzimin brenda vitit 2030. 17 OZhQ-të janë integruar dhe kanë ndikime plotësuese të njëra-tjetra. OZhQ 1, "Zhdukja e varfërisë" dhe më konkretisht synimi i tij 1.4, bën thirrje për veprim me synimin që "deri në 2030, të sigurohet që të gjithë meshkujt dhe femrat, e veçanërisht të varfrit dhe grupet vulnerabël, të kenë të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike, si dhe akses në shërbimet bazë, pronësi dhe kontroll mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimi, burime natyrore, teknologji të reja të përshtatshme dhe shërbime financiare, duke përfshirë mikrofinancën". Ky synim është me rëndësi të madhe për sa i përket aksesit dhe pronësisë mbi tokën dhe banesën. Ndërkohë, OZhQ 11, i cili fokusohet te qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme, e veçanërisht synimi 11.1, fokusohet te strehimi social dhe i përballeshëm. OZhQ 11.1 synon të garantojë, brenda vitit 2030, aksesin e çdo individi në një strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballeshëm dhe në shërbimet bazë, si dhe përmirësimin e lagjeve të varfra. Shqipëria i ka integruar synimet e OZhQ-ve në kuadrin e saj të planifikimit strategjik, dhe mbi 80% e synimeve të OZhQ-ve janë përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Gjithashtu, OZhQ-të përbëjnë një element të rëndësishëm të Planit të

Përgjithshëm Kombëtar Territorial, si dhe janë përfshirë në strategji të tjera sektoriale. *Për rrjedhojë, ato luajnë një rol të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Strehimit Social dhe të Përballueshëm.*

*Habitat III – Axhenda e re urbane* u miratua në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Strehimin dhe Zhvillimin Urban të Qëndrueshëm (Habitat III) në Quito, Ekuador, më 20 tetor 2016. Axhenda urbane është përkthyer në shqip dhe është përdorur nga ish Ministria e Zhvillimit Urban si dokument udhëzues për planifikimin territorial dhe planet në nivel kombëtar dhe vendor. Axhenda e re urbane mbështet zbatimin e OZhQ-ve në kontekste urbane, dhe veçanërisht atë të OZhQ 11 për qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme. Si pjesë e axhendës së re urbane, qytetet dhe komunitetet duhet të përmbushin “*të drejtën për strehim të përshtatshëm si element i së drejtës për një standard të mjaftueshëm jetese, pa diskriminim*”. Në këtë kuadër, anëtarët bien dakord të zhvillojnë politika strehimi që përkrahin vizionin e mësipërm dhe janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës, si dhe t’u kushtojnë vëmendjen e duhur politikave që nxisin strehim me akses dhe vendndodhje të përshtatshme. Gjithashtu, anëtarët duhet të nxisin *opsione të përshtatshme strehimi të cilat janë të sigurta, të përballueshme dhe të aksesueshme për anëtarë të shoqërisë me grupe të ndryshme të ardhurash, duke marrë në konsideratë integrimin socio-ekonomik dhe kulturor të komuniteteve të marxhinalizuara, personave të pastrehë dhe personave në situata të pafavorshme, si dhe duke shmangur segregimin*. Një tjetër element i rëndësishëm është nxitja e politikave dhe masave që garantojnë akses për *personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë strehimin*. Axhenda e re urbane kërkon marrjen e masave nga autoritetet (kombëtare, lokale dhe vendore) për të garantuar *përmirësimin dhe rikonstruktimin e të gjitha banesave për t’i bërë ato të qëndrueshme ndaj fatkeqësive*. Planifikimi urban luan një rol të rëndësishëm në axhendën urbane, dhe si i tillë, ai kërkon që të gjitha planet urbane të veprojnë si duhet për ofrimin e zgjidhjeve shumëfunksionale dhe opsioneve të përballueshme të strehimit. Në këtë kuadër, inkurajohet edhe zhvillimi i politikave dhe strategjive të zhvillimit në nivele të ndryshme qeverisjeje me anë të qasjeve të pjesëmarrjes në planifikim. *Axhenda nxit gjithashtu krijimin e skemave të larmishme të ofrimit të strehimit, duke përfshirë përmirësimet e lagjeve informale dhe atyre të varfra, si dhe prioritizimin e skemave të strehimit me vendndodhje dhe shpërndarje të përshtatshme për të shmangur zhvillimet në masë të njëjësive periferike dhe të izoluar të strehimit*.

*Karta e Gjenevës e OKB-së për Strehim të Qëndrueshëm*, miratuar më 16 prill 2015 nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën, është një dokument pa fuqi ligjore detyruese që synon të mbështesë shtetet anëtare në garantimin e aksesit në strehim të mirë, të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të shëndetshëm për të gjithë. Dokumenti është përkthyer në gjuhën shqipe. Objekti i Kartës është *përmirësimi i qëndrueshmërisë së strehimit* në rajonin e KEE-së përmes politikave dhe masave efikase në të gjitha nivelet. Karta bazohet në katër parime kryesore që garantojnë strehim të qëndrueshëm, të cilat janë mbrojtja e mjedisit; efektiviteti ekonomik; përfshirja dhe pjesëmarrja sociale dhe përshtatshmëria kulturore. Karta nxit fuqishëm *disponueshmërinë e opsioneve të shumta të strehimit, e veçanërisht të strehimit të përballueshëm dhe social, përmes instrumenteve të ndryshme*. Planifikimi i hapësirës konsiderohet si një prej mjeteve kryesore për arritjen e strehimit të përballueshëm dhe social. Qeveritë e niveleve të ndryshme duhet të hartojnë politika mbi bazën e parimit të përfshirjes sociale, për krijimin e instrumenteve të mbështetjes që garantojnë akses në strehim dhe nxisin kohezionin social.

*Axhenda Urbane e BE-së*: me aspiratën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE, Axhenda Urbane (pakti i Amsterdimit) është një prej dokumenteve kryesore që fokusohet posaçërisht te zonat urbane. Ajo është konceptuar si një mjet për të garantuar shfrytëzimin maksimal të potencialit të qyteteve për rritje dhe trajtimin me sukses të sfidave sociale, përmes nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare, qyteteve dhe Komisionit. Pakti i Amsterdimit është hartuar mbi bazën e 12 partneriteteve që trajtojnë 12 sfida urbane. *Partneriteti 4 fokusohet te strehimi*, me objektivin për të garantuar strehim të përballueshëm e me cilësi të lartë, dhe me fokus të posaçëm te strehimi publik i përballueshëm, rregullat e ndihmës shtetërore dhe politika e përgjithshme e strehimit.

*Strategjia Kombëtare Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)* është dokumenti kryesor strategjik në nivel kombëtar që koordinon prioritetet e integritit evropian dhe OZhQ-ve me ato të qëllimeve të qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore në vend. Strategjia u finalizua në vitin 2020 dhe një strategji e re pritet të përgatitet për periudhën 2021-2026. Një prej elementeve kryesore të vizionit të saj është *garantimi i të drejtave themelore të njeriut, të cilat përfshijnë deri në njëfarë pike edhe strehimin*. Strategjia bazohet në katër shtylla bazë, si rritja përmes qëndrueshmërisë makroekonomike dhe fiskale; rritja ekonomike përmes rritjes së konkurrencës dhe novacionit; investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezioni social; përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe zhvillimi territorial. *Përfshirja sociale është një prej objektivave që lidhen me aspektin e strehimit social, ndonëse kjo nuk citohet shprehimisht në strategji*. Në shtyllën e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve, energjia luan një rol të rëndësishëm. Objektivi është që Shqipëria të përmbushë angazhimin e saj në kuadër të strategjisë 20/20/20. SKZHI nxit përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë në ndërtesa. Në të njëjtën shtyllë përfshihet edhe tema e planifikimit të hapësirës dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, ekzistojnë *dy objektiva kryesore strategjike*, konkretisht përmirësimi i zhvillimit urban përmes përgatitjes së instrumenteve të planifikimit territorial në të gjitha nivelet dhe *përmirësimi i sektorit të banesave me anë të rritjes së efikasitetit të energjisë, rikonstruktimit të banesave që datojnë përpara vitit 1993 dhe përmirësimin të drejtpërdrejtë të kushteve të strehimit të komuniteteve romë dhe egjiptiane*.

*Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2030 (PPKT)* u hartua gjatë viteve 2014-2016. Ky instrument renditet i pari në hierarkinë e sistemit shqiptar të planifikimit. PPKT-ja ofron një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e Shqipërisë në harkun e 15 viteve të ardhshme. Dokumenti lidhet ngushtë me OZhQ-të, axhendën e re urbane dhe synimet e BE-së. *Plani promovon zhvillimin shumëfunksional, zonimin përfshirës dhe rigjenerimit dhe rivitalizimin e vendbanimeve urbane. PPKT-ja promovon strehimin e përballueshëm në zonat urbane, alternativat lehtësisht të aksesueshme dhe të ndërlydhura të strehimit, si dhe rritjen e efikasitetit të energjisë dhe të përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme në sektorin e strehimit*. Megjithatë, *PPKT-ja nuk bën parashikime të drejtpërdrejta për sa i përket strehimit social dhe të përballueshëm*. Ajo parashikon parime të ndryshme dhe fusha të ndryshme ndërhyrjeje me të cilat qeveria vendore mund të punojë përmes planeve të tyre të përgjithshme vendore territoriale.

*Plani i Integruar Ndërsektorial Kombëtar (PINSK)* u përgatit në periudhën 2014-2016 nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Ai ofron një vizion afatgjatë për zonë ekonomike kryesore Tiranë-Durrës. Ndonëse ka formën e një plani rajonal, duke qenë se është i kufizuar për nga shtrirja gjeografike, ai konsiderohet një plan kombëtar. *Në kuadrin e politikave të përgjithshme të zhvillimit urban, një prej fushave kryesore është strehimi social*. Plani nxit zonimin

*shumëfunksionalësh dhe përfshirës, strehimin e grupeve të marxhinalizuara përmes ndërtimit të strehimeve të posaçme, si dhe mbështetjen e bizneseve që ofrojnë strehim social me anë të taksimit të diferencuar. Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Shijakut dhe Vorës priteshin të përdornin objektivat e PINKS-së si pjesë e një kuadri më të gjerë gjatë përgatitjes së planeve të tyre të përgjithshme vendore territoriale. Gjithashtu, plani i nxitjes së strehimit të përballueshëm me synimin ambicioz për t'ia dedikuar 15-20% të ndërtimeve të reja rezidenciale zgjidhjeve të strehimit të përballueshëm. Bashkive të zonës u rekomandohet që të përgatisin planet e tyre të strehimit social dhe që 10-15% e ndërtimeve të reja të fokusohen në zgjidhjet e strehimit kolektiv social.*

*Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030 u miratua në korrik të vitit 2018. Ajo përcakton qëllimet dhe objektivat e sektorit në Shqipëri deri në vitin 2030. Strategjia është në përputhje me SKZHI-në dhe aspiron të arrijë synimin 20/20/20 për Shqipërinë, veçanërisht për sa i përket reduktimit të emetimeve të gazeve serë. Ndonëse këto luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa dhe në nxitjen e përdorimit të energjive të rinovueshme, strategjia nuk ka të bëjë edhe aq me sektorin e strehimit në përgjithësi dhe me sektorin e strehimit social dhe të përballueshëm në veçanti. Gjithashtu, për sa i përket energjisë së rinovueshme, strategjia fokusohet më shumë te projektet e mëdha sesa te nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme për qëllime individuale apo në banesa.*

*Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 u përgatit nga Ministria e Çështjeve Sociale me mbështetjen e UNDP-së në vitin 2015. Vizioni i saj është të krijojë një sistem mbrojtjeje sociale që redukton pabarazitë sociale dhe ekonomike dhe nxit ngritjen e sistemeve dhe mekanizmave për mbrojtjen e duhur sociale të personave vulnerabël, si dhe të promovojë përfshirjen e grupeve vulnerabël. Strategjia nuk bën parashikime të drejtpërdrejta për sa i përket strehimit social. Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është në procesin e rishikimit të të gjitha strategjive që lidhen me mbrojtjen dhe zhvillimin social.*

*Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 u miratua me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave në vitin 2015. Dokumenti është në përputhje me SKZHI-në dhe me qëllimet e OZhQ. Një prej objektivave kryesorë strategjikë të PKV-së është përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët. Përmes këtij objektiwi, parashikohen dy veprime kryesore. Njëri prej tyre është ofrimi i mbështetjes për personat e komunitetit rom dhe egjiptian në procedurat e legalizimit me anë të përmirësimit të mekanizmave të përfshirjes. Fusha e dytë e ndërhyrjes synon të rrisë numrin e familjeve romë dhe egjiptiane që përfitojnë nga programet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të strehimit. Në kuadrin e objektivit të legalizimit, qëllimi ishte që 80% e familjeve romë dhe egjiptiane të finalizonin proceset e tyre të legalizimit. Ky qëllim do të arrihej përmes këshillimit ligjor falas, projekteve pilot për urbanizimin dhe legalizimin e zonave joformale të banimit të romëve dhe egjiptianëve, dhe mbështetjes së autoriteteve vendore në hartëzimin e vendbanimeve të komuniteteve romë dhe egjiptiane. Procesi i hartëzimit do të nisë me mbështetjen e Komisionit Evropian. Ndërkohë, për sa i përket përfitimit nga programet e strehimit, qëllimi është që 1500 familje romë dhe egjiptiane të përfitojnë nga programet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Ky qëllim është arritur falë ndihmave me qiratë dhe kreditë, trajnimit të stafit të qeverisë vendore për përgatitjen dhe aplikimin për projektet lidhur me komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe ligjit të ri për strehimin social, bazuar në rekomandimet e avokatit të popullit. Gjithashtu, përmes granteve të vogla, synohet përmirësimi i kushteve të jetesës. Pilotimi i*

banesave me efijencë të lartë energjie, duke përfshirë ato të komuniteteve rome dhe egjiptiane, dhe përmirësimi i ndërtesave që nuk konsiderohen si banesa për komunitetet rome dhe egjiptiane. Një tjetër veprim i rëndësishëm është përfshirja e kritereve alternative me synim rritjen e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e strehimit.

**Përfundimi:** Shqipëria i ka trajtuar aspektet e strehimit social kryesisht përmes miratimit të strategjive dhe platformave ndërkombëtare, si dhe strategjive ndërsektoriale. Megjithatë, kjo nuk është bërë gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndonëse strategjitë e tjera kombëtare duhet të rimarrin në konsideratë strehimin social në rishikimin e tyre, nevojiten përmirësime edhe në rishikimin afatmesëm të strategjisë së strehimit social.

- OZhQ-të, e veçanërisht OZhQ 1 dhe 11, duhet të trajtohen në mënyrë të kujdesshme në objektivat e strategjisë së rishikuar.
- Strategjia aktuale ofron një shumëllojshmëri skemash strehimi, çka është në përputhje me axhendën e re urbane dhe me Kartën e Gjenevës të OKB-së për Strehim të Qëndrueshëm. Megjithatë, strategjia duhet të koordinohet më mirë me axhendën e re urbane, veçanërisht për sa i përket rikonstruktimit të banesave të grupeve vulnerabël dhe ofrimit të banesave sociale të cilat, përveçse cilësore, të aksesueshme dhe të përballueshme, janë edhe rezistente ndaj fatkeqësive. SSS-ja, në përputhje me axhendën urbane, duhet të theksojë edhe planet vendore territoriale si mënyrë për arritjen e objektivave të saj. Aktualisht, pjesa më e madhe e planeve vendore territoriale jo vetëm që nuk parashikojnë instrumente për opsionet shumëfunktionale të strehimit përfshirës, por nuk sugjerojnë as zona apo hapësira për programet e strehimit social. Për rrjedhojë, SSS-ja duhet të bëjë të qartë edhe faktin se programet/opsionet e strehimit në vend duhet të jenë në afërsi të shërbimeve që u nevojiten grupeve të ndryshme të përfituesve.
- Në po këto linja, strategjisë do t'i duhej të përqafonte edhe parimin e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuar në Kartën e Gjenevës të OKB-së për Strehimin e Qëndrueshëm. Në terma operacionale, ky synim mund të arrihet veçanërisht pasi SSS-ja e rishikuar të vendosë lidhje të qarta me planin e përgjithshëm kombëtar të territorit, dhe përfshin veprime që integrojnë strehimin social në planifikimin vendor territorial.
- Duke qenë se SKZHI-ja ka hyrë tashmë në fazën e rishikimit, aktorët institucionalë të strehimit social duhet të advokojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë të sektorit në objektivat e SKZHI-së, ose të paktën parashikimin e tij në mënyrë të shprehur në kuadrin e prioritetit të përfshirjes sociale dhe ekonomike. Në mënyrë të ngjashme, strategjitë e zhvillimit dhe mbrojtjes sociale që po shqyrtohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet të marrin në konsideratë parashikimin e drejtpërdrejtë të strehimit për grupet e tyre të synuara në objektivat dhe veprimet e strategjive.
- E fundit, por jo për nga rëndësia, objektivat e efijencës së energjisë së ndërtesave duhet të përcaktohen qartë edhe për programet e strehimit social.




### 3.6 Kostot dhe shpenzimet e strehimit social

Kostot totale të planifikuara në SSS për zbatimin e aktiviteteve të saj përgjatë të gjithë kohëzgjatjes (2016-2025) ishin në vlerën 7,2 miliardë lekë, prej të cilave përafërsisht 5,7 miliardë lekë do të mbuloreshin nga buxheti i shtetit. Strategjia parashikon edhe një ndarje të kostove për periudhën afatmesme, ku kontributi i buxhetit të shtetit për 2016-2020 ishte planifikuar rreth vlerës 1,5 miliardë lekë, ndërsa kostot totale rreth 1,6 miliardë lekë. Duke u bazuar te shpenzimet (burimi të dhënave: Ministria e Financave dhe Sistemi i Thesarit), gjatë periudhës 2016-2019, qeveria qendrore ka shpenzuar rreth 1,9 miliardë lekë, ndërsa totali i shpenzimeve për strehimin social (në nivel vendor dhe kombëtar) ka qenë përafërsisht 2,8 miliardë lekë (tabela 2).

Aktivitetet e SSS-së të zbatuara deri më tani (qoftë të përfunduara apo në proces), me përjashtim të programeve të strehimit, kanë një kosto totale prej 60 670 000 lekësh (siç parashikohet në strategji). Aktivitetet e SSS-së që kanë mbetur pa u zbatuar, pra nuk janë nisur ende, kanë një kosto totale prej rreth 1,5 miliardë lekësh dhe lidhen kryesisht me aktivitetet PPP të renditura në objektivin strategjik nr. 4. Të gjitha këto aktivitete (qoftë të përfunduara apo jo) i përkasin fazës së parë të zbatimit të SSS-së, pra periudhës 2016-2020.

Duke analizuar shpenzimet për programet e strehimit, duket se numri i familjeve që kanë përfituar nga subvencionet ka ardhur duke u rritur me kalimin e viteve, me përjashtim të vitit 2018, kur vihet re e kundërta (figura 6). Në vitin 2020, numri i familjeve përfituese të subvencioneve është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet paraardhëse, për shkak të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019. Për rrjedhojë, viti 2020 përbën përjashtim për sa u përket subvencioneve të strehimit social dhe numrit të familjeve përfituese. Ndërkohë që vlera e investimeve është rreth 514 milionë lekë në vitin 2020, subvencionet arrijnë vlerën 3,2 miliardë lekë, prej të cilave 2,9 miliardë janë subvencione për familjet e prekura nga tërmeti në vitin 2019.


Figura 6. Numri i familjeve përfituese të investimeve dhe subvencioneve për strehimin social



Burimi: Autorë të bazuar në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria ka bërë ndarjen e të dhënave mbi numrin e familjeve përfituese të programit të subvencionimit të qirasë për çdo kategori përfituesish përgjatë dy viteve të fundit, konkretisht 2019 dhe 2020 (figura 7). Të dhënat tregojnë se gjatë dy viteve të fundit, në terma të përgjithshëm, kategoritë që kanë përfituar më shumë kanë qenë personat me aftësi të kufizuara dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, me 26,68% dhe 19,4 të numrit total të familjeve, përkatësisht. Këto kategori pasohen nga familjet egjiptiane dhe familjet me një prind, me 10,54% dhe 9,78%, përkatësisht. Në total, për të dy vitet, 26 familje të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara kanë përfituar nga vlera totale e subvencionimit.


Figura 7. Numri i familjeve për çdo kategori përfituesish, që kanë përfituar nga subvencionimi i qirasë (2019 dhe 2020)



Burimi: Autorë të bazuar në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Figura 8 tregon gjithashtu se, mes programeve të ndryshme të investimit, shumica e fondeve të strehimit ndër vite (nga 61% në 2016 deri në 80% e lart gjatë viteve të tjera), janë përdorur për përmirësimin e kushteve të banimit.


Figura 8. Shpenzimet e programeve të strehimit social për vit: Investimet (majtas) dhe subvencionet (djathtas)



Burimi: Autorë të bazuar në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në rastin e subvencioneve, me përjashtim të vitit 2020, ku pjesa më e madhe e parave ka shkuar për rimëkëmbjen e banesave pas tërmetit, pjesa më e madhe ka shkuar gjithmonë për subvencionimin e normës së interesit (nga 100% në vitin 2014 në 49% në vitin 2019), ndonëse vlerat kanë pësuar rënie me kalimin e viteve, duke i lënë më shumë vend programit të subvencionimit të qirasë. Në vitin 2019, ka pasur një rritje të qartë të vlerës së subvencionimit të qirasë, duke arritur deri në 37% në total. Për programet e investimit, Drejtoria e Strehimit pranë MFE-së ka zgjedhur financimin e projekteve në harkun e dy viteve buxhetore, në mënyrë që asnjë projekt të mos përjashtohet për shkak të mungesës së fondeve, dhe në mënyrë që të përfitojnë më shumë familje. Fondet e investimit janë rritur veçanërisht gjatë tri viteve të fundit (2018-2020), së bashku me kontributin e qeverive vendore si bashkëfinancuese në programet e investimit (figura 9).

Figura 9. Investimet në strehimin social sipas burimit, në bazë të kontratës



Burimi: Autorë të bazuar në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas ligjit për strehimin social, qeveritë vendore duhet të miratojnë programe vendore të strehimit me kohëzgjatje 5-vjeçare, ku të përcaktojnë (ndër të tjera) burimet e financimit. Këto fonde do të planifikohen në buxhetin vjetor dhe afatmesëm. Veçanërisht në rastet kur qeverive vendore u jepen stimuj për të kontribuar në programet e strehimit social përmes fondeve të veta, është mjaft e rëndësishme që të bëhet një bashkërendim i qartë ndërmjet buxhetit afatmesëm dhe programit të strehimit social në nivel vendor. Ky planifikim i koordinuar do të kontribuonte në përmirësimin e efikasitetit të financimit të strehimit social dhe në rritjen e numrit të familjeve që do të përfitonin nga programet e përcaktuara me ligj. Mbi të gjitha, programet vendore 5-vjeçare dhe bashkërendimi i tyre me planet dhe instrumentet buxhetore territoriale përbëjnë kusht për aksesin e qeverive vendore në fondet kombëtare të strehimit social.

### 3.7 Legjislacioni mbi strehimin social dhe ndërthurja me sektorë të tjerë

Miratimi i ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" shënoi një arritje në zbatimin e SSS-së në tërësi, dhe veçanërisht për sa i përket objektivit 2 "Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e aksesit në strehim të familjeve të pafavorizuara me 50%". Ligji përmban 32 referenca (nene) që parashikojnë detyrimin për miratimin e akteve nënligjore. Për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga këto referenca ligjore, parashikohen 26 akte nënligjore në total, prej të cilave 22 janë miratuar dhe 4 janë në pritje të feedback-ut nga ministrinë e linjës.

Në shtojcën 1 të këtij raporti jepet një listë e akteve nënligjore, e cila përfshin lidhjen me nenet e ligjit, duke lehtësuar kështu të kuptuarit e objektivit të tyre të përgjithshëm. Legjislacioni për strehimin social parashikon një paketë të plotë instrumentesh, përkufizimesh dhe rregulloresh që lehtësojnë dhe rregullojnë zbatimin e strehimit social si shërbim. Gjatë analizës së legjislacionit janë identifikuar problematikat në vijim, të cilat mund të kërkojnë vëmendje të mëtejshme nga Drejtoria e Strehimit dhe aktorë të tjerë:

- Neni 16, germa "c", pika I e ligjit përcakton se gjendja e familjeve përbën një prej kushteve kryesore për përzgjedhjen e përfituesve, dhe personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një prej kategorive me përparësi. Sipas ligjit, Këshilli i Ministrave duhet të miratojë akte nënligjore që rregullojnë zbatimin e nenit 16. Duke qenë se aktet nënligjore për strehimin social (qoftë të miratuara apo në proces) nuk parashikojnë specifika në përputhje me citimin e mësipërm të ligjit, pritet që në rastin e personave me aftësi të kufizuara të zbatohet vetëm legjislacioni i tyre sektorial. Megjithatë, përfaqësuesit e këtij grupi interesi kanë deklaruar se praktika aktuale e ofrimit të strehimit social e merr në konsideratë vetëm pjesërisht legjislacionin mbi personat me aftësi të kufizuara, madje edhe më pak se legjislacioni i mëparshëm për strehimin social. Për rrjedhojë, bazuar në intervistën me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë (SHVSH), perceptimi i tyre është se mundësitë e personave me aftësi të kufizuara për të përfituar strehim social janë përkeqësuar në vend që të përmirësoheshin, për shkak se në aktet nënligjore të strehimit social mungojnë specifikat lidhur me nevojat e tyre të posaçme, si dhe për shkak të keqinterpretimeve të ligjit nga disa qeveri vendore. Sipas SHVSH-së, nuk ka pasur anëtarë të rinj nga kategoria e tyre që të kenë përfituar strehim social pas vitit 2018. Gjithashtu, ata e konsiderojnë strehimin përfshirës si të rëndësishëm nga pikëpamja e ofrimit të mundësive për të banuar në zona të ndodhura pranë rrjeteve të infrastrukturës dhe shërbimeve utilitare, si dhe në zona shumëfunktionale, për të shmangur mundësitë e getoizimit.

Prandaj, sipas tyre, duhet të bëhet diferencim i mëtejshëm i programeve të strehimit social prej të cilave personat me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë mbi bazën e grupeve të të ardhurave në kategorinë e tyre. Për shembull, aplikantët nga kategoria e personave me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë nga vlera totale e grantit apo nga programi i subvencionimit të normës së interesit për blerjen e banesave me kosto të ulët. Megjithatë, duke qenë se shumica e tyre janë të papunësuar, e për rrjedhojë pa të ardhura, aksesit i tyre në programe vështirësohet. Dhe, siç e konfirmojnë vetë ata, nuk ka pasur asnjë rast të ndonjë pjesëtari të kategorisë së tyre që të ketë përfituar subvencionim në masën 100% për akomodimin e tij. Gjithashtu, siç është konfirmuar në intervistat me grupet përkatëse të interesit, standardet e aksesueshmërisë në banesat e ofruara për personat me aftësi të kufizuara zbatohen apo disponohen rrallëherë. Për më tepër, kur aplikojnë pranë bashkisë së Tiranës, atyre u duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas procedurës së përgjithshme, pavarësisht lehtësimeve të parashikuara me ligj për kategorinë e tyre. Në mënyrë të përmbledhur, përfaqësuesit e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe Shoqata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve argumentojnë se do të donin që legjislacioni për strehimin social t'i merrte më shumë në konsideratë nevojat e tyre të posaçme. Kjo mund të arrihet me anë të përmirësimeve të mundshme të legjislacionit për strehimin social, duke garantuar gjithashtu një koordinim më të mirë me legjislacionin sektorial përkatës dhe duke mënjanuar çdo paqartësi që lë vend për interpretim nga ana e bashkive. Megjithatë, kjo mund të arrihet gjithashtu përmes një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet Drejtorisë së Strehimit pranë MFE-së, Autoritetit Kombëtar të Strehimit dhe shoqatave të lartpërmendura. Së fundi, ekziston mundësia që të përcaktohet një kuotë minimale për personat me aftësi të kufizuara, siç është vepruar për komunitetin rom.

- Sipas nenit 55/3 dhe 58/2 të ligjit, kushtet dhe standardet e projektit të banesave të përkohshme dhe të ndërtesave të specializuara, përkatësisht (dy prej programeve të strehimit social) do të përcaktohen përkatësisht në një udhëzim të ministrisë përgjegjëse për strehimin social dhe në një VKM. Aktualisht po hartohet një udhëzim për administrimin e banesave të përkohshme, por ai nuk përmban specifika lidhur me kushtet.
- Neni 6 i ligjit parashikon procedurën e zhvendosjes për familjet dhe individët banesa e të cilëve do të prishet për arsye të caktuara. Ky nen nuk i referohet shprehimisht zhvendosjes për shkak të fatkeqësive. Megjithatë, duke përdorur shprehjen "raste të tjera ... të përcaktuara nga ligje të tjera", ai lë hapësirë për përfshirjen e familjeve të prekura nga fatkeqësitë natyrore. Në terma të përgjithshëm, VKM nr. 361, datë 29/05/2019 "Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional" nuk u referohet drejtpërdrejt familjeve që zhvendosen për shkak të fatkeqësive natyrore (siç është rasti i tërmetit të 26 nëntorit). Bazuar në nevojën e të gjithë sektorëve për ruajtjen e një qasjeje të qëndrueshme dhe parandaluese (siç përcaktohet në ligjin për mbrojtjen civile), mund të jetë e mundur që këto parime të zbatohen edhe në legjislacionin e strehimit social. Ç'është më e rëndësishmja, edhe pse nuk përbën objektiv të drejtpërdrejtë të SSS-së, familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësive mund të jenë gjithashtu përfituese potenciale të trajtimit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen civile, por në kuadrin më të gjerë të strehimit social. Këta përfitues duhet të marrin një trajtim më të mirë përmes masave strategjike, në vend të atyre të posaçme të bazuara në akte normative me fuqinë e ligjit të nxjerra në kushtet e urgjencës, siç ka ndodhur deri më tani. Strategjia e Strehimit Social mund të jetë parashikuese dhe ta marrë këtë grup paraprakisht në konsideratë, duke kontribuar kështu në përpjekjet e gatishmërisë që duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet, dhe duke përqaftuar dimensionin e qëndrueshmërisë.
- Në disa nene të ligjit, dhe në pjesën më të madhe të akteve nënligjore, baza e të dhënave për strehimin social përmendet si një kriter kushtëzues për programet e strehimit dhe procedurat e tyre, për të funksionuar në përputhje me legjislacionin. Për shembull, sipas VKM 459/2019 "Për administrimin e kërkesave për strehim", bashkitë nuk mund të aplikojnë për fonde për sa kohë që nuk kanë kryer një analizë të plotë të nevojës. Kjo e fundit mund të kryhen me anë të informacioneve të përditësuara të mbledhura nga një sistem dinamik dhe i plotë informacioni. Gjithashtu, VKM 369/2019 "Për kriteret e shpërndarjes së subvencioneve të qirasë" përcakton se vlera e subvencionit për banesat nga pronarët socialë bazohet te qiraja mesatare e tregut, të ardhurat e familjeve përfituese dhe aftësia e tyre për të përballuar qiranë mujore. Për rrjedhojë, bashkia duhet të ruajë një bazë të dhënash të përditësuara në kohë reale lidhur me tregun e banesave dhe kushtet socio-ekonomike të përfituesve dhe të komunitetit lokal. E njëjta gjë vlen edhe për VKM 453/2019 "Për masën e subvencionit për kreditë në rastin e banesave me kosto të ulët", si dhe për udhëzimin e ministrit 22/2019 "Për ndërveprimin midis programeve të strehimit social dhe programeve të tjera të mbrojtjes sociale, kur vetëm një bazë e integruar të dhënash mund ta lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet ministrive përkatëse dhe programeve. Megjithatë, udhëzimi mbi bazën e të dhënave për programet e strehimit social është ende në fazën e hartimit, çka do të sjellë vonesa në krijimin e bazës së të dhënave në praktikë.

- Aktet nënligjore për strehimin social i referohen rrallëherë legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin territorial. Në raste të caktuara, siç është neni 11 i VKM-së 458/2019 ("Për kthimin e objekteve pronë shtetërore në fond banese"), përdoret një terminologji e cila nuk është më në përputhje me ligjin, që gjë çon, ndër të tjera, në keqpërdorim të instrumenteve të planifikimit, e për rrjedhojë në mospërputhshmëri ligjore (studime urbane në vend të planeve vendore të detajuara). Gjithashtu, programi për zhvillimin e zonës për strehim social mund të shfrytëzojë rregulloret që burojnë nga legjislacioni për planifikimin territorial si procedura ligjore të detyrueshme që çojnë drejt nxjerrjes së lejeve përkatëse të ndërtimit. Për më tepër, vetë ligji për strehimin social (neni 19, pika 2) rrezikon shmangien nga ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorial", të ndryshuar, duke riparashikuar instrumentin e "intensitetit të ndërtimit me kushte" me një grup disi të ndryshëm rregullash. Përpos kësaj, synimi i ligjit për strehimin social për të krijuar kushte për strehimin përfshirës (neni 19, pika 1) mund të kompromentohet për shkak të aspekteve të caktuara të procesit që janë lënë të hapura nga ligji dhe që mund të kërkojnë rregullim përmes akteve nënligjore. Për sa i përket rastit të fundit, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë ke deklaruar se qëndrimi i saj lidhur me çështjen është injoruar gjatë hartimit të ligjit dhe se janë vërejtur një sërë parregullsish në zbatim. Kështu, për shembull, bashkia e Tiranës ka kërkuar kontributin e barasvlershëm në para të 3% të sipërfaqes funksionale ndërtimore të zhvillimit. Ky kontribut duhet të paguhet përpara nxjerrjes së lejes së ndërtimit. Krahas kësaj, zhvilluesit kanë edhe detyrimin për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për këtë sipërfaqe ndërtimore të barabartë me 3% të zhvillimit. Ata e konsiderojnë aplikimin e taksës si të padrejtë në kushtet kur ata ia ofrojnë sipërfaqen ndërtimore bashkisë për qëllime të strehimit social. Si rezultat, ndërtuesit janë gati të padisin bashkinë e Tiranës për zbatimin e instrumentit, dhe kjo mund të rezultojë joproduktive për qëllimin e ligjit të strehimit social për të lehtësuar strehimin përfshirës.

Krahas legjislacionit për strehimin social, janë konsultuar 42 akte ligjore mbi aspektet sektoriale për të kuptuar implikimet reciproke midis këtyre sektorëve dhe strehimit social. 14 prej këtyre akteve janë konventa ndërkombëtare lidhur me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut, ndërsa 14 janë ligje sektoriale. Pjesa tjetër e akteve janë kryesisht vendime të Këshillit të Ministrave. Në shtojcën 1 të këtij raporti jepet një panoramë e hollësishme e legjislacionit sektorial. Disa implikime të rëndësishme që vlen të përmenden janë:

- Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për personat me aftësi të kufizuara përcakton, ndër të tjera, detyrimin e shteteve për të ofruar strehim [social] të përshtatshëm për përfituesit si në zona urbane ashtu edhe në ato rurale. Aktualisht, legjislacioni për strehimin social nuk është specifik për zonat rurale. Instrumentet e parashikuara zbatohen për çdo kuadër, në rrethana të ndryshme. U takon bashkive të interpretojnë përdorimin e çdo instrumenti në kuadër të ligjit dhe ta zbatojnë atë sipas konteksteve të tyre përkatëse. Megjithatë, bashkitë janë më të prirura ta interpretojnë ligjin nga pikëpamja e zbatimit të programeve të strehimit social për zonat urbane. Pavarësisht rasteve kur programet janë përshtatur me kontekstin rural, pjesa më e madhe e bashkive shfaqin njohuri të pamjaftueshme lidhur me trajtimin e çështjes së strehimit social në zona rurale.

- Akti normativ 9/2019 që rregullon procesin e rindërtimit të banesave për personat e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit i referohet vazhdimisht legjislacionit për strehimin social. Gjithashtu, çdo kategori përfituesish të strehimit social që është prekur nga tërmeti trajtohet nga ligji dhe nga programi i rindërtimit. Megjithatë, akti normativ, aktet nënligjore dhe programi i rindërtimit në tërësinë e tij janë zbatuar veçmas programeve të strehimit social, si dhe janë menaxhuar nga institucione të ndryshme nga Drejtoria e Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Ligjet nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë" dhe nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" nuk i referohen drejtpërdrejt strehimit social. Megjithatë, duke qenë se strehimi social përbën politikë publike, zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në programet e strehimit social duhet të përbëjnë zbatim të ligjeve të mësipërme.

### 3.8 Mësimet e nxjerra nga analiza e kontekstit

Strehimi social duhet të përfshihet qartë në programet dhe strategjitë kombëtare ndërsektoriale, ndërkohë që **strategjia e rishikuar duhet të përfshijë parimet e mbrojtjes së mjedisit, banesave rezistente ndaj fatkeqësive dhe efikasitetit të energjisë** në objektivat dhe masat e saj.

**Duhet të krijohet një lidhje e qartë ndërmjet planifikimit në hapësirë (territorial) dhe strehimit social.**

Ky i fundit duhet të integrohet në planet territoriale si një politikë kyçe për zbatimin e planeve territoriale. Kjo duhet të realizohet në planet në nivel kombëtar dhe vendor. Planet territoriale duhet të përfshijnë programet e zbatueshme të strehimit social për çdo bashki, dhe anasjelltas, programet 5-vjeçare të strehimit social duhet t'u referohen përkufizimeve që burojnë nga planet vendore territoriale.

Duhet të krijohet një lidhje e qartë ndërmjet strategjive dhe programeve të përfshirjes sociale dhe ekonomike dhe programeve dhe mekanizmave të strehimit social. Deri më tani, mungon një lidhje e tillë në nivelin lokal, dhe pavarësisht specifikimeve ligjore, grupet vendore të interesit kanë ngritur shqetësime lidhur me faktin nëse strehimi social konsiderohet si përparësi e mbrojtjes sociale, si investim ekonomik apo si një ndërhyrje në zhvillimin urban. Në parim, strehimi social i përfshin të tri këto dimensione. Megjithatë, **lidhja e qartë ndërmjet këtyre tri objektivave** do të kontribuonte padyshim në efikasitetin e programeve dhe instrumenteve që po përdoren nga pikëpamja socio-ekonomike, mjedisore dhe urbane.

Në kuadrin financiar, qeveria ka rritur fondet e alokuara për programet e strehimit social, jo vetëm si rezultat i programeve të reja të prezantuara me ligj, por edhe si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019. Gjithashtu, Departamenti i Strehimit ka bashkëpunuar me qeveritë vendore për të nxitur bashkëfinancimin përmes fondeve të veta të bashkive. Ky është një zhvillim pozitiv, i cili duhet të plotësohet më tej me skema të partneriteteve publike-private, si mënyra efikase për të garantuar njësi më të shumta e më të mira të strehimit social.

**Aktet nënligjore për strehimin social** janë përgjithësisht ekzistuese dhe janë në përmbushje të kërkesave ligjore. Disa syresh janë në zhvillim e sipër dhe mbeten ende për t'u miratuar. Përpos kësaj, disa akte nënligjore kanë nevojë për përmirësime për t'u përshtatur siç duhet me nevojat e ndryshme të përfituesve të përcaktuar me ligj. Për të realizuar këtë, qeveria duhet të bashkëpunojë ngushtë me grupet



e ndryshme të përfituesve dhe të diskutojë lidhur me shqetësimet e tyre. Për më tepër, baza e të dhënave të programeve të strehimit social duhet të vihet në zbatim sa më shpejt të jetë e mundur, dhe përpjekjet për ngritjen e një sistemi të integruar informacioni duhet të intensifikohen. Ekzistenca e një baze të dhënash është me rëndësi thelbësore për zbatimin e pjesës më të madhe të programeve dhe të vetë strategjisë, si dhe për koordinimin vertikal dhe horizontal ndërmjet institucioneve qeveritare. Në këtë drejtim, strategjia duhet të theksojë edhe **ngritjen e bazës së të dhënave si një masë prioritare**.

Për më tepër, **strategjia** duhet të përdoret jo vetëm si një instrument që thekson reagimin e qeverisë ndaj kërkesës për strehim social, por edhe **si një mjet për parashikimin dhe trajtimin e pasigurive të ardhshme**. Në këtë drejtim, strategjia mund të përmbajë **një seksion dhe/ose aktivitete për reduktimin/menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive lidhur me strehimin social**. Zhvendosja e familjeve/individëve për shkak të fatkeqësive është një ilustrim i përshtatshëm. Një tjetër është vendndodhja e njësisë të reja të banimit. Në mënyrë që të garantohet reagimi i duhur i bashkive dhe institucioneve qeveritare ndaj rasteve të zhvendosjes si pasojë e fatkeqësive, duhet të përmbushen dy kushte: higjiena dhe siguria e banesave të përkohshme dhe sigurimi në kohë i banesave të përshtatshme (sipas përcaktimit me ligj) në zona pak ose aspak të rrezikuara nga fatkeqësitë. Këto kushte duhet të mbështeten nga **procedura ligjore dhe standarde strehimi të qarta**, dhe duhet të ekzistojnë **baza të përditësuara dhe dinamike të dhënash mbi pronarët socialë**, si një prej opsioneve më të mira në raste emergjencash.

Së fundi, strategjia mund të theksojë nevojën për **një koordinim më të mirë ndërmjet legjislacionit dhe praktikës së strehimit social dhe sektorëve të tjerë**, krahas atyre që lidhen me mbrojtjen sociale. Me rëndësi të veçantë është koordinimi me legjislacionin për **planifikimin territorial, mbrojtjen civile dhe efikasitetin dhe performancën e energjisë**. Për sa i përket kësaj të fundit, strategjia mund të theksojë në mënyrë të veçantë nevojën për: standarde të larta të efikasitetit të energjisë për njësitë e reja të strehimit social; kontrole të energjisë për njësitë ekzistuese, e veçanërisht për ato të deklaruara nga pronarët socialë; dhe etiketim ekologjik të njësisë të strehimit social, si kërkesë për planet vendore të strehimit.


Ndryshimet institucionale që kanë ndodhur në vitin 2017 dhe procesi i ngadaltë i plotësimit me staf të Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e kanë vënë ekipin në nivel kombëtar përpara një presioni më të madh. Ndjekja e zbatimit të SSS-së në këto kushte ka qenë tejet sfiduese në ballë të vonësive në hartimin e legjislacionit dhe në ngritjen e bazës së të dhënave të strehimit social.

**Strategjia mund të theksojë nevojën për një përfshirje më të madhe të grupeve të interesit në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për strehimin social**. Deri më tani, përfaqësuesit e komuniteteve vulnerabël janë ndjerë të nënpërfaqësuar në Këshillin Konsultativ të Strehimit Social, i cili, në bazë të legjislacionit, përbëhet nga jo më shumë se një përfaqësues nga këto komunitete. Nga intervistat me grupet e interesit, është konstatuar se ky përfaqësim është i pamjaftueshëm për advokimin e nevojave të të gjitha grupeve, të cilat janë të larmishme dhe shpeshherë thelbësisht të ndryshme nga njëra-tjetra.

#### 4. Vlerësimi afatmesëm i Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025

Seksionet në vijim i referohen anketës së kryer me bashkitë, intervistave të hapura me disa bashki, gjetjeve nga intervistat me grupet e interesit në nivel kombëtar, dhe shqyrtimit të planit të veprimit me Drejtorinë e Strehimit pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Anketa ka qenë një instrument veçanërisht i rëndësishëm për vlerësimin e zbatimit të strategjisë në nivel vendor, dhe është shpërndarë në të 61 bashkitë, prej të cilave 37 kanë marrë pjesë në anketë (figura 10). Megjithatë, jo të gjitha bashkitë kanë dhënë përgjigje apo të dhëna për të gjitha pyetjet. Në disa raste, kjo ka ardhur si pasojë e papërshtatshmërisë së disa pyetjeve apo programeve strehimi për disa bashki, ndërsa në raste të tjera ka pasur të bëjë me mungesën e një opinioni nga ana e bashkive lidhur me zbatimin e strategjisë, apo mospjesëmarrjen e tyre në zbatimin e një veprimi/mase të caktuar. Kjo e fundit u konfirmua me anë të intervistave apo telefonatave të kryera me bashkitë për të kuptuar mungesën e të dhënave. Reagimi i bashkive është mjaft i ulët për të kontribuar në bazën e të dhënave të programeve të strehimit social në nivel vendor. Megjithatë, ai është në nivele të kënaqshme për të kontribuar në vlerësimin e zbatimit të strategjisë.

Figura 10. Shpërndarja e bashkive të anketuara (në ngjyrë blu)



#### 4.1 Rëndësia e objektivave, qëllimeve, produkteve dhe rezultateve dhe përshtatshmëria e masave

Rëndësia e përgjithshme e strategjisë mbetet e lartë në vitin 2020, duke qenë se zhvillimet kontekstuale të pas 2016-ës vetëm sa e kanë rritur më tej nevojën për një kuadër strategjik për strehimin social në nivel kombëtar. Dy fatkeqësitë madhore (tërmeti dhe COVID-19) kanë nxjerrë në pah faktin se gatishmëria ndaj rreziqeve të fatkeqësive mbetet e ulët në sektorin e strehimit social, si për nivelin e qeverisë qendrore ashtu për atë të qeverisjes vendore, dhe lipset një ndërhyrje urgjente, e cila duhet të merret në konsideratë edhe në strategjinë e rishikuar.


Rëndësia e SSS-së është vlerësuar më në hollësi në nivel vendor dhe kombëtar me anë të intervistave me bashkitë dhe diskutimeve me grupet e interesit. Grupet e interesit të kontaktuar në nivel kombëtar (grupe të ndryshme vulnerabël/të disavantazuara, zhvilluesit dhe Autoriteti i Strehimit Social) i konsiderojnë objektivat dhe nënobjektivat e strategjisë si të rëndësishme dhe të përshtatshme. Megjithatë, ato vazhdojnë të ngrenë shqetësime lidhur me zbatimin dhe të theksojnë sfida dhe/ose mangësi të ndryshme, në varësi të interesave të tyre specifike. Në përgjithësi, të gjitha grupet e interesit konkludojnë se njësitë të qeverisjes vendore, si aktorë kyçë në sigurimin e strehimit social, u mungojnë kapacitetet e duhura dhe bazat e të dhënave të nevojshme për zbatimin e programeve të ndryshme. Për rrjedhojë, ato nuk arrijnë të zbatojnë disa prej programeve të përcaktuara me ligj, ndonëse ato mund të jenë të një rëndësie të madhe.

Bashkitë u pyetën nëse objektivat strategjike të SSS-së janë të rëndësishme dhe të përshtatshme<sup>20</sup> për kontekstet e tyre (figura 11). Pavarësisht interesave të ndryshme që ekzistojnë në nivelin lokal, të gjitha objektivat u vlerësuan mbi mesataren për sa i përket rëndësisë dhe përshtatshmërisë. Megjithatë, ndonëse rëndësia e objektivave strategjike konsiderohet e lartë, përshtatshmëria vlerësohet në nivele më pranë mesatares, çka tregon se strategjia ka vend për përmirësim në trajtimin e diferencave dhe specifikave të veçanta.

Figura 11. Rëndësia dhe përshtatshmëria e objektivave strategjike në nivel vendor (mesatarja e ponderuar)

---

<sup>20</sup> Rëndësia i referohet lidhshmërisë dhe përkatësisë me temën, pra me objektivin në kuptim të gjerë, parë nga këndvështrimi kombëtar. Përshtatshmëria lidhet me përshtatshmërinë dhe lidhjen me kontekstin, vendin apo situatën, pra me përshtatshmërinë e objektivit me kontekstin vendor.



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Vlerësimi nga bashkitë bëhet me pikë nga 1 (aspak i rëndësishëm/i përshtatshëm) deri në 5 (plotësisht i rëndësishëm/i përshtatshëm), për çdo objektiv të përdorur si bazë për llogaritjen e mesatares së ponderuar (vlerat\*shpeshësia). Të gjitha objektivat strategjike konsiderohen të rëndësishme, por mesatarja më e lartë e ponderuar (4,5) ka rezultuar për objektivin strategjik nr.3 (koordinimi dhe alokimi i përmirësuar i strehimit social), i cili konsiderohet si plotësisht i rëndësishëm nga 77,1% e bashkive të anketuara (27 nga 35). Ky objektiv lidhet me përmirësimin e koordinimit midis institucioneve për një shpërndarje më të mirë të banesave sociale në nivel vendor. Mesataret e ponderuara të objektivave të tjera strategjike variojnë midis vlerave 4.1 - 4,4. Vlera 4,4 ka rezultuar për objektivin strategjik nr.2, i cili lidhet me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe është një prej objektivave më të arrirë deri më sot.


Për sa i përket përshtatshmërisë, vlerat janë më të ulëta, duke variuar nga 3 për objektivin strategjik nr.4 (niveli mesatar) deri në 3,7 (për objektivin strategjik nr. 1 dhe 2, afër mesatares) dhe 3,9 dhe 4 për objektivin strategjik 3 dhe 5, përkatësisht. Objektivi më pak i përshtatshëm (objektivi strategjik nr.4) lidhet me partneritetet publike-private si mjet për rritjen e numrit të familjeve përfituese me 20%. Siç duket, njësitë e qeverisjes vendore nuk e konsiderojnë shumë të përshtatshëm këtë objektiv, në rrethanat ku (sipas tyre dhe sipas grupeve të tjera të interesit) njohuritë mbi legjislacionin dhe instrumentet e PPP janë të pakta, dhe gatishmëria për bashkëpunim publik-privat lë për të dëshiruar. Kjo mund të jetë pasojë e paqartësive lidhur me mekanizmat e PPP për strehimin social. Megjithatë, krahas nevojës për rritje të kapaciteteve, bazuar në komunikimet në forumet publike, nivelet e ulëta të gatishmërisë mund të jenë edhe pasojë e perceptimit të përgjithshëm në Shqipëri lidhur me praktikën e PPP, të cilat janë ende të veshura me një hije dyshimi. Ndonëse perceptimi nuk mund të konsiderohet si tregues që identifikon progresin e PPP-ve, ai mund jetë një faktor që i shtyn grupet vendore të interesit të hezitojnë t'i përdorin ato.

Objektivi i tretë (bashkëpunimi) konsiderohet si i përshtatshëm, vlerësuar me 3,9 pikë, por vlerësimi më i lartë (4) është dhënë për objektivin nr.5, i cili lidhet me zgjerimin e alternativave të programeve të strehimit për të rritur përfshirjen e grupeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme, dhe veçanërisht atë të grupeve të disavantazuara, me 30%. Pra, në tërësi, përpjekjet për përmirësimin e zbatimit të

programeve dhe trajtimin e nevojave të grupeve të disavantazuara mbeten më të përshtatshmet në nivel vendor. Pas së gjithash, legjislacioni i strehimit social i miratuar pas vitit 2018 kontribuon pikërisht në zgjerimin e alternativave, duke prezantuar më shumë instrumente dhe duke rritur numrin e kategorive që përfitojnë nga strehimi social.

Bashkitë u pyetën gjithashtu lidhur me nevojën për ndryshime në objektivat e strategjisë, në mënyrë që të rritet përshtatshmëria me kontekstet e tyre specifike, si dhe lidhur me faktin nëse ndryshimi duhet të prekë objektivat, nënobjektivat apo qëllimet (figura 12). Për sa i përket objektivit strategjik nr.3 (bashkëpunimit), ekziston një lidhje ndërmjet faktit se bashkitë e cilësojnë atë si të parin për nga rëndësia dhe të dytin për nga përshtatshmëria, dhe faktit se 71% e bashkive kanë shprehur nevojën për ndryshime lidhur me të. 25% e bashkive të anketuara kanë shprehur gjithashtu nevojën për ndryshim të OS3 në nivelin e nënobjektivave. Ky ndryshim mund të materializohet në formën e një formulimi që jep rezultate më të mira dhe më të realizueshme për sa i përket bashkëpunimit vertikal dhe horizontal, si dhe për sa i përket sigurimit të një sistemi efikas të informacionit, i cili mungon deri më tani.

Figura 12. Përqindja e bashkive që kanë shprehur nevojën për ndryshim të objektiveve strategjike, nënobjektivave dhe/ose qëllimeve të objektiveve




Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

**Në rastin e OS1 (zhvillimi i kapaciteteve për njësitë e qeverisjes vendore), 75% e bashkive janë shprehur se nevojitet një përmirësim i objektivit.** Kjo mund të ketë të bëjë me nivelin relativisht të ulët të zbatimit të këtij objektivi, siç vihet re nga progresi i aktiviteteve në planin e veprimit të SSS-së, ose me perceptimin se nevojitet zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve. Në secilin rast, si për OS2 (kuadri ligjor) ashtu dhe për OS5 (programet e strehimit), mbi 50% e bashkive dëshirojnë të shohin ndryshim lidhur me nënobjektivin dhe/ose qëllimin. Për OS2, kjo mund të ketë të bëjë me faktin se aktivitetet e këtij objektivi pothuajse kanë përfunduar, dhe hallkat e mbetura lidhen me përmirësimin e disa akteve nënligjore dhe veçanërisht me zbatimin në mënyrë të drejtë dhe të pajtueshme. Megjithatë, në rastin e OS5, ku zbatimi është i pjesshëm (programet janë në zbatim të vazhdueshëm), **duket se shqetësimet e bashkive lidhen më shumë me mënyrën e zbatimit të objektivit dhe me mënyrën e arritjes së qëllimit, sesa me shqyrtimin e tij në nivel strategjik.**

Gjetjet e mësipërme lidhen me nivelin e të kuptuarit të strategjisë së strehimit social nga njësitë e qeverisjes vendore, si dhe me kapacitetet e tyre për zbatimin e programeve. Intervistat me grupet e interesit dhe anketa kanë konstatuar se bashkitë ndihen më të sigurta në zbatimin e programeve të tilla si qiraja sociale, pasuar nga strehimi me kosto të ulët dhe, në raste specifike, edhe programi i përmirësimit të kushteve të banimit. Pjesa më e madhe e bashkive nuk kanë njohuri mbi mënyrat e zbatimit të programit të zhvillimit të zonave për strehimin social dhe asnjëra prej tyre nuk ka ndërmarrë ndonjë përpjekje për ndërtimin e banesave të specializuara.

Bashkitë rendisin një sërë faktorësh pengues dhe vështirësish në realizimin e programeve të strehimit social, dhe në një mënyrë apo në një tjetër, të gjitha këto kanë të bëjnë me zhvillimin e kapaciteteve dhe proceset e brendshme (figura 13). 36,4% e bashkive e konsiderojnë mungesën e aftësisë për të menaxhuar rreziqet e lidhura me zbatimin e programeve të ndryshme dhe sigurimin e fondeve si faktorin negativ më madhor që ndikon në performancën e tyre. Rreth 51% e tyre mendojnë se komunikimi, ndarja e informacioneve dhe monitorimi dhe kontrolli janë faktorët e brendshëm më madhorë që pengojnë realizimin e aktiviteteve të tyre të strehimit social.


Figura 13. Vështirësitë në menaxhimin financiar dhe monitorimin e brendshëm të proceseve për programet e strehimit social.



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Krahas faktorëve të brendshëm, ekzistojnë gjithashtu edhe faktorë të jashtëm që pengojnë proceset vendore për strehimin social (figura 14). Tre faktorët më të rëndësishëm janë: i) kompleksiteti i aspekteve dhe procedurave institucionale në trajtimin e çështjes së strehimit social; ii) politikat qeveritare ekonomike, të cilat ndikojnë edhe te strehimi social; dhe iii) raporti kërkesë-ofertë në tregun e banesave, i cili ndikohet jo vetëm nga kërkesa e lartë për strehim social, por edhe nga çmimet e larta në treg. Faktori i parë, ndonëse është një faktor i jashtëm, lidhet qartë me të ardhmen e OS1 (zhvillimi i kapaciteteve), si një objektiv aktiviteteve të cilit mund të luajnë një rol kyç në zgjidhjen e kompleksitetit dhe t'u lejojnë bashkive të kuptojnë më mirë programet dhe marrëveshjet e lidhura për zbatimin. Edhe pse ka pak gjasa që bashkitë ose grupet e interesit në nivel kombëtar të mund të influencojnë drejtimin e përgjithshëm të politikave qeveritare ekonomike që prekin strehimin social (qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë), nuk ka dyshim se ato mund të bëjnë parashikime më të sakta të kërkesës për strehim social, duke ngritur sisteme funksionale informacioni (OS1).


Figura 14. Faktorët e jashtëm që pengojnë proceset vendore për strehimin social



Burimi: Anketat e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Më konkretisht, dy janë faktorët e jashtëm që supozohet të kenë ndikuar në proceset dhe programet e strehimit social: **tërmeti i 26 nëntorit dhe pandemia e COVID-19**. Bashkive u janë drejtuar një sërë pyetjesh për të kuptuar mënyrën sesi ato e perceptojnë këtë ndikim. Në krahasimin e dy fatkeqësive, numri i bashkive që e perceptojnë tërmetin si një ngjarje që ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë ndikim në strehimin social në të ardhmen e afërt dhe atë afatmesme, është më i madh se numri i atyre që kanë të njëjtin perceptim për COVID-19 (figura 15).

Figura 15. Ndikimi i perceptuar (balanca neto) e tërmetit të 26 nëntorit dhe i pandemisë COVID-19 në nivel vendor, sipas bashkive.



Burimi: Anketat e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Të paktën 83% e bashkive mendojnë se tërmeti ka pasur ndikim në strehimin social, krahasuar me rreth 59% në rastin e COVID-19. Për sa u përket efekteve të ardhshme, vlerat janë më të ulëta në të dy rastet, me 71,4% dhe 56,3% përkatësisht. Megjithatë, lidhur me të dyja rastet e fatkeqësive, si për ndikimin

aktual ashtu edhe për atë të ardhshëm, **balanca neto** ndërmjet përgjigjeve “asnjë lloj efekti/asnjë efekt” dhe “një farë efekti/efekt i madh” **mbetet negative**, me vlera që variojnë nga -24% deri në -47%. Për më tepër, për të dyja rastet e fatkeqësive, ka disa bashki, numri i të cilave varion nga 8,6% deri në 28%, të cilat nuk kanë ndonjë qëndrim në lidhje me ndikimet e perceptuara, e për rrjedhojë nuk i cilësojnë ngjarjet si “pa ndikim të strehimit social”. Është e kuptueshme se tërmeti perceptohet si një fatkeqësi me ndikime më të drejtpërdrejta të strehimit social sesa pandemia, nisur nga natyra e fenomenit dhe nga mënyra sesi ndikon te ndërtimet. Gjetjet lidhur me perceptimet mbështeten deri në një farë pike edhe nga numri i aplikimeve për të dyja rastet, i cili ka ndryshuar (është rritur) pas tërmetit, sipas 68,6% të bashkive të anketuara. Në rastin e COVID-19, edhe pse ngjarja është e përmasave kombëtare (ndryshe nga tërmeti i 26 nëntorit, i cili kishte përmasa rajonale), vetëm 44% e bashkive konfirmojnë se kanë parë ndryshim në numrin e aplikimeve për strehim social. **Siç duket qartë, situata e COVID-19 është mjaft dinamike dhe pozicioni i bashkive dhe grupeve vulnerabël mund të ndryshojë me ecurinë e pandemisë.**

Për më tepër, vlen të theksohet se pjesa më e madhe e bashkive (60%) nuk janë në gjendje t’i përgjigjen pyetjes nëse Strategjia e Strehimit Social ka ndihmuar ndopak në trajtimin e nevojave dhe sfidave të strehimit social gjatë dy fatkeqësive. Kjo mund të ketë të bëjë me një sërë faktorësh: me nivelin e të kuptuarit dhe njohurive që këto bashki kanë në lidhje me strategjinë; me faktin se strategjia nuk është konceptuar me mekanizma që mund të përshtaten me rrethana fatkeqe dhe katastrofike; ose ndoshta me mungesën e kapaciteteve të bashkive për t’i përshtatur aktivitetet përkatëse të strategjisë me kontekstet e tyre vendore. **Rreth 72% e bashkive mendojnë se strategjia duhet të rishikohet për t’u përshtatur më mirë me dy rastet e fatkeqësive, apo me raste të ngjashme të së ardhmes, duke garantuar një qëndrueshmëri më të madhe të sektorit.** Megjithatë, nga ana tjetër, mungesa e bazave të përshtatshme të të dhënave të strehimit social në nivel vendor, njohuritë e kufizuara që kanë disa bashki lidhur me programe të caktuara të strehimit, si dhe roli i kufizuar që njësitë e qeverisjes vendore kanë pasur në trajtimin e pasojave të pandemisë, tregojnë se **strategjia mund të ketë nevojë si për një rishikim të planit të vlerësimit/zbutjes së rrezikut, ashtu dhe për mënyra të reja e më të mira për të përcjellë mesazhin dhe njohuritë e saj në nivelin vendor.**

Për ta përmbledhur, si pasojë e ndryshimeve drastike në kontekstin e jashtëm, por edhe për shkak të vështirësive me të cilat janë përballur bashkitë në kontekstin e brendshëm, **rëndësia dhe përshtatshmëria e strategjisë së strehimit social mbetet e konsiderueshme, por ka ende vend për përmirësim.** Siç duket, rishikimi i objektivave strategjike, nënobjektivave dhe qëllimeve, lidhet me kapacitetet vendore për zbatimin e programeve të strehimit social dhe me mungesën e bazave përkatëse të të dhënave. Për më tepër, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike duhet të përmirësohet më tej, dhe përfshirja e grupeve të interesit në vendimmarrjen lidhur me strehimin social duhet të intensifikohet, duke e përshtatur zbatimin e strategjisë me kontekstin vendor. E fundit, por jo për nga rëndësia, **strategjisë i nevojitet një plan i rishikuar i zbutjes së rrezikut**, për rritjen e mëtejshme të qëndrueshmërisë së sektorit. Në tërësi, për sa i përket rëndësisë dhe përshtatshmërisë, **pjesa më e madhe e ndryshimeve dhe përmirësimeve pritet të ndodhin në nivelin e planeve të veprimit, dhe jo në nivelin e objektivave.**




#### 4.2 Efektiviteti përkundrejt parimeve, objektivave dhe veprimeve

Vizioni i Strategjisë së Strehimit Social bazohet në **tri parime bazë**, konkretisht: i) nevojat për strehim të familjeve me të ardhura të ulëta, dhe veçanërisht grupeve në pozita të pafavorshme (sipas përcaktimit me ligj) përbëjnë përparësi; ii) politika e strehimit është rezultat i një qasjeje të integruar për strehim bazuar në parimet e gatishmërisë, aksesueshmërisë dhe përballueshmërisë së alternativave të strehimit cilësor; iii) sektori i strehimit është i integruar me sektorë të tjerë, të tillë si arsimi, shëndetësia, punësimi dhe mbrojtja sociale, dhe ndikon te mirëqenia sociale dhe ekonomike e familjeve (f. 29). Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 ka gjithashtu pesë (5) objektiva kryesore, konkretisht: i) rritja e kapaciteteve vendore lidhur me njohuritë mbi ofertën dhe kërkesën për strehim social; ii) përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e aksesit në strehim social të 50% të familjeve në pozita të pafavorshme; iii) koordinimi midis nivelit qendror dhe atij vendor për përmirësimin e shpërndarjes së banesave sociale në 61 autoritetet vendore; iv) zhvillimi i partneriteteve publike-private për përmirësimin e alternativave të strehimit social për të rritur aksesin në strehimin social me 20%; v) zgjerimi i alternativave të strehimit social për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, dhe veçanërisht ato në pozita të favorshme, me 30%. Ky seksion merret me analizën e efektivitetit në arritjen e objektivave dhe parimeve të strategjisë. Ai tregon statusin e çdo objektivi në nivelin më të gjerë të veprimeve të strategjisë dhe jep një panoramë më të hollësishme të arritjeve, bazuar në anketën vendore.

**Për sa i përket parimit të parë, gjatë katër viteve të fundit (2017-2020), bashkitë kanë zbatuar programe të ndryshme në mbështetje të grupeve vulnerabël.** Programi më i përdorur është subvencionimi i qirasë së tregut. Zbatimi i këtij programi mund të jetë rezultat i niveleve më të ulëta të investimit që kërkohet nga bashkitë. Gjithashtu, ky program përfiton edhe nga disponueshmëria e banesave me qira në treg, duke rritur ndjeshëm ofertën.

Figura 16. Programet e strehimit social të zbatuara nga bashkitë gjatë periudhës 2017-2020<sup>21</sup>



Burimi: Anketë e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020


Programi i 2-të që ka gjetur zbatim më të gjerë ka të bëjë me përmirësimin e kushteve të banimit, pasuar

<sup>21</sup> SH1. Subvencionimi i qirasë; SH2. Përmirësimi i kushteve të banimit dhe përshtatja e ndërtesave jorezidenciale; SH3. Strehimi me kosto të ulët; SH4. Zhvillimi i zonave për qëllime strehimi; SH5. Banesat e përkohshme; Banesat e specializuara.

nga programi i strehimit me kosto të ulët. Ndërkohë, **programi 6 (për banesat e specializuara) nuk është zbatuar nga asnjë prej bashkive të anketuara.** Kjo mund të ketë ardhur si pasojë e faktit se ky program është prezantuar rishtazi dhe **kuadri ligjor përkatës për zbatimin e tij ka fare pak kohë që është hartuar.** Ky përbën gjithashtu një prej shqetësimeve të ngritura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. Gjithashtu, edhe programi 5 (banesat e përkohshme) ka një nivel të ulët zbatimi, edhe pse familjeve të prekura nga tërmeti u janë siguruar banesa të specializuara, por mbi bazën e akteve normative me fuqinë e ligjit të nxjerra në kushtet e urgjencës.

Deri në vitin 2017, 63,6% e bashkive kishin zbatuar vetëm një program të strehimit social. Megjithatë, me kalimin e viteve, **është vënë re një tendencë pozitive, pasi bashkitë kanë filluar të zbatojnë më shumë se një program,** duke iu përgjigjur kështu nevojave të kategorive të ndryshme përfituese të strehimit social (figura 17).

Figura 17. Bashkitë që zbatojnë më shumë se 1 program të zbatimit social




Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

**Në vitin 2020, 17/29 bashki të anketuara zbatojnë më shumë se një program, krahasuar me raportin 9/23 në vitin 2017.** Kjo tregon se prioriteti që i jepet të shërbyerit të një sërë grupeve të ndryshme në nivel vendor është rritur me kalimin e viteve.

Për sa i përket parimit ii), **67,7% e bashkive të anketuara mendojnë se programet aktuale të strehimit janë të mjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave për strehim dhe grupeve vulnerabël.** Nga ana tjetër, **bashkitë shfaqin mangësi në aspektin e gatishmërisë së njësive të strehimit social/ofertës. 83,3% e bashkive raportojnë se nuk kanë opsione të gatshme strehimi social.** Gjithashtu, bashkitë pretendojnë se me opsionet ekzistuese të strehimit social, ato mund të mbulojnë mesatarisht 10% të kërkesave për strehim social, dhe maksimumi 30%. Ka edhe bashki të cilat nuk kanë asnjë opsion ekzistues strehimi, e për rrjedhojë nuk mund të mbulojnë asnjë kërkesë.

Për sa i përket parimit iii), **integrimi i politikës së strehimit me sektorë të tjerë, bashkitë përpiqen t’i integrojnë programet e tyre të strehimit me një larmishmëri grupesh përkatëse të interesit.** Figura 18 jep një panoramë të ndërthurjes së programeve të ndryshme të strehimit me sektorë të tjerë:

Figura 18. Integrimi i programeve të strehimit me sektorë të tjerë




Burimi: Anketë e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

**Mbrojtja sociale është e mirëintegruar, edhe pse jo njësoj në të gjitha programet e strehimit,** bazuar në përgjigjet e bashkive. Grafiku tregon se niveli më i lartë i integritimit është ai ndërmjet programeve të mbrojtjes social dhe banesave të specializuara (76,9%), pasuar nga mbrojtja sociale dhe subvencionimi i qirasë (58,8%) dhe mbrojtja sociale dhe banesat e përkohshme (52,6%). Kujdesi shëndetësor dhe arsimit janë të shpërndara pothuajse barabartë në të gjitha programet e strehimit dhe shfaqin tendencë të ngjashme bazuar në përgjigjet e bashkive. Ndërkohë, punësimi është i integruar më së shumti me programe të tilla si strehimi me kosto të ulët, zhvillimi i zonave për strehim social dhe përmirësimi i kushteve të banimit, ku bashkitë e anketuara variojnë midis 22,6% - 24% krahasuar me llojet e tjera të programeve të strehimit.

Një prej aspekteve që lidhen me koordinimin ndërmjet programeve të ndryshme është edhe bashkëpunimi ndërmjet bashkive dhe institucioneve në nivel kombëtar. Figura 19 jep një panoramë të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet 3 institucioneve kryesore në nivel kombëtar dhe bashkive, sipas raportimit nga bashkitë.

Figura 19: Niveli i bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe institucioneve në nivel kombëtar




Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Siç mund të shihet nga grafiku, **bashkitë kanë një bashkëpunim “të dobët” deri në “shumë të dobët”** me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Entin Kombëtar të Banesave. Mbi 50% e bashkive raportojnë një nivel të dobët deri në shumë të dobët bashkëpunimi me nivelin kombëtar. Duke marrë parasysh kapacitetet bashkiake, bashkëpunimi me këtë institucion është mjaft i rëndësishëm për të rritur dhe përmirësuar integrimin e programeve të strehimit me sektorë të tjerë socialë, dhe për të arritur efikasitet më të lartë në zbatimin e programeve.

Në nivelin e përgjithshëm të objektivit 3 të strategjisë (që fokusohet në bashkëpunimin institucional midis nivelit qendror dhe atij vendor dhe në përfshirjen e grupeve të interesit në programet e strehimit social), ka pasur dy aktivitete kryesore. Prodhimi i materialeve informuese lidhur me programet e strehimit social është realizuar në shkallë të pjesshme, dhe është arritur kryesisht në nivel vendor nga bashkitë, sipas shpjegimeve në vijim për komunikimin dhe ndarjen e informacioneve. Ndërkohë, aktiviteti tjetër, i cili fokusohet në ndarjen e roleve për strehimin social ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, OShC-ve dhe autoriteteve lokale, nuk është kryer ende. Megjithatë, është miratuar një akt nënligjor për përcaktimin e roleve të çdo institucioni, sipas objektivit 2.

Me rëndësi për rritjen e aksesit të grupeve vulnerabël në programet e strehimit social është edhe ndarja e informacioneve nga bashkitë. **Metodat më të parapëlqyera për ndarjen e informacioneve janë njoftimi pranë zyrave bashkiake, publikimi në faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe mediat sociale, por këto të fundit në një shkallë më të vogël.**

Figura 20. Metodatat e ndarjes së informacionit




Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Megjithatë, gjatë komunikimit me disa bashki (si për shembull Përmeti dhe Vau Dejës) u raportua se ndërgjegjësimi i komunitetit është mjaft i ulët. Situata mund të jetë e ndryshme në bashkitë më të mëdha, si Tirana, Shkodra apo Vlora, ku komunitetet apo grupet përfituese janë më të mirëorganizuar. Bashkitë e shohin komunikimin me komunitetet si një sfidë, dhe organizojnë shpeshherë takime të posaçme ku një anëtar i stafit të sektorit të strehimit viziton njësi të ndryshme administrative për të ofruar mbështetje me anë të ndarjes së njohurive. 66,7% e bashkive mendojnë se metodat aktuale të komunikimit janë të mjaftueshme. Megjithatë, nga ana tjetër, 60% e bashkive të anketuara mendojnë se duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të përmirësuar komunikimin në lidhje me programet e strehimit social.

Bazuar në të dhënat nga 34 bashkitë e anketuara, programet e strehimit social janë aksesuar nga pothuajse të gjitha grupet e synuara. Përrjashtim bëjnë punonjësit e brigadës së zjarrfikësve, të miturit në konflikt me ligjin pas vuajtjes së dënimit të tyre dhe viktimat nga komuniteti LGBTI. Megjithatë, **jo të gjithë përfituesit kanë pasur të njëjtin akses në programet e strehimit**. Përfituesit e ndihmës ekonomike, kryefamiljaret femra dhe personat me aftësi të kufizuara përbëjnë 11-12% të familjeve përfituese për çdo kategori, pasuar nga romët, egjiptianët dhe familjet me një prind, të cilët përfaqësojnë 8-9% të familjeve përfituese për çdo kategori. Grupi i tretë, ku 5-7% e familjeve për çdo kategori përfitojnë nga programet, përbëhet nga të moshuar, familje të mëdha, çifte të reja, viktimat të dhunës në familje dhe gra të dhunuara. Siç mund të kuptohet edhe nga të dhënat, **raportet ndërmjet grupeve të përfituesve kanë pësuar ndryshime mjaft të vogla gjatë katër viteve të fundit**. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2017, gjatë dy viteve të fundit ka pasur rritje të llojeve të kategorive që kanë pasur akses në programet e strehimit social. Kjo mbështetet gjithashtu nga fakti **se bashkitë e anketuara mendojnë (90,3%) se kriteret e përdorura në sistemin e bazuar në pikë për përzgjedhjen e përfituesve të programeve të strehimit janë realiste**, pra u sigurojnë qytetarëve një procedurë më të drejtë përzgjedhjeje. Në mënyrë të ngjashme, **82,4% e bashkive të anketuara mendojnë se, përveçse realist, sistemi i bazuar në pikë është edhe i përshtatshëm**. Një grup përfituesish që përbëjnë ende shqetësim për sa u përket të drejtave të njeriut në një nivel politik më të lartë dhe në kuadër të integritimit në BE, janë refugjatët. Progres raporti 2020 i BE-së për Shqipërinë konstaton se "Përrjashtimi i refugjatëve nga strehimi social ... mbetet ende për t'u trajtuar, pasi përpjekjet për ofrim të asistencës për integrim janë

disi të limituara.” (Komisioni Evropian, 2020, f. 47). Në bashkitë e anketuara, azilkërkuesit (në total) përbëjnë vetëm 1% të përfituesve gjatë viteve 2017-2020.


Figura 21. Aksesit i grupeve vulnerabël në programet e strehimit social gjatë periudhës 2017-2020



Burimi: Anкета e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që mund të ketë ndikuar në shpërndarjen e banesave sociale mes grupeve përfituese është bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve). Sipas përgjigjeve të bashkive, **43,8% e tyre punojnë me OShC-të për identifikimin e grupeve vulnerabël dhe 46,9% punojnë me OShC-të për alokimin e banesave sociale** te grupet vulnerabël. Ky është një proces i rëndësishëm, pasi bashkëpunimi ndërmjet bashkive dhe OShC-ve mund të ndihmojë në përmirësimin e aksesit në programet e strehimit social për grupet vulnerabël. Për sa i përket konsultimit, përgatitja e sistemit të bazuar në pikë është gjithashtu me rëndësi. Kur bashkitë u pyetën nëse i kishin konsultuar sistemet e tyre të bazuara në pikë me 1) organizatat e shoqërisë civile, 2) OJF-të, 3) Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe 4) institucione të tjera (Këshilli Vendor Bashkiak), përgjigjet e tyre ishin të larmishme:

Figura 22. Konsultimi i kriterëve të përzgjedhjes të bazuara në pikë me grupet e interesit



Burimi: Anketë e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Bashkitë kanë një tendencë prej 66,7% për t'i konsultuar sistemet e tyre të bazuara në pikë me organizatat e shoqërisë civile. Ndërkohë, konsultimi me institucione të tjera, si Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ose Këshilli vendor Bashkiak është në nivele më të ulëta.

Objektivi 5 i strategjisë përbëhet nga 5 aktivitete kryesore. Një prej aktiviteteve që fokusohen në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet rome dhe egjiptiane ka vazhduar zbatimin e tij gjatë periudhës 2016-2020, dhe për vitin e kaluar, fondi i alokuar ishte në vlerën 120 milionë lekë. Në mënyrë të ngjashme, është zbatuar edhe aktiviteti 5, i cili fokusohet në programin e subvencionimit të qirasë. Aktiviteti 2, i cili fokusohet në efikasitetin e energjisë së ndërtesave, është zbatuar vetëm deri në vitin 2017, me një program të posaçëm në buxhetin e shtetit, por fill pas kësaj (periudhë e cila përkoi gjithashtu me shpërbërjen e Ministrisë së Zhvillimit Urban), programi u ndërpre. Ndërkohë, aktivitetet 3 dhe 4, të cilat fokusohen në një studim fizibiliteti për shndërrimin dhe përcaktimin e tokave në pronësi shtetërore për zhvillimin e banesave sociale dhe rehabilitimin e ndërtesave për strehimin e jetimëve, nuk janë kryer ende. Megjithatë, në nivel vendor dhe kombëtar janë zhvilluar shumë aktivitete që kanë zgjeruar mundësitë për strehim për kategori të ndryshme të paparashikuara në strategji, por në përputhje me ndryshimet ligjore.

Aspektet që janë marrë në konsideratë **për të kuptuar shkallën e pajtueshmërisë me standardet e strehimit social** në Shqipëri për qëllimet e këtij raporti vlerësimi janë **vendndodhja e banesave (në përputhje me vendndodhjet e parapëlqyera të grupeve vulnerabël, standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, efikasiteti dhe energjisë dhe strehimi përfshirës** (që nënkupton shkallën në të cilën banesat sociale janë integruar në ndërtime shumëfunksionale).

Bashkitë kanë pasur një shkallë të ulët reagimi lidhur me pozicionimin e strehimit social në kuadrin e zhvillimit shumëfunksional. Gjithashtu, nga përgjigjet e marra, një përqindje e vogël prej **vetëm 7,8% e ofertës aktuale për banesa social duket se është e integruar në ndërtime shumëfunksionale**. Kjo ka të bëjë kryesisht me strehimin me kosto të ulët, ndërkohë që programet e subvencionimit të qirasë varet nga lloji i subvencioneve të ofruara. Për rrjedhojë, qasja kryesore për ofrimin e strehimit social në nivel vendor është ajo përmes zhvillimeve të izoluar të strehimit social. Megjithatë, kjo qasje arrin të realizojë

ofrimin e strehimit, por nuk mjafton për të përmbushur standardet e strehimit. Strehimi përfshirës është një prej parimeve dhe politikave kryesore që po zbatohen në mbarë botën në kuadër të përpjekjeve për t'u larguar nga ideja e krijimit të lagjeve të dedikuara plotësisht për strehimin social, e cila mund të rrisë rreziqet e getoizimit, dhe për të kaluar në integrimin e banesave sociale në ndërtime shumëfunktionale. Kjo është e rëndësishme nga aspekti i integritit social të grupeve vulnerabël dhe aksesit të tyre në shërbime të tjera. Për më tepër, duke qenë se ligji për strehimin social parashikon një instrument financiar që garanton strehim përfshirës, kjo do të thotë se bashkitë duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të shfrytëzuar partneritetet publike-private si një instrument për ofrimin e strehimit social.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm lidhur me standardet është vendndodhja e banesave sociale, **pra disponueshmëria e banesave në pozicione të parapëlqyera/të përshtatshme për nevojat e grupeve vulnerabël.** Nga 22 pyetje në total, **45,5% e bashkive u përgjigjën se banesat ndodhen në pozicione pjesërisht të parapëlqyera** nga grupet vulnerabël, **ndërkohë që 27,3% u përgjigjën se banesat ndodhen në zona gjerësisht të parapëlqyera** nga grupet vulnerabël. Kjo tregon se **banesat e ofruara kanë një tendencë të përgjithshme për të përmbushur preferencat e strehimit të krahut të kërkesës.** Megjithatë, nuk ndodh gjithmonë kështu, siç u konstatua edhe nga intervistat me personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë kërkesa më të mëdha lidhur me përshtatshmërinë e vendndodhjes së banesave. Përshtatja e vendndodhjes së banesave për përfituesit është me rëndësi thelbësore për integrimin social dhe ekonomik të grupeve vulnerabël. Banesat sociale që ndodhen në zona të pranuar dhe/ose të preferuara nga grupet vulnerabël rrisin mundësitë e punësimit dhe mundësitë e aksesit në shërbime të tjera.

Për sa u përket standardeve të strehimit social, dy aspektet e tjera kryesore që janë analizuar i referohen **efiçencës së energjisë dhe aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.** Për të dyja pyetjet, shkalla e reagimit të bashkive ka qenë e ulët. Përgjigjet tregojnë se, në Shqipëri, **vetëm 16,9% e banesave aktuale sociale përmbushin standardet e efiçencës së energjisë.** Duke pasur parasysh se legjislacioni mbi efiçencën e energjisë ka evoluar me shpejtësi përgjatë periudhës 2013-2016, sektori i strehimit social ka rezultuar i ngadaltë në përshtatjen e këtyre kërkesave të reja. Në këtë drejtim, fakti se **kontrolli dhe certifikimi energjetik i ndërtesave nuk është kryer** ende, kjo përqindje prej 16,8% duhet të konsiderohet si opinion për sektorin social, më tepër sesa si një përgjigje përfundimtare dhe e konfirmuar. Gjithashtu, niveli i ulët i reagimit **tregon në njëfarë mënyre mungesën e ndërregjyjesimit dhe të dhënave në nivel bashkiak lidhur me këtë çështje.** Për sa i përket aksesueshmërisë, për personat me aftësi të kufizuara në banesa sociale, vetëm 7,8% e banesave aktuale përmbushin disa standarde. Gjithashtu, sipas intervistave me grupet e interesit (Federata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve dhe Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë), standardet e përmbushura lidhen kryesisht me praninë e rampave, ashensorëve dhe shenjave. Ndërkohë, në hapësirat e brendshme të apartamenteve, ka mangësi lidhur me hapësirën dhe nevojat e këtyre grupeve vulnerabël.

Objekti 4 lidhet me përdorimin e partneriteteve publike-private (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social, përbëhet nga gjashtë aktivitetet, dhe vetëm një prej tyre është realizuar plotësisht. Ky aktivitet fokusohet te vlerësimi i modeleve të PPP që mund të zbatohen për alternativat e strehimit social. **Vetëm një prej 23 bashkive ka arritur të zbatojë PPP-të për përmirësimin e ofertës së banesave sociale.** Në këtë rast, përmes një PPP-je, bashkia ka arritur të përmirësojë kushtet e banimit për 75 familje



dhe ka garantuar 60 banesa të reja me kosto të ulët. Kjo është arritur me anë të kontratave të PPP. **88,9% e bashkive raportojnë se shoqëritë private nuk kanë asnjë interes të përfshihen në çështjet e strehimit social.** Kjo përforcohet edhe më tej nga fakti se 94,4% e bashkive raportojnë se nuk kanë marrë ndonjë kërkesë zyrtare/shprehje interesi nga kompanitë private për t'u përfshirë në këtë sektor. Megjithatë, nga ana tjetër, **bashkitë (85,3%) nuk kanë ndërmarrë asnjë nismë për përfshirjen e shoqërive private në çështjet e strehimit social.**

Aktivitetet në kuadër të objektivit nr. 2 të strategjisë janë realizuar në shumicën e rasteve. Prej 15 aktiviteteve të planifikuara, 13 janë realizuar plotësisht, dhe 2 të tjera janë në proces. Ky objektiv është fokusuar kryesisht në kuadrin ligjor dhe institucional. Pas miratimit të ligjit për strehimin social në vitin 2018, u miratua edhe pjesa më e madhe e akteve nënligjore, ndërsa disa prej tyre janë ende në përgatitje e sipër. Zbatimi i këtij objektivit supozohej të kryhej gjatë periudhës 2016-2017. Megjithatë, duke qenë se ligji është miratuar në vitin 2018, përgatitja e të gjitha akteve nënligjore ka ardhur pas këtij viti, gjë që ka shkaktuar vonesa të mëtejshme të aktiviteteve në kuadër të disa prej objektivave të tjera.

**88,9% e bashkive të anketuara raportojnë se pjesa më e madhe e problematikave që lidhen me strehimin social trajtohen tashmë nga legjislacioni.** Gjithashtu, si rezultat i përmirësimeve ligjore, **63,6% e bashkive (21/33) raportojnë se numri i përfituesve nga programet e strehimit social ka pësuar rritje që prej vitit 2016.** Megjithatë, disa bashki deklarojnë se, për familjet me të ardhura nën mesataren, të cilat mund të ndërtojnë shtëpitë e tyre, barra financiare për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurat është e lartë. Për rrjedhojë, mund të ofrohet një farë mbështetjeje për të reduktuar kostot institucionale të ndërtimit të një banese për këto lloj familjesh.


Një prej faktorëve kryesorë që lidhen me suksesin e programeve të ndryshme të strehimit ka të bëjë me procedurat e zbatuara nga bashkitë. Lidhur me këtë faktor, **48,6% e bashkive pranojnë se procedurat dhe dokumentet e kërkuara për aplikimin në programe të strehimit social janë të lehta, të kuptueshme dhe të komunikuar mirë nga bashkitë, ndërkohë që 34,3% janë shprehur neutrale..** Megjithatë, nga diskutimet me përfaqësues të grupeve të ndryshme vulnerabël, duket qartë se kjo përbën një sfidë në disa bashki. Për shembull, komunitetet romë dhe egjiptiane **theksojnë faktin se disa bashki zbatojnë procedura dhe kërkesa dokumentacioni ekstra,** duke e vështirësuar procesin dhe duke i shkurajuar aplikantët. Në mënyrë të veçantë, bashkia e Tiranës është në shkelje të kërkesave ligjore, duke qenë se, me anë të një rregulloreje të posaçme, u kërkon aplikantëve të japin të gjithë dokumentacionin, ndërkohë që legjislacioni parashikon se është detyrë e bashkisë që ta mbledhë këtë informacion dhe të kryejë verifikimet e nevojshme. Një shembull i tillë është **programi i subvencionimit të qirasë, për të cilin bashkia e Tiranës kërkon një kontratë të nënshkruar ndërmjet aplikantit dhe pronarit përpara aplikimit.** Kjo procedurë krijon një barrë dhe presion të madh për aplikantët, pasi asnjë pronar banese nuk pranon të nënshkruajë një kontratë pa u siguruar se familja ka aftësinë për t'i paguar detyrimet.

Për sa i përket objektivit 1 të strategjisë, prej 21 aktiviteteve, vetëm 3 janë realizuar plotësisht dhe 2 janë realizuar vetëm pjesërisht. Në përgjithësi, ky aktivitet është fokusuar në përgatitjen e raporteve mbi kushtet e banesave sociale të ofruara në nivel vendor dhe në ofrimin e mbështetjes për autoritetet vendore, në mënyrë që ato të kuptojnë më mirë situatën në lidhje me strehimin social. Sistemi elektronik, i cili është është konceptuar për të shërbyer si shtylla kurrizore e këtij objektivit, është planifikuar të vihet

në përdorim në vitin 2021, gjë që ka shkaktuar vonesa në zbatimin e aktiviteteve të tjera.


Një prej **sfidave kryesore** me të cilat janë përballur bashkitë për zbatimin e programeve të ndryshme të strehimit lidhet me **kapacitetet financiare**. Figurat 23 dhe 24 japin një paraqitje të nivelit të vështirësisë me të cilin përballen bashkitë në zbatimin e secilit prej programeve të strehimit, përkundrejt kapaciteteve të tyre financiare.

Figura 23. Niveli i vështirësisë me të cilin përballen bashkitë në lidhje me kapacitetet financiare



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Figura 24. Vlerësimi mesatar nga 1 (shumë i lehtë) deri në 6 (i pamundur) për çdo program të strehimit social (perceptimi i bashkive bazuar në vështirësitë teknike dhe financiare)



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020


Siç duket, **programet që konsiderohen si më të lehta për t'u zbatuar nga bashkitë janë subvencionimi i qirasë dhe përmirësimi i kushteve të banimit** (banesat ekzistuese). Ndërkohë, programe të tilla si strehimi i përkohshëm, strehimi i specializuar ose zhvillimi i një zone për strehim, janë tejet të vështira, dhe në disa raste pothuajse të pamundura për t'u zbatuar, duke pasur parasysh kapacitetet financiare të

bashkive. Në të njëjtin kuadër, **40% e bashkive të anketuara shprehen se kapacitetet e tyre financiare kanë pësuar rritje gjatë periudhës 2017-2020, ndërkohë që 45,5% deklarojnë se këto kapacitete kanë mbetur të pandryshuara.** Niveli i perceptuar i vështirësisë mund të ketë më shumë lidhje me kapacitetet dhe njohuritë për zbatimin e programit sesa me fondet e disponueshme.

Kështu, kapacitetet financiare bashkiake janë mjaft të rëndësishme për zbatimin e programeve të ndryshme të strehimit, ashtu si edhe burimet njerëzore. **70,3% e bashkive të anketuara deklarojnë se numri i stafit nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjashta programet e strehimit social.** Krahas numrit të stafit të punësuar në sektorin e strehimit **bashkitë janë të ndara edhe për nga kualifikimi i stafit të tyre për menaxhimin e programeve të strehimit, me 50%.** Kjo tregon se situata varion nga bashkia në bashki, dhe se mund të nevojitet një qasje e personalizuar për të rritur kapacitetet e burimeve njerëzore, si dhe kualifikimet e tyre.

Në përgjithësi, për sa u përket burimeve (figura 25), bashkitë deklarojnë se kanë toka të mjaftueshme për zhvillimin e banesave sociale, ndërkohë që shprehen se ka kryesisht mungesë të fondeve dhe ndërtesave. Është e qartë se situata nuk është universale, pasi ndodh rëndom që bashkitë të pretendojnë se nuk kanë toka.

Figura 25. Burimet bashkiake për përmbushjen e kërkesës për strehim social



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020


Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 ka propozuar një **sistem për monitorimin e zbatimit të strategjisë**, si dhe të situatës së përgjithshme të sektorit të strehimit social në Shqipëri. Sistemi i monitorimit përbëhet nga një sërë treguesish. Duke u nisur nga sistemi i monitorimit (treguesit për planin e veprimit dhe qëllimet e strategjisë), pjesa më e madhe e të dhënave pritet të sigurohen nga niveli vendor (bashkitë). Gjithashtu, është parashikuar të instalohet një sistem elektronik për sigurimin e këtij informacioni në rrugë automatike. Aktualisht, **sistemi elektronik është në fazat përfundimtare, dhe pritet të vihet në punë brenda fundit të vitit 2020, ose maksimumi në fillim të vitit 2021.** MFE ka kryer gjithashtu trajnime me bashkitë lidhur me sistemin elektronik. **75,5% e bashkive të anketuara konfirmojnë se kanë marrë pjesë në këto trajnime për sistemin elektronik.** Vonesat me sistemin elektronik kanë penguar raportimin dhe mbledhjen e të dhënave nga bashkitë dhe niveli qendror. Pra, pyetja këtu nuk lidhet edhe aq me treguesit që përdoren, sesa me mënyrën sesi ata mblidhen.

Pritej që bashkitë të identifikonin grupet vulnerabël në bashkinë e tyre gjatë periudhës 2016-2020, në kuadër të ngritjes së një sistemi të integruar informacioni për strehimin social. Megjithatë, deri më tani, vetëm **77,1%** e bashkive raportuese e kanë kryer këtë aktivitet, ndërkohë që vetëm **61,8%** e bashkive raportuese kanë identifikuar edhe vendndodhjen e tyre territoriale. Ky është një prej aktiviteteve thelbësore për të filluar krijimin e bazave të të dhënave. Ndonëse pjesa më e madhe e bashkive konfirmojnë se kanë identifikuar vendndodhjen territoriale të grupeve vulnerabël, **asnjë bashki nuk përdor GIS për qëllimet e krijimit të një baze të dhënash**. Shumica e të dhënave në nivel bashkiak mbahen në tabela Excel-i, ku **23,5%** e bashkive të anketuara deklarojnë se kanë baza të detajuara të dhënash në Excel, ndërkohë që **50%** mbajnë në Excel vetëm të dhënat kryesore. Në këtë rast, shqetësimi ka të bëjë me faktin se **26,5%** e bashkive i dokumentojnë të dhënat në formë fizike ose nuk kanë fare të dhëna (**14,7%**). Duke pasur parasysh se shumica e të dhënave mbi monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe situatën e sektorit të strehimit social pritet të burojnë nga niveli vendor, **kjo mungesë të dhënash mund të konsiderohet si një prej sfidave kryesore të procesit.**

Megjithatë, një përmirësim pozitiv që prej vitit 2016 është fakti se bashkitë raportojnë një zgjerim dhe diversifikim të të dhënave të mbledhura prej tyre në lidhje me strehimin social. **82,9%** e bashkive raportuese kanë diversifikuar dhe zgjeruar llojin e të dhënave që ato mbledhin dhe ruajnë në lidhje me aspektet e strehimit social dhe programet përkatëse. Të dhënat e reja fokusohen më së shumti te kategoritë e ndryshme të kualifikueshme për programet e strehimit social. Megjithatë, nga ana tjetër, **81,8%** e bashkive raportuese nuk kanë të dhëna rreth pronarëve sociale. Regjistrimi i pronarëve socialë është një element i rëndësishëm për programet e strehimit, veçanërisht për programin e subvencionit të qirasë.

Së fundi, **25 bashki raportojnë se kanë një regjistër funksional të personave të pastrehë**, me një numër total të raportuar prej 11 530 personash të pastrehë. Figura 26 tregon numrin total të personave të pastrehë të raportuar nga secila prej bashkive, në raport me mesataren kombëtare.

Figura 26. Përqindja e personave të pastrehë për bashki, në raport me mesataren kombëtare



Burimi: Anketat e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Numri më i lartë i raportuar i personave të pastrehë është në bashkinë e Shkodrës, me rreth 2200 të pastrehë (19,1% e totalit). Në bashkinë e Pogradecit ka 1688 persona të pastrehë, që përfaqësojnë 14,6% të totalit të personave të pastrehë në 24 bashki raportuese, pasuar nga bashkitë e Vlorës (12,1%) dhe Lezhës me 10,3% të totalit. Krahasuar me popullsinë totale të censusit, numri i personave të pastrehë në bashkitë e anketuara është mesatarisht 1,2% e popullsisë përkatëse.

#### 4.3 Efiçenca përkundrejt produkteve

Zbatimi i SSS-së për periudhën e vlerësimit ka pasur një ecuri më të ngadaltë nga ç'ishte parashikuar, duke u fokusuar më tepër te përgatitja e legjislacionit. Nga 55 aktivitetet e planifikuara në strategji, 23 prej tyre janë raportuar nga ministria si të pazbatuara. Aktivitetet e tjera janë zbatuar ose janë në proces, me një vlerë të planifikuar prej 60 670 000 lekësh. Në strategji, rreth 1,5 miliardë lekë ishin planifikuar për zbatimin e marrëveshjeve të PPP-ve për ndërtimin e banesave sociale gjatë periudhës 2016-2020, por aktivitetet përkatëse (në kuadër të OS4), janë raportuar nga ministria si të pazbatuara. Megjithatë, është raportuar të paktën një PPP për bashki, si dhe bashkëpunimi me bankat për programin e subvencionimit të qirasë. Për më tepër, aktivitetet e OS5 konsistojnë në zbatimin e programeve të ndryshme të strehimit dhe subvencioneve të ndryshme për strehimin social, dhe janë planifikuar për të gjithë kohëzgjatjen e strategjisë, me një vlerë totale prej rreth 5,6 miliardë lekë.

Duke qenë se bashkitë kanë vazhduar shpenzimet për programet e strehimit social, janë shpenzuar rreth 2,8 miliardë lekë në këtë drejtim. Lidhur me investimet dhe subvencionet për periudhën 2016-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton të dhënat e pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Fondet e planifikuara për OS5 dhe investimet dhe subvencionet e zbatuara gjatë periudhës 2016-2020, në lekë

Periudha 2016-2020	Fondet e planifikuara për OS5 (2016-2025)	Investimet dhe subvencionet (2016-2020)
Programet e strehimit	2 176 434 000	1 505 741 212
Subvencione dhe grante	3 484 317 624	4 240 633 213
<b>Totali</b>	<b>5 660 751 624</b>	<b>5 746 374 425</b>

Burimi: Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 (tabela 3.1 Buxheti i nevojshëm) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (shpenzimet e raportuara)


Siç duket nga tabela, shuma e planifikuar për programet dhe subvencionet e strehimit social për të gjithë kohëzgjatjen e strategjisë është shpenzuar dhe madje është tejkaluar gjatë periudhës afatmesme. Këto shpenzime i atribuohen kryesisht shumës prej 24 milionë lekë të shpenzuar në Vorë, Krujë, Kavajë dhe Kurbin pas tërmetit, gjatë dhjetorit të vitit 2019, dhe shumës prej 2,9 miliardë lekë të shpenzuar gjatë vitit 2020 në të gjitha bashkitë e prekura nga tërmeti.

Në përgjithësi, zbatimi i strategjisë ka ecur në një hap me shpenzimet e raportuara, pa ndonjë përmirësim në efiçencë gjatë periudhës afatmesme. Megjithatë, ndonëse kjo mund të duket si një shumë e barabartë apo edhe më e madhe se ajo që ishte planifikuar të shpenzohej, kjo i atribuohet gjendjes së papritur të

shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit dhe barrës tejet të lartë që i është ngarkuar financave kombëtare nga kjo katastrofë. Për më tepër, rritja e shumëfishte e kërkesës për strehim gjatë vitit 2020 ka rezultuar në përqendrimin e fondeve shtesë në një rajon specifik të rajonit. Këto fonde shtesë nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi tek ato të planifikuara për strehimin social. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme që, gjatë viteve në vijim, barra financiare e krijuar nga tërmeti të mos shkaktojë reduktim të fondeve që duhet të alokohen për strehimin social.

Për sa u përket fondeve, 87% e bashkive të anketuara i konsiderojnë ato si të pamjaftueshme për të trajtuar nevojat e tyre për strehim social. Gjithashtu, 60% e bashkive të anketuara raportojnë se kanë investuar burime nga fondet e veta në strehimin social (siç është konfirmuar edhe nga MFE). Më shumë se gjysma e bashkive të anketuara nuk arrijnë të japin një opinion mbi lehtësinë e aksesit në fondet e strehimit social të ofruara nga qeveria qendrore (figura 27). Gjithashtu, mbetet e paqartë nëse bashkitë bëjnë ndonjë farë lidhjeje midis lehtësisë së aksesit në fonde dhe cilësisë së burimeve të tyre njerëzore. Në fakt, vetëm 44% e bashkive anketuese kanë investuar në burime njerëzore, dhe në pjesën më të madhe të rasteve kjo përfshin një rritje të numrit të stafit, por asnjë trajnim.

Figura 27. Lehtësia e aksesit të bashkive në fondet e strehimit social në nivelin qendror




Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Për sa u përket procedurave të aksesit në programet e strehimit social, duket se bashkitë janë të dyzuara në shifra thuajse të barabarta ndërmjet “një procedure komplekse” dhe “një procedure të përshtatshme”. Siç duket, kjo mbështetet edhe nga informacioni që bashkitë ofrojnë mbi numrin e ditëve që nevojiten për përfundimin e procedurave. Numri mesatar i ditëve të shpenzuara për përfundimin e procedurave në nivel vendor është 19, ndërkohë që minimumi varion midis një dhe go ditëve. Në mënyrë të ngjashme, kur bëhet fjalë për procedurat bankare që lidhen me programet e strehimit (sipas rastit), ka ende ekstreme në kohën e raportuar - mesatarja është go ditë, me një minimum prej dy ditësh dhe një maksimum prej një viti, siç konfirmohet nga bashkitë.

#### 4.4 Qeverisja

Strehimi social është një funksion i qeverisjes vendore, i përkufizuar si **shërbim social** nga neni 24 i Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Ky është një tregues i qartë se strehimi social përfshihet në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe duhet të trajtohet si i tillë në strukturat përkatëse të qeverisjes. Siç e tregojnë edhe të dhënat nga anketa vendore, në pothuajse 41% të bashkive të anketuara, strehimi social ofrohet nga një strukturë e brendshme (drejtori, departament, sektor apo zyrë) që është kryesisht përgjegjëse për shërbime të tjera, të tilla si: planifikimi territorial/urban, infrastruktura dhe shërbimet publike, ndihma ekonomike, mbrojtja civile dhe/ose emergjencat civile dhe investimet publike. Bashkitë e tjera kanë një drejtori specifike për strehimin social (37,5%) ose një sektor (21,9%).

Figura 28. Struktura institucionale për strehimin social në nivel vendor



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Këto struktura institucionale janë pasojë e aksesit në burime njerëzore dhe e implikimeve buxhetore për çdo bashki. Për rrjedhojë, numri mesatar i ekspertëve të strehimit social të punësuar në bashkitë e anketuara është dy, ku 66,7% e bashkive kanë vetëm një anëtar stafi të punësuar për shërbimin. Shpeshherë, ky person është përgjegjës edhe për detyra të tjera përtej strehimit social. Numri më i lartë i stafit të strehimit social raportohet nga bashkia e Tiranës, me 10 punonjës të dedikuar, pasuar nga Roskoveci dhe Puka me 8 punonjës secila, dhe Delvina me 7 punonjës. Edhe pse këto të fundit kanë një staf relativisht të madh për strehimin social, kjo lidhet me ngjarje specifike të kufizuara në kohë (siç është rasti i Pukës), ose ky staf përbëhet nga ekspertë të cilët kryejnë edhe detyra të tjera njëkohësisht. Mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme reflektohet gjithashtu edhe në mungesën e një koordinatori social në 65,7% të bashkive të anketuara.

Numri i vogël i punonjësve të dedikuar për strehimin social, dhe ndonjëherë edhe njohuritë e tyre të pamjaftueshme mbi programet, janë në fakt dy prej arsyeve që ndikojnë në cilësinë e shërbimit të ofruar nga bashkitë dhe, për rrjedhojë, në zbatimin e SSS-së në nivel vendor. Megjithatë, pjesa më e madhe e

bashkive përmendin edhe mungesën e fondeve, mungesën e strukturave të strehimit (ndërtesave) dhe/ose tokës dhe përputhjen midis procedurave dhe kritereve ligjore dhe aftësinë e kategorive në nevojë për t'i përmbushur këto kritere. Edhe pse jo shpesh, disa bashki përmendin edhe mungesën e strategjive/planeve vendore të strehimit social dhe nivelin e ulët të koordinimit ndërmjet instrumenteve të planifikimit.

Në fakt, kur u pyetën për praninë e një strategjie/plani të strehimit social për 5-10 vitet e ardhshme, 66,7% e bashkive u përgjigjën se nuk kanë e kanë një të tillë, apo nuk kanë fare dijeni. Edhe pse ligji aktual për strehimin social kërkon që çdo bashki të ketë një program 5-vjeçar të strehimit social, ato që deklarojnë se e kanë një program të tillë (12 nga 36), e kanë atë mbi bazën e strategjisë vendore 10-vjeçare të kërkuar nga legjislacioni i mëparshëm. Për rrjedhojë, më shumë sesa qeverisin një funksion vendor, bashkitë veprojnë si zbatuese të një shërbimi, duke u bazuar kryesisht në atë çfarë duket më e realizueshme në territoret e tyre sipas kërkesës për strehim social. Për shkak të kësaj, por edhe të mungesës së njohurive lidhur me disa prej programeve, bashkitë fokusohen kryesisht tek zbatimi i programit të subvencionimit të qirasë.

Gjithashtu, disa bashki (18 nga 36) e kanë trajtuar strehimin social në mënyrë strategjike, duke i përfshirë objektivat përkatëse në planet e tyre vendore territoriale. Kjo qasje i jep strehimit social një dimension territorial, të paktën në një nivel strategjik. Ndonëse numri i bashkive është i vogël, ky integrim është mjaft pozitiv, veçanërisht duke pasur parasysh se të gjitha sistemet aktuale vendore të informacionit për strehimin social nuk janë të referuara në nivel territorial. Përrjashtim bën vetëm hartëzimi i disa prej kategorive të disavantazuara që përfitojnë nga ligji për strehimin social, siç shpjegohet më thellë në vijim. Kjo qasje lehtëson edhe koordinimin e politikave të strehimit social dhe atyre të planifikimit territorial në nivelin vendor.


Megjithatë, vetëm 12 bashki raportojnë se kanë përfshirë projekte të strehimit social në PPVT-të e tyre, dhe 15 bashki kanë zona të caktuara për zhvillimin e banesave sociale në hartuat e PPVT. Përmasat e këtyre zonave variojnë nga 665 m<sup>2</sup> në bashkinë e Klosit deri në 60 000 m<sup>2</sup> në Korçë. Megjithatë, vetëm katër bashki raportojnë se kanë përdorur pjesë relativisht të limituara të zonave të planifikuara. Në përputhje me ligjin për planifikimin territorial dhe ligjin për strehimin social, shtatë nga 36 bashki raportojnë se kanë përdorur programin e intensitetit të ndërtimit me kushte<sup>22</sup> për ofrimin e strehimit social.

Figura 29. Madhësia e sipërfaqeve (m<sup>2</sup>) të caktuara për banesa sociale në Planet e Përgjithshme Vendore Territoriale

---

<sup>22</sup>Njohur ndryshe si "raporti i sipërfaqes shtesë mbi tokën".






Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Për më tepër, 13 bashki kanë përdorur instrumentin e “3% të sipërfaqes së ndërtimit” që zhvilluesit duhet t’u ofrojnë bashkive për strehimin social. Edhe pse intensiteti i ndërtimit me kushte konsiderohet si një instrument i përshtatshëm nga zhvilluesit, bashkitë preferojnë instrumentin e dytë, ndonëse ky i fundit kundërshtohet fort nga zhvilluesit për arsye etike dhe ligjore. Gjithashtu, nuk dihet se në ç’masë fondet e grumbulluara përmes instrumentit “3% e sipërfaqes së ndërtimit” janë përdorur për strehimin social. Ligji specifikon qartë se 3%-shi duhet të llogaritet mbi sipërfaqen funksionale të ndërtimit, por disa bashki aplikojnë kontributin barasvlerës në para. Përveç faktit që është një instrument i ri dhe me përvoja të kufizuara zbatimi, shpenzimet e lidhura me përdorimin e këtij instrumenti në programet e strehimit social nuk janë gjurmuar ende. Bashkitë nuk kanë raportuar vlera kur janë pyetur për banesat sociale të financuara përmes këtyre të ardhurave. Në përgjithësi, bashkitë nuk bëjnë gjurmim të shpenzimeve për qëllime të llogaridhënies financiare. Të ardhurat, me përjashtim të rasteve kur burojnë nga një tarifë, janë gjithnjë të pamjaftueshme dhe zakonisht përzihen dhe përdoren sipas nevojës, e jo sipas burimit të gjenerimit të tyre. Ndërkohë që bashkitë bëjnë përpjekje për të vlerësuar nevojat për strehim social (85,7% e tyre), një pjesë më e vogël (51,5%) i vlerësojnë kapacitetet fiskale të reagimit ndaj nevojave si të mira.

Për kryerjen e funksionit të strehimit social, bashkitë grumbullojnë të dhëna mbi kërkesën dhe regjistrojnë të dhënat mbi zbatimin e programeve të ndryshme. Megjithatë, situata me bazat vendore të të dhënave është tejet e pakënaqshme. 70,3% e 37 bashkive të anketuara regjistrojnë të dhëna mbi kërkesën për strehim social, ndërkohë që vetëm 20,6% (nga 34 bashki) mbajnë inventare mbi ofertën. Bazat e të dhënave janë të hartuara kryesisht në tabela Excel-i dhe Word-i (80%), siç tregohet në figurën 30, dhe nuk kanë asnjë lidhje me territorin.


Figura 30. Sistemi i përdorur nga bashkitë për të regjistruar dhe ruajtur të dhëna mbi strehimin social



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Vetëm dy bashki i përditësojnë të dhënat e tyre dy herë në vit dhe 73,3% e bashkive i përditësojnë të dhënat e tyre me raste, pra vetëm kur ka aplikime dhe kur zgjidhen përfituesit (Figura 31). Megjithatë, duhet të theksohet se sistemet e informacionit nuk janë njëlloj të konsoliduara për sa i përket afatit kohor. Në disa bashki, ka vetëm dy vite që informacioni hidhet në bazën e të dhënave, edhe nëse kanë ekzistuar dosje të posaçme për projektin në zyrat e arkivit dhe protokollit.


Figura 31. Shpeshtësia e përdorimit të sistemeve të informacionit në nivel vendor



Burimi: Anketa e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Informacioni territorial për përfituesit ose grupet në nevojë për strehim social është i kufizuar. 20-23 bashki konfirmojnë se kanë bërë hartëzim të komuniteteve të disavantazhuara, si romët, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara (figura 32). Këto bashki kanë marrë zakonisht mbështetje nga programe të financuara nga donatorë, me synim fuqizimin e shërbimeve sociale në nivel vendor. Për rrjedhojë, hartëzimi është mjaft specifik dhe i lidhur me projektet, më shumë sesa një aktivitet rutinë. Numri i bashkive që monitorojnë ndikimin e programeve të strehimit social te komunitetet e disavantazhuara është më i lartë (30), por nuk është e qartë nëse ato kryejnë procese monitorimi të rregullta dhe të mirëstrukturuara mbi bazën e një metodologjie, apo thjesht mbajnë shënim aplikantët dhe përfituesit përfundimtarë.

Figura 32. Hartëzimi i komuniteteve të disavantazhuara në nivel vendor dhe monitorimi i ndikimeve të programeve të strehimit



Burimi: Anketat e strehimit social me njësitë e qeverisjes vendore, tetor 2020

Zbatimi i SSS-së (planit të veprimit) ka pasur ndikim të kufizuar te strukturat e qeverisjes për strehimin social në nivel vendor. Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve kanë qenë të dobishme për bashkitë për të kuptuar më mirë programet e strehimit social, por aspektet e tjera të qeverisjes janë më shumë rezultat i disa faktorëve të tjerë (decentralizimi, të ardhurat vetjake, burimet njerëzore, procedurat e brendshme etj.) sesa i strategjisë. Për shembull, vlerësimi i nevojave për trajnim mbi përdorimin e sistemit elektronik është kryer pa u pasuar nga një vlerësim dhe pilotim në vendin e punës, pasi sistemi elektronik i informacionit dhe aplikimit nuk është vënë ende në zbatim. Ky i fundit përfshin një bazë të dhënash mbi nevojat për strehim social në nivel vendor (që do të krijohet në bashkëpunim me INSTAT-in) dhe një sistem elektronik për aplikime online nga qytetarët. Aplikimet do të menaxhohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe do të monitorohen nga ministria, duke garantuar integrimin hierarkik të mekanizmave të qeverisjes. Megjithatë, duke qenë se sistemi nuk është ngritur ende dhe bashkitë bëjnë përpjekje të vogla apo mesatare për krijimin e bazave vendore të të dhënave, proceset e menaxhimit të kryera në nivel vendor mbeten disi të shkëputura nga veprimet e strategjisë.

Një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes është komunikimi ndërmjet Drejtorisë së Strehimit dhe njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera. Drejtorja e Strehimit komunikon rregullisht me bashkitë

lidhur me nevojat e tyre, duke i përfshirë ato në hartimin e akteve nënligjore të strehimit social dhe duke i ndihmuar ato të menaxhojnë proceset e tyre të aplikimit, sipas rastit. Së fundmi, një akt nënligjor për krijimin dhe/ose përmirësimin e rezervave publike të strehimit social (873/2020) e mbështet më tej fuqizimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet ministrisë dhe njësive të qeverisjes vendore. Për më tepër, Drejtoria e Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale. Bashkëpunimi realizohet veçanërisht në sajë të akteve nënligjore të përbashkëta për programet sociale. Megjithatë, nëse i referohemi planit të veprimit të SSS-së, nuk është përgatitur ende një raport vlerësimi për "Përshkrimin dhe vlerësimin e roleve koordinuese të MMSR-së, OShC-ve dhe NjQV-ve" (aktiviteti 3.1.1, f.79). Nga ana tjetër, "Hartimi i materialeve informuese rreth mundësive të përfitimit dhe aplikimit, dhe bashkëpunimi me NjQV-ve dhe qeverinë qendrore për shpërndarjen e tyre, me fokus të posaçëm të përfshirja e grupeve të disavantazhuara, të verbërve, personave që nuk dëgjojnë, komunitetit rom etj." (aktiviteti 3.2.1, f.79) është realizuar pjesërisht. Megjithatë, informacioni mbi këtë aktivitet është i kufizuar, pasi këto fushata ndërmerren në mënyrë të pavarur nga bashkitë.

## 5. Konkluzione të vlerësimit të zbatimit të Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025 për periudhën afatmesme<sup>23</sup>

### 5.1 Arritjet, sfidat dhe problematikat

#### 5.1.1 Konteksti

Kushtet e strehimit në Shqipëri, dhe sidomos strehimi social, janë ndikuar në vitet e fundit nga disa faktorë madhorë të jashtëm: **tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19**, nga njëra anë, dhe **ndryshimet e rëndësishme institucionale** që u ravijëzuan në nivel kombëtar në 2017, pas zgjedhjeve qendrore. Këto ndryshime institucionale shkaktuan vonesë në zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë, ndërkohë që dy fatkeqësitë e sipërpërmendura rritën kërkesën për strehim social, dhe presionin mbi bashkitë dhe qeverinë për të administruar këtë çështje. Nga pikëpamja financiare, si qeveria vendore, ashtu edhe ajo qendrore qëndruan aktive në përgjigjen ndaj kërkesës për strehim social, sipas planifikimeve të bëra. Në fakt, buxheti i parashikuar për strehim social para fatkeqësive natyrore nuk u cënuar, por vazhdoi të adresojë kërkesën e deriatëhershme për strehim. Ndërkaq, nevoja për kërkesa të reja për strehim (si pasojë e tërmetit) u adresua me fonde të dedikuara nga Qeveria e Shqipërisë. Sa i takon situatën e pandemisë, mbështetja financiare e qeverisë u përqëndrua në tre paketa ndihme për bizneset, si dhe në sigurimin e bazës ushqimore dhe mjekësore për familjet në nevojë. Këto aksione nuk u shoqëruan me sigurim strehimi. Aktualisht, për shkak të mungesës së të dhënave, është e pamundur të identifikohet se ç'pjesë e familjeve të ndikuara nga tërmeti apo COVID-19 i përkasin kategorive në pozita të pafavorizuara (sipas ligjit të strehimit), apo të pastreha, të cilat mund të përfitojnë nga strehimi social.

Tërmeti i 26 Nëntorit 2019 ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi sektorin e strehimit dhe infrastrukturës. Raporti i vlerësimit i përgatitur nga Qeveria Shqiptare në 2020, me mbështetjen e PNUD,

<sup>23</sup> Këto konkluzione janë shkruar në kuadër të raportit të vlerësimit të Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025 për periudhën afatmesme të zbatimit (2016-2020).

Bankës Botërore dhe Bashkimit Europian, formoi bazën për hartimin e një programi të rindërtimit pas tërmetit, të shoqëruar me fondin përkatës, si dhe nxiti mobilizim të mbështetjes financiare nga donatorët. Si raporti i vlerësimit, ashtu dhe vetë programi i rindërtimit adresojnë dëmet dhe humbjet e shkaktuara në shtatë sektorë, duke përfshirë dhe atë të strehimit, si dhe parashikojnë mekanizma financimi për rimëkëmbjen socio-ekonomike. Gjithsesi, nuk ka ende një vlerësim të pasojave të tërmetit mbi strehimin social (si sektor, dhe si grup përfituesish), apo mbi kategoritë më të disavantazuara (si përfituese të strehimit social). Në këto kushte është e vështirë të bëhet një vlerësim për mënyrën se si është ndikuar sektori i strehimit social. Gjithsesi, është e qartë që eventet e tërmetit ka kontribuar në rritjen e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje për të siguruar strehim, nëpërmjet skemave të ndryshme sociale. Si rezultat i kësaj, për vitin 2020 Qeveria Shqiptare caktoi një buxhet prej 2,9 miliard Lekë për subvencionimin e qerasë në treg për mbi 14,000 familje të prekura nga tërmeti.

Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 është hartuar pa marrë në konsideratë çështje madhore natyrore/biologjike që mund të ndikojnë mbi strehimin. Për këtë arsye, institucionet që sigurojnë apo mbështesin aksesin në programet e strehimit social nuk u gjenden të përgatitura nga pikëpamja strategjike për adresimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 2019-ës dhe COVID-19. Të dy eventet u menaxhuan nëpërmjet ndërhyrjeve të emergjencave kombëtare nga pikëpamja e hartimit të politikave, kuadrit ligjor, si dhe zbatimit të tyre. Për shkak të natyrës së emergjencës, tërmeti kishte një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm mbi strehimin, duke kontribuar në një rritje të kërkesës për siguri të strehimit social. Ndërkaq, COVID-19 ndikoi, ndër të tjera, mbi ndërveprimin social mes familjeve, për shkak të masave izoluese që u zbatuan, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit 2020. Gjithashtu situata pandemike theksoi nevojën për kushte më të mira të strehimit dhe hapësirës publike, në këndvështrim të higjienës, distancimit dhe kërkesave për shëndet psikologjik. Gjithsesi, përgjatë të dy emergjencave, nuk ishte e mundur të caktohej një marrëdhënie e qartë shkak-pasojë mes tyre dhe programeve dhe përfituesve të strehimit social, për shkak të mungesës së të dhënave.

Mbledhja e informacionit mbi numrin e aplikuesve dhe përfituesve të strehimit social që janë ndikuar nga tërmeti dhe/ose COVID-19 në nivel vendor, duke përfshirë dhe aspekte të tjera të tyre, si cënueshmëria, kushtet socio-ekonomike, etj, kërkon një angazhim shumë madhor në mjete, kohë dhe burime financiare. Ky angazhim mund të ketë qenë jo-realist të ndërmerrej gjatë 2020-ës, por në të ardhmen e afërt ky informacion do bëhet akoma edhe më i rëndësishëm, për financimin e strehimit social dhe për proceset që bashkitë duhet të ndërmarrin në kuadër të reduktimit të riskut ndaj fatkeqësive. Sugjerohet që informacionet e mësipërme të mblidhen paralelisht me procesin që po zhvillohet aktualisht nga Drejtoria e Strehimit për vendosjen në funksion të sistemit *online* të aplikimeve për strehim social, dhe për ngritjen e një baze të dhënash të integruar për strehimin social (përfshirë edhe Sistemin Gjeografik të Informacionit – GIS). Në planin e hartuar për përgjigje dhe rimëkëmbje socio-ekonomike prej COVID-19, UN Albania parashikon mbështetje për Qeverinë Shqiptare në analizimin e sfidave dhe problematikave të sigurimit të shërbimeve publike në nivel vendor (duke përfshirë këtu dhe strehimin) si pasojë e COVID-19, dhe ndryshimin në mënyrën e sjelljes së popullsisë së ndikuar nga COVID-19, me fokus në grupet e disavantazuara (UN Albania, 2020, f.72). Këto vlerësime duhen koordinuar me ministritë përkatëse. Kjo mbështetje mund t'i shërbejë Qeverisë dhe të përdoret nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për hartimin e bazës së integruar të të dhënave. **Interesi i MFE mbi bazën e të dhënave duhet të formulohet në mënyrë të qartë në rishikimin e Strategjisë së Strehimit Social.**

### 5.1.2 Rezultatet e Strategjisë

**Parimet e Strategjisë janë zbatuar dhe fokusi strategjik mbi strehimin e përballeshëm dhe të përshtatshëm, veçanërisht për komunitetet në pozita të pafavorizuara, vazhdon të mbështetet nga grupet e interesit. Objektivat Strategjike konsiderohen ende të vlefshme dhe të përshtatshme nga pjesa më e madhe e bashkive, në nivel mbi mesataren, dhe nga grupet e interesit. Objektivat mbeten të vlefshme, pavarësisht kontekstit në ndryshim të shpejtë. Për këtë të fundit, mund të nevojitet një përshtatje bazuar në nivelin e zbatimit të aktiviteteve të tyre deri tani. Për shembull, Objektivi Nr. 2, i cili adreson hartimin e një kornize ligjore të përshtatshme, është përmbushur pothuajse plotësisht, dhe ka mbetur në proces vetëm miratimi dhe zbardhja e disa akteve nënligjore të fundit. Ky objektivi, megjithëse mbetet i rëndësishëm, do rishikohet për të reflektuar nivelin e tij të realizimit dhe nevojës për përmirësim të vazhdueshëm. Në mënyrë të ngjashme, edhe Objektivi Nr.5, i cili adreson zgjerimin e programeve të strehimit social dhe zbatimin e tyre, duhet të jetë subjekt rishikimi për të reflektuar ndryshimet që ka sjellë ligji i ri për strehimin social për programet e reja që nga viti 2018.**

Gjithsesi, **“rëndësia” (ose vlefshmëria) është vlerësuar më lartë se “përshtatshmëria” (për objektivat), duke dëshmuar se Strategjia duhet të garantojë që transmeton fuqishëm mesazhin se reflekton diversitetin dhe specificitetin e kontekstit vendor.** Kjo mund të nënkuptojë rishikim të gjuhës së përdorur në Strategji, por kryesisht rishikim të planit të veprimit, me fokus në ngritje kapacitetesh vendore, në mënyrë të dedikuar dhe sipas nevojave. Vlerësimi më i ulët i “Përshtatshmërisë” së parimeve dhe objektivave të Strategjisë (si vlerësim perceptiv i bashkive dhe disa prej grupeve të interesit), përkundrejt “rëndësisë”, është i justifikueshëm sepse Strategjia ende po përballet me sfidën e zbatimit të këtyre objektivave, pavarësisht plotësisht të suksesshëm të kuadrit ligjor. Kjo vjen për disa arsye: i) mungesë ose pamjaftueshmëri kapacitetesh vendore dhe kuptueshmëri e ulët e Strategjisë dhe programeve të ndryshme të strehimit social në nivel vendor; ii) mungesë të dhënash dhe burimesh (si njerëzore, ashtu edhe financiare) në nivel kombëtar dhe vendor; dhe iii) planet e shmangies së riskut, që në nivel kombëtar e vendor janë të cinguar/mungojnë dhe nuk marrin në konsideratë gjithë fatkeqësitë dhe rreziqet.

Këto sfida në zbatim lidhen drejtpërdrejt me **politikat dhe mekanizmat qeverisëse** që zbatohen nga bashkitë për strehimin social. Aktualisht po vërehet një lëvizje pozitive në drejtim të zgjerimit të programeve të strehimit të planifikuara, dhe rritjes së përpjekjeve bashkiake në zbatimin e tyre. Gjithsesi, **dobësitë janë ende të thella, për shkak të kapaciteteve të ulëta financiare dhe njerëzore.** Numri i punonjësve bashkiakë që janë të dedikuar si staf për strehim social është shumë i ulët, dhe përgjithësisht këta persona mbajnë edhe përgjegjësi të tjera. Rritja e numrit të stafit vendor shkon përtej synimeve të kësaj Strategjie, por duke qene faktor kryesor pengues për zbatimin e saj në nivel vendor, ky propozim mund të jetë pjesë e planit të veprimit, në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera. Në mënyrë të ngjashme, Strategjia duhet të theksojë nevojën e bashkive për të eksploruar mekanizma të reja për rritjen e të ardhurave të veta, duke stimuluar Objektivin mbi zbatimin e PPP-ve. Kur flitet për financim, bashkitë nuk duhet të gjenden në pozitë pritëse ndaj Qeverisë Qëndrore. Instrumentet e partneritetit publik-privat, edhe pse aktualisht nuk preferohen/aplikohen nga bashkitë, duhet të shndërrohen në burime të rëndësishme të ardhurash për to.

Një ndër problematikat kryesore në politikat e strehimit social dhe në zbatimin e Strategjisë është

mungesa e të dhënave në nivel vendor. **Këto të dhëna aktualisht nuk janë të unifikuara (në kohë apo format), janë të shpërndara dhe nuk mbahen gjithmonë në formë elektronike, pa lënë vend për diskutim mbi bazën e integruar të të dhënave.** Regjistri elektronik (i propozuar në Strategji) do t'a ndihmojë shumë këtë aspekt, por nuk e zgjidh problemin, nëse furnizohet me të dhëna vetëm nga aplikantët në momentin e aplikimit. Bashkitë duhet të vendosin në sistem edhe informacione të tjera mbi strehimin social, duke pasuruar bazën e të dhënave. Përgjegjësia kryesore në ngritjen e këtyre sistemeve të menaxhimit të të dhënave mbetet e bashkive. Gjithsesi, Strategjia mund të theksojë nevojën për sistem të integruar, duke përfshirë aktivitete për promovimin dhe mbështetjen për ngritje kapacitetesh në këtë drejtim.

Një tjetër problematikë që vërehet, është se ka **një keqkuptim dhe mungesë njohurie mbi programet e strehimit social nga ana e komunitetit.** Bashkitë publikojnë periodikisht kriteret e përzgjedhjes së përfituesve dhe thirrjet për aplikime, por komunitetet kanë njohuri të cunguar mbi çfarë publikohet dhe kush mund të përfitojë. Ky fakt konfirmohet nga disa bashki, por dhe nga grupe të tjera interesi, veçanërisht përfaqësuesit e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Kjo do të thotë që bashkitë duhet të përmirësojnë ndjeshëm komunikimin dhe informimin ndaj proceseve të përfitimit të strehimit social. Strategjia mund të theksojë nevojën për aktivitete komunikimi dhe shkëmbimi njohurish si pjesë e objektivave dhe planit të aktiviteteve, të paktën në nivel kombëtar. Gjithsesi, mbetet përgjegjësi e bashkive t'i zbatojnë këto aktivitete në nivel vendor. Mbi të gjitha, kërkohet që informacioni të jepet në mënyrë të dedikuar, duke adresuar nevojat e komuniteteve specifike.

Pavarësisht se **aksesi i grupeve në nevojë** në programet e strehimit **është përmirësuar**, bashkitë ende nuk janë në gjendje të ofrojnë zgjidhje për strehim të përballueshëm për grupet me të ardhura të ulëta deri në të mesme, dhe të mesme. Një problematikë kryesore në këtë drejtim, e evidentuar nga bashkitë dhe disa nga grupet e interesit, është regjistrimi i **pronarit social**. Ky proces është i rëndësishëm për zbatimin e Strategjisë, si dhe për përgatitjen dhe zbatimin e planeve vendore të strehimit (programet 5-vjeçare të strehimit, siç parashikohen në ligj). Mungesa e gatishmërisë së pronarëve për t'u regjistruar si pronar social vjen edhe si pasojë e informalitetit në sektorin e qerasë sociale, dhe deklarimit të taksave. Për më tepër, PPP-të në sektorin e strehimit nuk po ofrojnë ndonjë alternative të qenësishme për rritjen e ofertës së strehimit social. Bashkitë ende nuk kanë gjetur mënyra si të terheqin kompanitë private në procesin e sigurimit të strehimit social, edhe pse nuk përjashtohet mundësia që vetë bashkitë të mos kuptojnë si të përfitojnë nga PPP-të për sigurim strehimi social. Nga ana tjetër, disa nga aktorët e sektorit të zhvillimit urban sugjerojnë që të ndërmerren disa masa, si psh. reduktimi/heqja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për mbështetjen e procesit të zbatimit të PPP-ve, veçanërisht në rastin e aplikimit të instrumentit të strehimit përfshirës (3% e sipërfaqes funksionale të ndërtimit sipas Ligjit).

Një nga çështjet më problematike të ngritura nga grupet e interesit është **përfaqësia e shoqërisë civile, dhe veçanërisht komuniteteve në pozita të pafavorizuara, në Këshillin Konsultativ për Strehimin Social.** Aktualisht, sipas përfaqësuesve të Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve të Shqipërisë, përfaqësimi në Këshillin Konsultativ bëhet **me rotacion**. Gjithsesi, duke pasur parasysh nevojat specifike të tipologjive të ndryshme të aftësive të kufizuara, kjo përfaqësi nuk është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbrojtur interesat e të gjitha komuniteteve PAK. Për më tepër, këto organizata raportojnë se bashkëpunimi i tyre me bashkitë nuk


është i kënaqshëm dhe zbatimi i legjislacionit ndesh në hendeqe. Si pasojë, është e domosdoshme të kryhet një komunikim dhe bashkëpunim më i afërt mes tyre dhe Drejtorisë së Strehimit pranë MFE, për të adresuar këto probleme. Përveç këtij komunikimi, këto grupe interesi kanë shprehur edhe nevojë për përfaqësi të rritur në Këshillin Konsultativ, si dhe një përputhje më të mirë mes çështjeve në diskutim në Këshill dhe grupeve të interesit të përfshira në këto procese.

Së fundi, rezultatet e Strategjisë u vlerësuan në lidhje me arritjen e objektivave bazuar në treguesit e monitorimit. Tabela e mëposhtme përfshin 39 tregues, bazën e tyre të vlerësimit, vlerën e planifikuar të treguesve për 2020 dhe 2025, dhe vlerat e raportuara për vitin 2020 dhe ato vjetore për periudhën 2017-2020. Këto vlera bazohen në raportimet e bashkive në sondazhin e kryer, ku vetëm 37 nga 61 u përgjigjën. Për këtë arsye, vlerat nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar, por janë mjftueshëm treguese. Ndërkohë, për pak nga treguesit vlera vjen nga raportimet në nivel kombëtar, (p.sh. Ministria) dhe në këtë rast duhet të referohemi në kapitujt raportit të vlerësimit të Strategjisë për periudhën afatmesme (2016-2020). Në disa raste të tjera, formulimi i treguesit ka qënë i paqartë sa i takon identifikimit të grupit të referimit. Përgjithësisht, rastet janë komentuar në tabelën e treguesve, në kolonën 'komente të ekspertëve'.

Panorama e përgjithshme nga tabela e treguesve tregon se 21 nga 39 tregues janë realizuar dhe kanë tejkaluar vlerën e tyre të parashikuar. 10 nga 39 tregues kanë vlerë pozitive, por janë më poshtë se vlera e parashikuar. 8 nga 39 tregues konsiderohen 'të pamundur për t'u matur', për shkak të të paktën një prej arsyeve në vijim: i) mungesë të dhënash nga vëzhgimi me bashkitë, për të përlogaritur si duhet vlerën; ii) të dhëna mund të gjenden, po nuk krahasohen dot me treguesit e formuluar në Strategji, apo me vlerën e parashikuar; iii) formulimi i treguesit është i paqartë dhe nuk ka reference në bazë të së cilës të matet. Mesatarisht 39% e aplikantëve (për të gjitha programet sëbashku) kanë përfituar nga strehimi social. 11 nga 25 kategori aplikuesish qëndrojnë mbi vlerën mesatare, dhe vetëm 6 kategori aplikantësh qëndrojnë në kuotën 'mbi 50%' të përfitimit (përfitues/aplikues): pra më shumë se gjysma e aplikantëve në këto kategori përfitojnë nga programet (shiko figurën e mëposhtme).

Figura 2. Raporti mes përfituesve dhe aplikantëve për strehim social, sipas kategorive të përcaktuara në Strategji (2020)





Burimi: Vëzhgim për Strehimin Social me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Tetor 2020

## Monitorimi dhe vlerësimi i treguesve të Strategjisë së Strehimit Social për periudhën 2016-2020

ID	Treguesit	Baseline	Treguesi (Vjetor)		Komente të ekspertëve	Vlera e treguesit në vit				Total
		2013-2015	2020	2025		2017	2018	2019	2020	Kumulative 2020
1	Përqindja e familjeve rome dhe egjiptiane në nevojë që kanë përfituar nga programet e strehimit social	10%	40%	80%		29%	47%	49%	48%	43%
2	Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar nga programi i përmirësimit të infrastrukturës	282 (23%)	458 (38%)	480 (39%)		0%	0%	0%	0%	
3	Përqindja e njësisve vendore të cilat kanë ngritur një sistem për grumbullimin e të dhënave dhe kanë përdorur evidencën e grumbulluar për përmirësimin e programeve të strehimit	0%	40%	80%	Duhet survey me aplikues dhe përtues				69%	
4	Përqindja e aplikantëve që janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar nga specialistët e strehimit në njësitë vendore	Nuk ka informacion	50%	80%	Nuk është e përcaktuar çfarë nënkupton					
5	Përqindja e kërkesave të suksesshme për financim nga NJQV-të në vit.	90%	100%	100%	Duhet marrë info nga PBA e QQ (ministra)					
6	Përqindja e buxhetit qendror që caktohet për programet e strehimit social. (Sqarim: Nënkupton buxhetin e ministrisë)	19%	100%	100%	Llogaritur si nr I bashkive qe raportojne qe kane kryer shpenzime per strehimin social me fonde te veta ndaj nr total te bashkive raportuese, per cdo vit					
7	Përqindja e njësisve vendore të cilat kanë financuar programe strehimi me burimet e veta.	Më pak se 5%	30%	50%	Yes (6.1) Tabela 14, per vit	19%	22%	28%	36%	
8	Numri i familjeve të dëbuara me forcë nga banesat.	129	0	0	Yes (6.1) Tabela 2	0	19	0	1	20

9	Përqindja e aplikantëve në nevojë që kanë patur akses në më shumë se një program social (për shembull përqindja e aplikantëve të papunë që kanë përfituar bonus strehimi si dhe janë punësuar).	Nuk ka informacion	20%	50%	Duhet marre në minsitri	231	207	253	453	1,144
10	Numri i trojeve të kaluara NJQV-ve për ofrimin e strehimit social në një vit.	Nuk ka informacion	Në varësi të trojeve shtetërore të lira për strehim	Në varësi të trojeve shtetërore të lira për strehim	Yes (6.1) Tabela 4					
11	Numri i familjeve që kanë përfituar nga programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë.	0	Në varësi të trojeve të vëna në dispozicion	Në varësi të trojeve të vëna në dispozicion	Yes (6.1) Tabela 5	0	0	8	0	8
12	Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i marrëveshjeve të partneritetit – publik - privat.	0	500	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	Yes (6.1) Tabela 7	1	50	14	24	89
13	Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i marrëveshjeve të partneritetit – publik - privat - komunitet.	0	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	Në varësi të marrëveshjeve që do të hartohen	Yes (6.1) Tabela 8	3	5	4	3	97
14	Numri i familjeve të strehuara në ndërtesat e pashfrytëzuara (të përshtatura për qëllime strehimi).	0	Në varësi të kërkesave nga bashkitë	Në varësi të kërkesave nga bashkitë	Yes (6.1) Tabela 6	123	147	112	136	518
15	Numri i projekteve të miratuara për përmirësimin e vendbanimeve romë dhe egjiptiane të konceptuara me pjesëmarrje të komuniteteve dhe të miratuara nga NJQV-të.	13	50	100	Kam vendosur nr total perfituesish. Mendoj qe nuk është përcaktuar mirë kategoria kujt i referohet.	72	74	41	18	205
16	Numri i familjeve që kanë përfituar si rezultat i skemave të miratuara të strehimit me pjesëmarrje për grupet në pozita të pafavorizuara.	282	400	700	Nuk e llogarisim dot.	1,582	2,002	1,553	2,057	7,194
17	Përqindja e grupeve në pozita të pafavorizuara që kanë përfituar nga cilido prej instrumenteve financiare në muaj.	0	20%	60%	Duhet marre nga Ministria					
18	Sasia e fondeve të siguruar nga donatorët ndërkombëtarë.	0	79,620,000	6,700,000	Yes (6.1) Tabela 10/11	Aktivitetet <i>soft</i> u financuan me mbështetje nga donatorë				

19	Raporti i përfituesve (numri i përfituesve/aplikantëve) nga programi i financimit të projekteve të efikasitetit të energjisë në banesa.	57	163	170	Yes (6.1) Tabela 12	20	2	4	6	32
20	Numri i përfituesve të kredive të lehtësuara që u është disbursuar kredia	3,894	5,000	7,000	Eshte konsideruar kategoria 1 e P1	413	549	30	349	1,341
21	Përqindja e grupeve në pozita të pafavorizuara që kanë përfituar nga subvencionimi i qirasë për objektet në pronësi të bashkisë.	S'ka informacion	Informacioni do të ofrohet nga NJQV-të	Informacioni do të ofrohet nga NJQV-të	Eshte konsideruar kategoria 2 e P1	27%	70%	46%	74%	47%
22	Raporti i përfituesve të bonusit të qirasë (numri i përfituesve/ aplikantëve) për banesat në treg të lirë të kontraktuara nga njësitë.	S'ka informacion	Informacioni do të ofrohet nga NJQV-të	Informacioni do të ofrohet nga NJQV-të	Ka probleme në saktësi pasi bashkitë nuk raportojnë mirë mbi nr e aplikuesve dhe të përfituesve.	219%	206%	139%	28%	73%
23	Përqindja e familjeve me kryefamiljare femër përfituese	18.7%	25%	50%	Duhet survey me aplikues dhe përtues	30%	33%	80%	50%	49%
24	Përqindja e familjeve me një prind të vetëm përfituese	31.70%	50%	60%		26%	18%	85%	53%	32%
25	Përqindja e familje të mëdha përfituese	25.50%	30%	35%		21%	27%	46%	75%	63%
26	Përqindja e të moshuarve përfitues	25.40%	35%	50%		21%	25%	37%	55%	33%
27	Përqindja e persona me aftësi të kufizuara përfitues	13.50%	25%	40%		26%	23%	51%	42%	38%
28	Përqindja e çifteve në moshë të re përfitues	40.20%	45%	50%		13%	26%	22%	46%	22%
29	Përqindja e familje që kanë ndryshuar vendqëndrim përfituese	28.60%	35%	40%		36%	37%	13%	98%	64%
30	Përqindja e jetimëve përfitues	4.70%	30%	50%		17%	15%	0%	69%	33%
31	Përqindja e emigrantëve të rikthyer përfitues	27.90%	30%	30%		10%	11%	8%	19%	13%
32	Përqindja e punëtorëve migrues përfitues	30.80%	35%	35%		20%	0%	50%	85%	54%
33	Përqindja e azilkërkuarve përfitues	0%	5%	5%		0%	33%	0%	100%	25%
34	Përqindja e familjeve të oficerëve të rënë në krye të detyrës përfitues	0%	10%	25%		25%	0%	100%	100%	50%
35	Përqindja e viktimave të dhunës në familje përfituese	0%	20%	40%		21%	17%	113%	68%	40%
36	Përqindja e familjeve romë përfituese	37.20%	50%	70%		29%	46%	69%	53%	46%
37	Përqindja e familjeve egjiptiane përfituese	11.20%	30%	50%		28%	47%	42%	46%	42%

38	Përqindja e përfituesve të cilët marrin ndihmës ekonomike	22.80%	40%	60%		22%	20%	57%	32%	33%
39	Grupe të tjera përfituese	35.90%	40%	50%		34%	52%	108%	54%	46%

Burimi: Strategjia e Strehimit Social dhe të dhëna nga Sondazhi me bashkitë (2020) mbi monitorimin e Strategjisë

### 5.1.3 Çështjet ligjore, institucionale, organizative, dhe të politikave

**Rishikimi i Strategjisë së Strehimit Social po ndodh në kohën e duhur dhe ka qenë i parashikuar edhe ligjërisht.** Gjithsesi, monitorimi vjetor i zbatimit të saj nuk ka ndodhur deri tani, e procesi duhet të nisë tashmë. Edhe nëse ky monitorim vjetor dhe raportet e vlerësimit nuk përmbajnë të gjithë informacionin e plotë, si pasojë e vështirësive në përcaktimin dhe popullimin e bazës së të dhënave, procesi duhet të ndodhë, në mënyrë që të krijohet një traditë dhe kulturë pune. Kjo nevojitet për konsolidimin e Strategjisë si instrument, por edhe për të çuar qeverisjen për strehim social në një nivel të ri, qoftë kombëtar, ashtu edhe vendor.

Legjislacioni është plotësuar. Ka mbetur ende shumë pak punë për përshtatjen e akteve nënligjore të fundit. Parimisht, është ende herët për të diskutuar mbi përmirësime të legjislacionit, duke qenë se ende nuk ka ndodhur zbatimi i tij në tërësi. Vetëm kur legjislacioni zbatohet i plotë, mund të kuptohen plotësisht boshllëqet ose pengesat ligjore. Megjithatë, bazuar në takimet me grupet e interesit, duket se mund të ketë çështje për trajtim që në këtë fazë.

Disa prej çështjeve janë formuluar qartë, bazuar në argumente, ndërsa të tjerat mund të vijnë për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm ose keqinterpretimit. Sido që të jetë rasti, duke qenë se këto çështje (siç parashtrihen edhe në raportin e vlerësimit të Strategjisë) vijnë nga grupet e interesit, kjo do të thotë që bashkëpunimi midis Drejtorisë së Strehimit dhe palëve të interesit vlen të përforcohet më tepër në vijim. Si pasojë, mund të kryhen edhe ndërhyrje përmirësuese të kornizës ligjore të deritanishme. Kështu, Objektivi nr.2 mund të rishikohet për të përfshirë përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit, bazuar në bashkëpunim të plotë me palët e interesit dhe bashkitë. Sa i përket bashkëpunimit midis MFE dhe ministrive të tjera, ai duhet të vazhdojë dhe të bëhet më i fortë, duke u shndërruar në mjet për të rritur mirëqenien dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe statusin shoqëror për komunitetet në nevojë. Përveç legjislacionit, i cili tashmë është në fuqi, ky bashkëpunim mund të materializohet përmes një aksesit të përbashkët në një sistem të integruar të të dhënave të strehimit social dhe ndarjes së informacionit, dhe përmes përpjekjeve të Drejtorisë së Strehimit për të nxitur në mënyrë më proaktive zbatimin e legjislacionit sektorial në lidhje me strehimin social (për shembull sektorët e eficiencës energjitike, planifikimit të territorit dhe zhvillimeve informale).

### 5.1.4 Burimet

Nga pikëpamja financiare, **alokimi i burimeve ka ndodhur paralelisht me zbatimin e planit të aktiviteteve.** Aktivitetet e karakterit *soft* (pra jo investime) janë mbështetur nga donatorët, veçanërisht nga PNUD përmes programit 'Askush të mos mbetet pas'. Fondet nga buxheti i shtetit janë shpenzuar për zbatimin e programeve të strehimit, në një shumë totale (duke përfshirë investimet dhe subvencionet) që deri në periudhën afatmesme (2016-2020) mbulon 50% të kostove të parashikuara në strategji. Ky raport vlen edhe për secilën nga dy kategoritë, investimet dhe subvencionet. Kjo shumë e shpenzuar nuk përfshin burime shtesë të alokuara për familjet e prekura nga tërmeti. **Efikasiteti financiar në realizimin e programeve të strehimit është ruajtur, por nuk është rritur,** duke patur parasysh që fondi i planifikuar për PPP-të nuk është gjeneruar (aktiviteti 4.1.4) dhe që disa aktivitete të



Strategjisë (të tilla si baza e të dhënave dhe sistemi *online*) nuk janë finalizuar ende, pavarësisht se është kaluar koha e parashikuar për to në Strategji. Efikasiteti në këtë rast mund të jetë ndikuar nga ndryshimet institucionale, vonesat me legjislacionin dhe numri i pamjaftueshëm i stafit, si në nivelin kombëtar, ashtu dhe në atë vendor.

Së fundi, qëndrueshmëria e rezultateve të Strategjisë nuk mund të vlerësohet aktualisht. Koha e konsiderueshme që i është kushtuar përgatitjes së legjislacionit dhe procesit përkatës të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe zbatimi i programeve të strehimit sipas planit (përfshirë ndryshimet e paraqitura nga Ligji), janë tregues të një qasjeje dhe instrumenti potencialisht të qëndrueshëm. Sidoqoftë, për shkak të vonesës në zbatimin e Strategjisë, ndryshimeve në kornizën ligjore dhe institucionale që ndodhën gjatë dy viteve të fundit, dhe faktit që ndodhemi vetëm në fazën afatmesme të zbatimit, është shumë shpejt për të vlerësuar qëndrueshmërinë e Strategjisë.

## **5.2 Sinergjia me strategji, programe dhe instrumente të tjera**

Përveç Strategjisë së Strehimit Social dhe legjislacionit të strehimit social, Qeveria e Shqipërisë i ka adresuar disa aspekte të strehimit social edhe përmes miratimit të strategjive dhe platformave ndërkombëtare dhe në strategjitë ndër-sektoriale. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndodhur gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Analiza tregon se disa nga strategjitë e tjera kombëtare duhet të rishikojnë çështjen e strehimit social kur të kryejnë rivlerësimin e tyre afatmesëm/final. Nga ana tjetër, Strategjia e Strehimit Social mund të theksojë më tej lidhjen e strehimit social me sektorë të tjerë.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), veçanërisht objektivat 1 dhe 11, duhet të adresohen me kujdes në Strategjinë e rishikuar. Strategjia aktuale ofron një larmi të skemave të strehimit, e cila është në përputhje me Agjendën e Re Urbane dhe Kartën e Gjenevës të Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin e Qëndrueshëm. Sidoqoftë, Strategjia mund të bëjë një lidhje më të mirë me Agjendën e Re Urbane, veçanërisht në lidhje me rikonstrukcionin e ndërtesave për grupet në nevojë dhe sigurimin e strehimit social që përveçse është cilësor, i arritshëm dhe i përbalueshëm, ka dhe aftësi përshtatshmërie ndaj rreziqeve natyrore (*resilient*). Strategjia e rishikuar, në përputhje me Agjendën Urbane, duhet gjithashtu të theksojë rolin e Planeve të Përgjithshme Vendore të Territorit si mjete për të siguruar arritjen e objektivave të saj. Shumica e planeve vendore aktualisht nuk sugjerojnë zona ose vendbanime për programet e strehimit social, ndërkohë që në asnjë rast nuk aplikohen instrumente që mundësojnë strehim social të integruar në zhvillimet e reja me përdorim miks (të përzier). Për më tepër, Strategjia mund të ofrojë një vlerësim shumë të qartë mbi vendndodhjen e programeve / opsioneve të strehimit në territor përkundrejt shërbimeve që janë të nevojshme për grupe të ndryshme përfituesish.

Ndërkaq, Strategjia do të duhej të përshtaste gjithashtu parimin e mbrojtjes së mjedisit siç përcaktohet në Kartën e Gjenevës të Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin e Qëndrueshëm. Në terma operacionale, ky synim mund të arrihet në momentin që Strategjia e rishikuar krijon lidhje të qarta me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe përfshin aktivitete që përmirësojnë strehimin social përmes planifikimit vendor të territorit.

Ndërkohë që Strategjia Kombëtare për Zhvillimi dhe Integrim (SKZHI) ka hyrë në fazën e rishikimit, aktorët institucionalë të strehimit social mund të advokojnë për përfaqësimin e drejtpërdrejtë të sektorit në objektivat e SKZHI, ose për përfshirjen e qartë brenda prioriteteve të përfshirjes ekonomike dhe

sociale. Në mënyrë të ngjashme, strategjitë e zhvillimit dhe mbrojtjes sociale që po rishikohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të marrin në konsideratë sigurimin e strehimit për grupet e tyre të synuara, si pjesë të objektivave dhe veprimeve strategjike. Së fundi, por jo nga rendësia, objektivat e lidhura me eficiencën energjitike në ndërtesa duhet të shfaqen dhe përkufizohen qartë edhe për programet e strehimit social, si kontribut i rëndësishëm mjedisor dhe i lidhur me jetueshmërinë e kategorive përkatëse.

## **6. Rekomandime për rishikimin e mundshëm të Strategjisë së Strehimit social 2016-2025**

Rekomandimet mbi ndryshimet e mundshme të Strategjisë së Strehimit Social vijnë drejtpërdrejt nga konkluzionet e analizës së vlerësimit të zbatimit për periudhën afatmesme. Kapitull i rekomandimeve përmban një listë përmbledhëse të tyre, të formuluar specifikisht për ndërhyrjet në Strategji. Drejtoria e Strehimit do të vendosë në mënyrë finale për përfshirjen ose jo të këtyre rekomandimeve në Strategji, duke u bazuar gjithashtu edhe tek takimet me palët e interesuara.

**(1)** Përmbajtja e kapitullit 1 (Situata aktuale) të Strategjisë, kishte rëndësi në momenti kur strategjia u miratua, pasi përcaktoi bazën për kapitujt e mëtejshëm, të cilët parashtrajnë vizionin dhe masat e marra për të adresuar kontekstin. Nga viti 2016 konteksti ka evoluar, dhe edhe pse disa prej sfidave vazhdojnë të jenë ende reale (për shembull kapaciteti, larmia e programeve, zbatimi i legjislacionit), ato janë adresuar në nivele të ndryshme nëpërmjet zbatimit të Strategjisë deri në vitin 2020. Rishikimi që Strategjia mund të pësojë në këtë moment është një rishikim afatmesëm dhe jo një proces për hartimin e një Strategjie të re. Ndërkohë që Strategjia aktuale është në fuqi, qëllimi i rishikimit afatmesëm është të rivlerësojë dhe konfirmojë parimet, vizionin dhe objektivat e Strategjisë me palët e interesuara, dhe të rishqyrtojë masat e saj për t'u përshtatur sa më mirë me kontekstin dhe progresin e zbatimit. Në këto kushte, rekomandohet që teksti i Strategjisë për kapitullin e parë (Situata aktuale) mos të pësojë anjë modifikim. Ndryshimet rekomandohen të kryhen për pjesët e tjera të Strategjisë si në vijim:

- Sa i përket kapitullit të parë, ai mund të pasurohet me përfshirjen e një shtojce në Strategji që përmban pika të përmbledhura të situatës demografike dhe migracionit, të tregut të banesave në Shqipëri dhe të konkluzioneve të raportit afatmesëm të vlerësimit, si aspektet kontekstuale të cilat çojnë në rishikimin e Strategjisë;
- Në Strategji mund të përfshihet një shtojcë që përmban ndryshimet e mundshme të Vizionit dhe Objektivave (si më poshtë).
- Në Strategji mund të përfshihet një shtojcë me Planin e Veprimit të rishikuar dhe me Tabelën e Treguesve të rishikuar nga seksioni i Monitorimit. Plani i Veprimit do të përmbajë gjithashtu edhe kostot financiare për masat dhe objektivat;
- Në Strategji mund të përfshihet një shtojcë me rishikimet e planit të menaxhimit të risqeve që reflektojnë ndryshime në Objektiva apo në masa tek Plani i Veprimit.
- Të gjitha anekset e listuara më sipër mund të përdorin rekomandimet për modifikime të parashtruara në pikat e mëposhtme, 2 deri në 6.



Nëse të gjitha apo një pjesë e ndryshimeve të mësipërme dakordësohen nga grupet e interesit në takimet për rishikimin e Strategjisë që do të realizojë MFE, atëherë kapitulli i parë plus shtojcën e vetë dhe kapitujt e tjerë të rishikuar do të hidhen në pjesët përkatëse të sistemit SIPI/IPSIS. Ky shënim bëhet sepse Strategjia aktuale nuk ka të njëjtin format me atë të përcaktuar në sistemin SIPI/IPSIS, edhe pse përmban të gjitha pjesët përmbajtësore që kërkon SIPI/IPSIS. Strategjia aktuale është hartuar dhe miratuar përpara ndryshimeve ligjore për sistemin SIPI/IPSIS dhe përgjatë rishikimit përmbajtësor do të rishikohet edhe për riformatim të saj sipas kërkesave ligjore<sup>24</sup>.

**(2)** Vizioni dhe tre parimet strategjike qendrojnë të pandryshuara. Gjithsesi, MFE-ja mund të vendosë të rishqyrtojë disa nga pikat e mëposhtme, duke u bazuar tek rezultatet e vlerësimit dhe sfidat e kontekstit:

- Ndryshimi i vlerës së synuar (target) prej 60% të vendosur në vizion kundrejt një target më të arritshëm, sidomos pas tërmetit;
- Shtimi i një parimi mbi aftësinë ripërtëritëse ekologjike dhe përgatitjen ndaj riskut të katastrofave
- Rishikimi i parimit të tretë, parimi mbi bashkëpunimin dhe koordinimin me sektorë të tjerë, për të përfshirë gjithashtu planifikimin territorial, eficiencën energjitike dhe mbrojtjen civile. Një koordinim më i mirë midis strehimit social dhe këtyre tre sektorëve do të kontribuojë në vazhdimësinë e përmbushjes të tre parimeve ekzistuese të Strategjisë.

**(3)** Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë ka një synim prej 25,000 familjesh për të adresuar, duke përjashtuar ato që mund të përfitojnë në rast emergjence, të tilla si pas tërmetit. Numri i përgjithshëm i përfituesve për periudhën 2017-2020, bazuar në sondazhin (përgjigjur nga 37 bashki) është rreth 7,200 familje. Sipas MFE, 1,840 familje përfituan nga programi i subvencionimit të qirasë vetëm gjatë viteve 2019-2020. Për më tepër, një vlerësim i përafërt i përfituesve gjatë periudhës afatmesme (bazuar në të dhënat e MFE) tregon më shumë se 10,000 familje. Kështu, supozohet se të paktën gjysma e familjeve të synuara kanë marrë mbështetjen e nevojshme, në gjysmën e parë të periudhës së zbatimit të Strategjisë. Drejtoria e Strehimit mund të konsiderojë të rishikojë vlerën e synimit, duke vendosur një target më të arritshëm, në përputhje me financat, dhe ndoshta duke e rritur atë. Nga ana tjetër, vlera e synuar (*target*) mund të mbetet e pandryshuar, por është e rëndësishme për Strategjinë të amplifikojë përpjekjet që të gjitha institucionet duhet të bëjnë për përmbushjen apo edhe tejkalimin e tij.

**(4)** Të katërta prioritetet strategjike qendrojnë të pandryshuara dhe plotësisht të vlefshme. Formulimi i prioritetit strategjik nr. 2 (akses më i mirë në strehim social nëpërmjet rishikimit të legjislationit dhe kornizës institucionale) ka nevojë për disa rishikime që reflektojnë faktin që legjislationi është në fuqi dhe se përmirësimi i vazhdueshëm i legjislationit duhet të mbetet prioritet për Drejtorinë e Strehimit.

**(5)** Pesë objektivat e strategjisë kanë rëndësi/vlefshmëri të lartë, por një rishikim i lehtë për të përmirësuar përshtatshmërinë, siç përkufizohet në këtë raport, dhe për të reflektuar sfidat e kontekstit, sugjerohet i nevojshëm. Gjithashtu, në rast se parimet e Strategjisë do të modifikohen lehtësisht për të përfshirë aftësinë ripërtëritëse dhe dimensionet e reduktimit të riskut të fatkeqësive, ndryshimet duhet

---

<sup>24</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar SIPI/IPSIS.

të reflektohet edhe tek Objektivat, nënobjektivat, rezultatet e pritshme dhe masat e Strategjisë. Rishikime të mundshme në nivelin e objektivave janë si më poshtë:

- Objektivi i 2-të mund të rishikohet, nga "përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e qasjes në strehim të 50% të familjeve në pozita të pafavorizuara" në "përmirësimi i vazhduar dhe qartësimi mbi kuadrin ligjor e institucional për garantimin e aksesit në strehim të të gjitha grupeve përfituese që njeh ligji dhe veçanërisht për familjet në pozita të pafavorizuara. Propozohet heqja e target prej "50%", sepse legjislacioni është në fuqi dhe siguron hapësirë dhe mundësi për strehim social për më shumë se 50% të komuniteteve/kategorive vulnerabël dhe në nevojë. Prandaj, nga një këndvështrim ligjor, kategoritë e përcaktuara janë gjithëpërfshirëse dhe të gjithë përfitojnë një trajtim të barabartë. Për më tepër, nëse target nënkupton raportin midis përfituesve dhe aplikantëve, atëherë nuk është e mundur të caktohet një target i tillë, ose ndonjë vlerë tjetër e tij vetëm si ndikim i legjislacionit. Me legjislacionin në fuqi, numri i përfituesve vetëm mund të rritet nëse arrihen objektivat e tjerë të Strategjisë.
- Objektivi i 3-të mund të rishikohet për gjuhën, duke zëvendësuar terma si "koordinimi i përpjekjeve" me "koordinimi ndërmjet institucioneve" dhe "procesi i shpërndarjes/alokimit" me "mundësimi dhe pajisja me banesa sociale", në mënyrë që të bëhet një deklaratë e qartë, duke evituar subjektivizmin për një çështje (koordinim dhe bashkëpunim) që është thelbësore për mundësimin dhe shpërndarjen e strehimit social. Duhet përmendur që Objektivi i 3-të ka vlefshmërinë më të lartë në vlerësimin e Strategjisë dhe është objektivi i dytë përsa i përket përshtatshmërisë, siç është raportuar nga qeveritë lokale, por ka nevojë për përmirësime në nivel objektiv dhe nënobjektivash, për më shumë qartësime.
- Objektivi i 4 rishikohet duke hequr mundësisht target në formulimin e tij. Strategjia nuk i përmbushi shumicën e aktiviteteve të objektivit 4 dhe, si pasojë, është e vështirë të propozohet një target që mund t'i përshtatet më mirë objektivit. Një zhvillim pozitiv, i pa planifikuar në Strategji, është bashkëpunimi ndërmjet MFE dhe tre bankave tregtare, duke përfshirë gjithashtu Autoritetin Kombëtar të Strehimit, për programin e subvencionimit të kredisë, brenda programit të strehimit me kosto të ulët. Si rezultat, marrëveshjet u firmosën në vitin 2019, dhe 1000 përfitues u planifikuan të shtohen tek ata që mund të përfitonin nga subvencionet e kredisë në vitin 2020. Ky grup përfaqëson 13% të numrit total të përfituesve të vitit 2020, gjë që është premtuese në terma të vlerës së synimit (target). Por, meqenëse me shumë mundësi aktivitetet e objektivit 4 do të ndryshojnë (siç sugjerohet më poshtë), një rishikim ose heqje e target mund të jetë e nevojshme.
- Objektivi i 5-të ka nevojë për rishikim për të përfshirë në formulimin e tij të gjitha programet dhe grupet e përfituesve, të përcaktuara nga Ligji. Këto grupe përfshijnë komunitetet e pafavorizuara, dhe gjithashtu familjet me të ardhura të ulëta dhe familjet me të ardhura të ulëta në të mesme. Formulimi aktual i objektivit është gjithashtu i paqartë përsa i përket target. Pra, rritja me 30% i referohet programeve të strehimit (të përcaktuara si alternativa) apo numrit të përfituesve? Meqenëse Ligji është mjaft specifik përsa i përket programeve/instrumenteve, duke përfshirë edhe të reja, të aplikueshme në të gjitha kontkstatet, është më e arsyeshme që target t'i atribuohet numrit të përfituesve. Duhet gjithashtu të qartësohet që rritja me 30% nuk nënkupton përqindjen e përfituesve kundrejt aplikuesve, por rritjen në përqindje të përfituesve kundrejt

aplikuesve. Gjithsesi, meqenëse tabela e treguesve të Strategjisë përmban një larmi përqindjesh të tilla, do ishte më mirë heqja e target nga objektivi. Në fund të fundit, çdo objektivi ka treguesit e vetë në lidhje me rezultatet që arrin, të paraqitura në tabelën e monitorimit të treguesve të Strategjisë. Kjo nuk do të ulë ambicien e Drejtorisë së Strehimit dhe bashkive për të arritur një numër më të lartë përfituesish, meqenëse ata duhet të përmbushin gjithsesi treguesit e vendosur në tabelën e monitorimit.

**(6) Rishqyrtimi i objektivave do të çojë në rishikimin e aktiviteteve/masave dhe treguesve përkatës në planin e veprimit. Disa ndryshime kyç për t'u marrë në konsideratë janë si më poshtë:**

- Përfshirja e të gjitha programeve të strehimit të përcaktuara nga ligji, në Strategji, sidomos në aktivitetet e Objektivit të 5-të. Ligji ka krijuar bazën për përmirësimin e efikasitetit në mundësimin e opsioneve për strehim, nëpërmjet më shumë programeve dhe për më shumë grupe në nevojë. Prandaj kjo duhet të reflektohet edhe në Strategji. Nëpërmjet ndryshimeve ligjore, numri i përfituesve që mund të aksesojnë banesat sociale, në rastin e komunitetit Rom ka mundur të kapë edhe kuotën prej 5%. Ndoshta kuota të ngjashme mund të vendosen edhe për kategori të tjera të përfituesve, si PAK. Për më tej, mund të bëhen specifikime për të nënvizuar nevojën për zbatimin e standardeve të strehimit për të gjitha kategoritë, në bazë të nevojave, dhe për opsionet të mirëfillta të vendodhjes së banesave, në afërsi të shërbimeve dhe mundësisht në zona me përdorim të përzier.
- Rishikimi i masave të Objektivit 1, për të theksuar ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve. Faktikisht, aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve duhet të rriten në përgjithësi dhe duhet të ndërthuren me shumicën e objektivave. Këto mund të përfshinë trajnimin dhe asistencën në vendin e punës, të mundësuar nga Drejtoria e Strehimit, mundësisht me mbështetjen e programeve të donatorëve.
- Aktivitetet e Objektivit 3 duhet gjithashtu të rriten në numër dhe duhet të diversifikohen për të përfshirë institucione dhe sektorë të tjerë dhe jo vetëm ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen sociale. Këtu mund të përfshihet INSTAT, institucionet e planifikimit të territorit në nivel kombëtar, ministria dhe agjencitë përgjegjëse për energjinë, etj. Kjo do t'u sigurojë mundësinë Strategjisë dhe aktiviteteve të saj të përfshijë aftësinë ripërtëritëse dhe dimensionin e përgatitjes ndaj fatkeqsive, pasi të paktën një ndër aktivitetet e Objektivit 3 mund të konsistojë në bashkëpunimin me institucionet e mbrojtjes civile. Dimensioni i aftësisë ripërtëritëse mund të adresohet gjithashtu përmes një rishikimi të vlerësimit të riskut dhe planit të zbutjes së tij në Strategji.
- Së fundmi, ose në Objektivin 1 ose në Objektivin 3, Strategjia mund të parashikojë gjithashtu më shumë aktivitete bashkëpunimi midis Drejtorisë së Strehimit, përfituesve dhe palëve të interesit. Kjo do të nënkuptojë gjithashtu se potenciali për PPP mund të eksplorohe më tej dhe të përdoret më mirë. Në fund të fundit, përveç fizibilitetit financiar, PPP-të duhet të bazohen në besim. Ndërtimi i aleancave me zhvilluesit, mund të ofrojnë përfitime për MFE-në në rritjen e burimeve financiare për strehimin social. Si fillim, përmes aktiviteteve të Objektivit 2, mund të parashikohet edhe përmirësimi ligjor në lidhje me rolin e zhvilluesve në strehimin

gjithëpërfshirës, duke lehtësuar ngarkesat e panevojshme të taksimit dhe duke fuqizuar kuadrin rregullator për ta realizuar instrumentin e 3%-shit.

## Referenca

Bank of Albania, 2020. Rezultatet e Vrojtimit "Tregu i Real" dhe indeksi i Çmimeve të Strehimit, Banka e Shqipërisë, Tiranë.

Council of Ministers; European Union; United Nations Agency; The World Bank. (2020). *Albania Post Disaster Needs Assessment; Volume A*. Tirana.

Polis University; Co-PLAN; A.U.A. (2019). *Technical Note: Reconstructing the city following a natural disaster - Post Earthquake Urban Resilience*. Tirana: POLIS University; Co-PLAN, Institute for Habitat Development; A.U.A - Albanian Union of Architects and Urban Planners.

DCM 754, dated 30.11.2019, 'On the organization of temporary accommodation of the affected population because of the natural disaster in the Qarks of Durrës, Tiranë, Lezhë in accommodating structures'

DCM 5, dated 6.1.2020, 'On the definition of rules and procedures for the beneficiaries from the Reconstruction Grant Program and the Model Projects'

DCM 9, dated 10.1.2020 'On the designation of implementation units for drafting the Compulsory Local Plans and their financing through the Reconstruction Fund, approved in the 2020 Budget'

DCM 202, dated 5.3.2020 'On the use of the Reconstruction Fund, approved in the 2020 Budget, for the financing of the reconstruction of individual houses'

European Commission, 2020. Albania 2020 Report. SWD (2020) 354 final.

European Union, 2012. Charter of fundamental Rights of the European Union. Official Journal of the European Union.

Eurostat, 2020. First estimates of Purchasing Power Parities for 2019, Eurostat newsrelease 98/2020.

Government of Albania, 2016. Social Housing Strategy 2016-2025. Decision of Council of Ministers 405/2016.

Government of Albania, 2020. COVID-19 Plan-Vepimi për Shqipërinë. Parandalimi, Parapërgatitja dhe Përgjigja kundër COVID-19. [Online] available at: [https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Covid\\_AL-spreads.pdf](https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf). [Accessed 14 December 2020].

INSTAT, 2019. Të ardhurat dhe Cilësia e Jetës në Shqipëri 2017-2018. INSTAT: Tiranë

MacDonald, W. and Tempest, F., 2018. Final Report Midterm Review of UNEG Strategy. Infinity Consulting and Legal Services, Final Evaluation Report.

Milligan, V., Phibbs, P., Gurrin, N., and Fagan, K., 2007. Approaches to evaluation of affordable housing initiatives in Australia: National Research Venture 3: housing affordability for lower income Australians. Melbourne: Australian Housing and Urban Research Institute.

Numbeo (2020) Property Prices in Tirana, [online] available at: <https://www.numbeo.com/property-investment/in/Tirana> last accessed 14/12/2020

Rogers, P., Stevens, K., Briskman, L., and Berry, M., 2005. Framework for Evaluating Building a Better Future: Indigenous Housing to 2010. Australian Housing and Urban Research Institute.

Toto, R., Toska, M., Shutina, D., Farrici, A. and Limaj, A., 2020. The Response of Local Governments during Covid-19 in Albania: January 2020-April 2020. Resilience Series, 3. DOI: 10.32034/CP-PPRESI-P01-03.

UN Albania, 2020. UN Albania COVID-19 Socio-economic Recovery and Response Plan. [Online] available at: <https://www.unicef.org/albania/media/3101/file/UN%20ALBANIA%20COVID-19%20SOCIO-ECONOMIC%20RECOVERY%20&%20RESPONSE%20PLAN.pdf>. [Accessed 14 December 2020].

World Bank, 2020. Albania Emergency COVID-19 Response Project. Report no. PAD4019. [Online] available at: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/941251597066127352/pdf/Albania-Emergency-COVID-19-Response-Project.pdf>. [Accessed 14 December 2020].